

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

RAPORT VJETOR 2015



Tabela Përmbledhëse

Fjala përshëndetëse e Komisionerit	4
HYRJE	5
Konsiderata të Përgjithshme	7
KAPITULLI I	9
VËSHTRIM MBI SITUATËN E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI	9
I.1. Zhvillimi i kuadrit ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri	9
I.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri.....	17
I.2.1. Diskriminimi për shkak të racës.....	17
I.2.2. Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuara.....	32
I.2.3. Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor	37
I.2.4. Diskriminimi për shkak të gjinisë	40
I.2.5. Diskriminimi i shumëfishtë	45
KAPITULLI II	46
VEPRIMTARIA E KMD-SË NË MBROJTJEN NGA SJELLJET DISKRIMINUESE DHE PROMOVIMIN E BARAZISË	46
II.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim	46
II.1.1. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD	46
II.1.1.1. Procedura e shqyrtimit të ankesave	46
II.1.1.2. Çështjet e trajtuara nga KMD gjatë vitit 2014	47
II.1.1.3. Ankuesit	48
II.1.1.4. Shpërndarja rajonale e ankesave	49
II.1.1.5. Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara.....	50
II.1.1.6. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat.....	63
II.1.1.7. Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara	68
II.1.2. Trajtimi i çështjeve me objekt diskriminimi në gjykatë	70

II.1.2.1. Person i Tretë në gjykim në 16 procese gjyqësore	71
II.1.2.2. Dhënie Mendimi me Shkrim nga KMD për Gjykatën në 4 procese gjyqësore	72
II.1.2.3. Palë e Paditur në 14 çështje gjyqësore	73
II.1.2.4 Kërkues për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit në 3 procese gjyqësore	74
II.2. Rekomandime Legjislative dhe Opinione	74
II.2.1. Rekomandime Legjislative	74
II.2.1.1. Rekomandime për Ligjin nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”	75
II.2.1.2 Rekomandim “Për marrjen e masave për eliminimin e situatës diskriminuese në lidhje me trajtimin me karburant dhe lubrifikantë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik”	75
II.2.2. Opinione.....	76
II.2.2.1. Opinion për Gjykatën Kushtetuese	76
II.2.2.2. Opinion për projektligjin “Për shërbimet shoqërore”	76
II.2.2.3. Opinion nga Drejtoria e Çështjeve, Procedurale Ligjore dhe Marrëdhëniet me Jashtë për kalimin e çështjeve në shqyrtim nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit	78
II.3. Ndërgjegjësimi.....	79
II.3.1. Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese dhe manualeve trajnuese.....	79
II.3.2. Organizimi i trajnimeve, takimeve, workshop dhe Ditëve të Hapura.....	80
II.3.3. Pjesëmarrja aktivitetet.....	81
II.3.4. Leksione të Hapura, trajnime të aktorëve të ndryshëm dhe prezantime	81
II.3.5. Rritja e vizibilitetit në media dhe monitorimi i vazhdueshëm i trajtimit të çështjeve të diskriminimit në media.....	82
II.4. Studime e Monitorime mbi diskriminimin dhe Raportime të KMD	83
II.4.1. Studime të KMD mbi diskriminimin	83
II.4.2. Monitorime të KMD mbi diskriminimin	83
II.4.3. Raportime të KMD	84
II.4.3.1. Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi para Organizatave Ndërkombëtare dhe Rajonale.....	84
II.4.3.2. Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të procesit të integritetit evropian.....	85
II.4.3.3. Seancat Publike në Kuvend.....	86

II.5. Bashkëpunime	86
II.5.1. KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit European të Organeve të Barazisë.....	86
II.5.2. Pjesëmarrja dhe kontributi i KMD në grupe pune	88
II.5.3. Marrëveshje Bashkëpunimi të nënshkruara	89
KAPITULLI III.....	90
ASPEKTE TË SHËRBIMEVE.....	90
III.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore	90
III.2. Menaxhimi i burimeve financiare	91
III.3. Programi i transparencës.	93
ANEKS 1	96
Kuadri ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri.....	96
ANEKS 2	101
Pjesëmarrje e stafit të KMD në konferenca, trajnime, takime informuese dhe grupe pune	101

Fjala përshëndetëse e Komisionerit

**I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar Deputetë,**

Me përgjegjësinë që mbart Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion që siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe sjelljet që e nxisin atë, po paraqesim pranë Kuvendit të Shqipërisë Raportin Vjetor 2015.

Aktiviteti i Komisionerit është zhvilluar në funksion të ushtrim të detyrave të tij, mbi zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ky raport është konceptuar duke mbajtur parasysh detyrimin ligjor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të parashikuar në nenin 26 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ku thuhet shprehimisht se “Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e Komisionerit dhe të zyrës”.

Përmbajtja e këtij raporti është ndërtuar bazuar në misionin dhe objektivat e Zyrës së Komisionerit, si dhe në rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar për vitin 2015.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERE

Irma BARAKU

HYRJE

KMD, si një institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit, vlerëson mbrojtjen efektive të së drejtës së çdo individi për barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi si një prioritet të aktivitetit të tij dhe si një çështje me rëndësi të veçantë drejt progresit të shtetit shqiptar drejt integritit në Bashkimin Europian.

Puna e institucionit është bërë e mundur në sajë të bashkëpunimit me organizata të ndryshme jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë grupeve në nevojë, institucioneve të ndryshme në nivel qendror dhe vendor, medias dhe publikut.

Edhe gjatë vitit 2015, veprimtaria e KMD është udhëhequr nga legjislacioni në fuqi, Plani Strategjik 2012-2015 dhe rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e institucionit të KMD për vitin 2015. Plani Strategjik 2012-2015 përbën një instrument të rëndësishëm në punën e KMD, në të cilin përcaktohen jo vetëm objektivat e institucionit, por edhe institucionet e tjera që luajnë rol në zbatimin e kësaj strategjie.

Vlerësimet dhe rekomandimet e Komisionit për çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me “*Projekt - Rezolutën për Vlerësimin e Punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2014 dhe rekomandimet për vitin 2015*”, kanë përbërë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që e nxit diskriminimin.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve dhe masash për:

Së pari, ofrimin e një asistence të kualifikuar ndaj viktimave të diskriminimit përmes trajnimit të aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë:

- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për trajtimin e çështjeve të diskriminimi, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut dhe frymën dhe parimet e vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtësisë;
- Trajnimin e gjyqtarëve të Gjykatave të Shkallës së Parë;
- Trajnimin e nëpunësve të administratës vendore për trajtimin në barazi dhe pa u diskriminuar të qytetarëve;
- Trajnimin e OJF-ve mbi identifikimin e rasteve të diskriminimit dhe rrugët që mund të ndjekin për të asistuar viktimat e sjelljes diskriminuese.

Këto aktivitete trajnimi kanë sjellë si rezultat jo vetëm rritjen e numrit të ankesave pranë KMD-së, dhënien e vendimeve strategjike të diskriminimit (diskriminimi përmes përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBT, diskriminimi në formën e viktimizimit, për shkak të mëmësisë, në fushën e punësimit, arsimit dhe në ofrimin e shërbimeve), ushtrimin e të gjitha kompetencave që ligji i ka dhënë institucionit të Komisionerit, por edhe në rritjen e numrit të çështjeve të trajtuara nga gjykata, vendimeve gjyqësore të dhëna për diskriminim dhe kërkesës së gjykatës për opinionin e Komisionerit apo pjesëmarrjen e Komisionerit si palë e tretë në procesin gjyqësor.

Së dyti, ndërgjegjësimin e shoqërisë në përgjithësi dhe grupeve specifike në veçanti përmes:

- Hartimit dhe botimit të materialeve informuese dhe ndërgjegjësuere mbi Ligjin “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, si manuale, broshura dhe fletëpalosje;
- Përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve informuese në gjithë territorin e Shqipërisë
- Vazhdimin e fushatave ndërgjegjësuere në shkollat 9- vjeçare;
- Leksioneve të hapura me studentët.

Së treti, dhënien e rekomandimeve legislative. Komisioneri ka synuar në përafrimin e legjislacionit ekzistues në përputhje me parashikimet e Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, kryesisht në lidhje me:

- shkaqet e diskriminimit për të cilat këto ligje ofrojnë mbrojtje;
- format e diskriminimit;
- shpërndarjen e barrës së provës.

Konsiderata të Përgjithshme

- Për të luftuar diskriminimin në fushën e arsimit, Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka ngarkuar Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës¹ për marrjen e masave me karakter pozitiv (neni 18 i ligjit), dhe në zbatim të këtyre detyrimeve ka parashikuar në nenin 39 të tij, nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e nenit 18. Komisioneri konstaton se edhe pse me Urdhrin Nr. 52, datë 23. 04. 2012 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02, 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është ngritur një grup ndërinstitucional pune i kryesuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës², akoma nuk janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- KMD i ka kushtuar një vëmendje të veçantë nxitjes së parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke shfrytëzuar disa instrumente, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe rritjen e identifikimit të rasteve apo ankesave. Kontributi i punonjësve të KMD në median e shkruar dhe elektronike, organizimi i workshop-eve, tryezave, seminareve dhe konferencave, organizimi i Ditëve të Hapura, forcimi i bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse, institucione të pushtetit qendror dhe vendor, Universitetet, dhe aktorë të tjerë i ka krijuar më shumë mundësi institucionit të KMD të ndërgjegjësojë publikun në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin. Gjithashtu, përmes organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere me publikun është rritur niveli i informacionit të publikut mbi mjetet ligjore, rolin e KMD, gjykatës dhe numri i ankesave të paraqitura pranë institucionit tonë.
- I është kushtuar një vëmendje e veçantë botimeve të vendimeve të KMD dhe botimeve të tjera, me qëllim rritjen e informacionit të komunitetit mbi situatat diskriminuese dhe mjetet që mund të përdoren për adresimin e tyre. Edhe faqja zyrtare e institucionit është pasuruar me informacione të përditësuara me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm të institucionit me ta.
- Gjatë vitit 2015, është rritur numri i ankesave të paraqitura pranë KMD në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi. Raca, gjendja ekonomike, aftësia e kufizuar, bindjet politike, gjendja shëndetësore, dhe shkaqeve të tjera janë ndër shkaqet kryesore të ankesave të paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- KMD vlerëson të rëndësishme dhe mirëpret rritjen e rolit të organizatave jofitimprurëse që punojnë për të drejtat e grupeve vulnerabël si fëmijët, gratë, përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, pasi këto organizata përbejnë një burim informacioni për KMD. Gjithashtu, media duhet të forcojë rolin e saj aktiv, me qëllim

¹ Emërtimi siç parashikohet në Ligjin “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, sot emërtimi zyrtar “Ministri i Arsimit dhe Sportit”.

² Emërtimi zyrtar në kohën e daljes së urdhrin për ngritjen e grupit të punës, sot Ministria e Arsimit dhe Sportit.

identifikimin e situatave diskriminuuese me të cilat përballen përfaqësues të grupeve të ndryshme, në nivel kombëtar. Pavarësisht mundësive që parashikohen në ligjin nr.10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për paraqitjen e ankesave para KMD nga organizata me interesa legjitimë që pretendojnë diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, numri i ankesave të paraqitura prej tyre zë vetëm 4 % të numrit total të ankesave të paraqitura për shqyrtim pranë KMD.

- Vërejmë se është forcuar roli i organizatave jofitimprurëse, që punojnë për garantimin e të drejtave të komunitetit rom dhe egjiptian, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Bazuar në ankesat e paraqitura nga përfaqësues të komunitetit rom, vërejmë se pjesëtarë të këtij komuniteti ankohen kryesisht për diskriminim në fushën e punësimit, strehimit, arsimit, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe në atë të shërbimeve.
- Ankesat me pretendim diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar kishin të bënin me mohimin e përshtatjes së arsyeshme, ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.
- Vërejmë se, numri i ankesave me pretendim diskriminim për shkak të gjinisë është relativisht i vogël, krahasuar me shkaqet e tjera, por ka një rritje të numrit të ankuesve femra krahasuar me vitin e kaluar.
- Gjatë 2015, vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të ankesave me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve politike, në fushën e punësimit.
- I është kushtuar vëmendje e veçantë zgjerimit të mbledhjes së të dhënave dhe informimit nga institucionet publike qendrore dhe vendore si dhe subjektet private. Kështu, për hartimin e një pjese të këtij raporti, KMD i është drejtuar për informacion 40 institucioneve dhe OJF-ve.
- Me qëllim përmirësimit e mëtejshëm të mekanizmave ligjorë, harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe përafrimin me të drejtën ndërkombëtare në fushën e mosdiskriminimit janë përgatitur dhe dërguar rekomandime legjislative.
- Përmes organizimit të aktiviteteve informuese, trajnuese, etj. me aktorë të ndryshëm janë promovuar praktikrat më të mira të KMD në adresimin e diskriminimit për shkaqe të ndryshme.
- Gjatë vitit 2015, punonjësit e KMD kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre për trajtimin e ankesave në lidhje me diskriminimin për shkaqe të ndryshme, zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit.
- Me qëllim forcimit të bashkëpunimit të KMD me institucione të tjera janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi si dhe janë zhvilluar shumë aktivitete të përbashkëta. Përfshirja si anëtar në rrjetin EQUINET ka ndihmuar KMD të njihet dhe të përdorë më mirë praktikrat e institucioneve homologe europiane dhe të japë kontributin e saj në këtë rrjet.
- KMD ka kontribuar në hartimin e raporteve/raportimeve në kuadrin e organizmave ndërkombëtare dhe rajonale apo procesin e integritit europian.

KAPITULLI I

VËSHTRIM MBI SITUATËN E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI

I.1. Zhvillimi i kuadrit ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në nenin 18 parashikohet se “*të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*”.

Shqipëria është pjesë e instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mos-diskriminimit. Normat ndërkombëtare kanë ndikim shumë të rëndësishëm në sistemin ligjor dhe politikat kombëtare të shtetit tonë. Raporti i tyre me legjislacionin kombëtar në fuqi, përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, jep mundësinë që t'i referohemi dokumenteve të rëndësishëm ndërkombëtare, në veprimtarinë e institucionit tonë. Në rekomandime legjislative dhe rekomandime të tjera, në vendimet në lidhje me shqyrtimin e ankesave, raportet vjetore dhe raportet e veçanta, KMD është referuar në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Kuadri ligjor në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit ka pësuar zhvillime gjatë vitit 2015 të cilat i bëjmë prezent në këtë çështje të raportit, ndërkohë që një informacion të hollësishëm mbi legjislacionin që parashikon dhe garanton mbrojtjen nga diskriminimi do ta gjeni në Aneksin 1 të këtij raporti.

- **Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë**

Ligj Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili ka zëvendësuar ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative*”, është një tjetër akt mbi bazën e të cilit vepron KMD-ja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor (neni 1). Në këtë kod, parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit sanksionohet në nenin 17 sipas të cilit “*1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. 2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë. 3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim*”.

për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”.

Në kuadër të hartimit të Kodit të ri të Procedurave Administrative, KMD ka dërguar rekomandime legislative duke ritheksuar se shpërndarja e barrës së provës për çështjet e diskriminimit është thelbësore referuar edhe në standartet e parashikuara nga direktivat e BE-së në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. Ky standard është reflektuar në kuadër të Kodit të ri të Procedurave Administrative, konkretisht në nenin 82 “barra e provës”, ku thuhet se “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

- **Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar**

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 136, date 5.12.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, date 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Kodi i Punës përcakton disa elemente të rëndësishme të *acquis*, që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve, ndalimin e diskriminimit, marrëdhëniet e punës, si dhe mbrojtjen e veçantë të grave.

Ndryshimet në Kodin e Punës parashikojnë:

- Shkaqe të tjera për të cilat ndalohet diskriminimi në punësim dhe formim profesional, si "orientimi seksual" apo "jetesës me HIV/AIDS", si dhe përputhet kuptimi i diskriminimit me direktivat e BE, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin Nr. 10221, date 4.2.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Barra e provës i lihet punëdhënësit, me qellim të detyrohet për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të respektuar parimin e mosdiskriminimit.
- Një përcaktim më të saktë dhe më të plotë të "shqetësimit seksual". Barra e provës i lihet personit që pretendohet se ka kryer shqetësimin seksual me qellim forcimin e masave për parandalimin e rasteve të shqetësimit seksual në vendin e punës.

Ndryshimet në Kodin e Punës për mosdiskriminimin për personat LGBT parashikojnë:

Shkaqe të tjera për të cilat ndalohet diskriminimi në punësim dhe formim profesional, si "orientimi seksual" dhe "identitetit gjinor", si dhe përputhet kuptimi i diskriminimit me

direktivat e BE, Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

- **Ligj Nr. 104 datë 11.08.2012 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.**

Konventa e Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”, është nënshkruar me 11 maj 2011 në Stamboll, ka hyrë në fuqi në 1 gusht 2014, pas ratifikimit nga 20 shtete anëtare të KiE.³ Kjo Konventë është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 104/2012, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje’”, duke treguar gatishmërinë e shtetit shqiptar për të plotësuar kuadrin ligjor që adreson dhunën në familje dhe përmbushur detyrimet që burojnë nga .

Dhuna në familje si një ndër format më serioze të shkeljes së të drejtave të njeriut. Konventa përkufizon “dhunën ndaj grave” si “shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private”⁴. Kështu, konventa zbatohet për të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë disproporcionale. Parandalimi, mbrojtja e grave ndaj të gjitha formave të dhunës, ndjekja penale e dhunuesve, eliminimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit kundër grave si edhe promovimi i barazisë reale midis burrave dhe grave janë disa nga shtyllat kryesore të këtij akti ndërkombëtar.

Kjo konventë parashikon disa detyrime të rëndësishme që konsistojnë në: të drejtën për informim për viktimat, ofrimin e shërbimeve mbështetëse, të përgjithshme dhe të specializuara për çdo viktimitë, garantimin se sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori veprë penale, ngritjen e strehave të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme e në numër të mjaftueshëm, të drejtën për kompensimin e viktimave të dhunës, garantimin e të drejtës për ndihmë ligjore falas, etj. Kjo konventë përcakton një numër ndërhyrjesh si në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor që adreson dhunën ndaj grave/dhunën në familje ashtu edhe në lidhje me zbatimin e legjislacionit.

³ <http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210/signatures>

⁴ Neni 3 pika (a) e Konventës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”.

- **Ligji kuadër nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”**

Ligji kuadër nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”, synon të garantojë mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara me qëllim pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të PAK në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët. Gjithashtu, ligji përcakton përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse publike dhe jo publike për të bërë të mundur pjesëmarrjen e barabartë në shoqëri të PAK.

Ky ligj përcakton termat, “Persona me aftësi të kufizuara”, “Mohim i përshtatjes së arsyeshme”, e njohur si formë diskriminimi edhe në ligjin 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Organizatë e personave me aftësi të kufizuara”, “Organizatë për personat me aftësi të kufizuara”, “Aksesueshmëri”, “Përfshirje” etj. Edhe përkufizimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar është në përputhje me kuptimin e diskriminimit në nenin 3, “Përkufizimet”, në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ligji prezanton disa koncepte të reja në legjisllacionin e brendshëm për PAK si, “jetesë e pavarur”, “vendimmarrja e mbështetur”, etj. Në ligj përcaktohen institucionet përgjegjëse dhe detyrat me të cilat i ngarkon ligji. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor. Nëpunësit që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe vendor dhe organizata jofitimprurëse janë institucione përgjegjëse në zbatim të tij.

Ligji parashikon ngritjen e Komisioneve multidisiplinare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar e të nevojave për ndihmë e mbështetje.

Mosdiskriminimi dhe barazia duke përfshirë barazinë gjinore janë ndër parimet bazë të këtij ligji. Ky ligj kuadër pritet të udhëheqë përmirësimet e legjisllacionit të brendshëm në përjasje me standardet e KDKPAK. Ky ligj ka parashikuar KMD dhe Avokatin e Popullit si instrumente përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj Konvente.

Lidhur me ndryshimet legjislative për të garantuar të drejtat themelore dhe mundësi të barabarta për grupet në nevojë, në zbatim të Konventës Ndërkombëtare të OKB “Për të Drejtat e personave me Aftësi të Kufizuara” dhe në zbatim të Ligjit Kuadër Nr. 93, datë 28.07.2014 “Për përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të kufizuara”, janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore, që renditen si më poshtë:

- VKM Nr. 48, Date 21.1.2015, “Për rregulloren e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar”.
- VKM Nr. 708, Date 26.8.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.

- VKM Nr. 1074, Date 23.12.2015, "*Për masat e menjanimi të pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike*".
- **Ligj nr. 40/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"**

Ligj nr. 40/2014 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"*", të ndryshuar parashikon trajtimin me dinjitet, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të paraburgosurve dhe të dënuarve, grave të paraburgosura dhe të dënuara, të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor dhe të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar.

Këto ndryshime kërkojnë parandalimin e çdo akti dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi ndaj grave të paraburgosura dhe të dënuara.

Në përputhje me legjislacionin për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, ky ligj parashikon se, masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për grupe të veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve nuk konsiderohen diskriminim.

Masa mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime ligjore, me qëllim rehabilitimin u ofrohen të paraburgosurve dhe të dënuarve që kanë pasur përvoja të përballjes me forma të ndryshme dhune, para ose gjatë qëndrimit në institucion.

Me këto ndryshime ligjore, trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve orientohet nga rehabilitimi dhe ri-integrimi i individualizuar sipas nevojave. Programe kulturore të veçanta parashikohen të ofrohen për të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajve dhe personave pa shtetësi.

Edhe shërbimi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale organizohet pa diskriminim, për shkak të statusit ligjor të personit në institucion ose për çdo shkak tjetër.

- **Ligji nr. 77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, 'Për Ndhmën Juridike', të ndryshuar"**

Me këto ndryshime, legjislatori zgjeroi subjektet që përfitojnë ndihmë juridike, duke përfshirë a) shtetasit shqiptarë me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) shtetasit e huaj që e përfitojnë atë mbi bazën e parimit të reciprocitetit; c) personat pa shtetësi, të pajisur me leje qëndrimi, sipas legjislacionit në fuqi; ç) personat me shtetësi të huaj ose personat pa shtetësi, që kërkojnë të pajisjen me leje qëndrimi, aplikojnë për azil ose që janë në proces ankimi të

vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e lejes së qëndrimit ose aplikimit për azil.”

Të ardhurat financiare të pamjaftueshme të personit dhe të personave që janë në ngarkim të tij/saj, përbërja familjare, statusi shoqëror, përfshirja në programet e mbrojtjes sociale ose plotësimi i kushteve për t'u përfshirë në to dhe çdo rrethanë tjetër që e vendos personin në kushte pamundësie, për të siguruar privatisht ndihmë juridike janë kritere që vlerësohen nga KSHNJ.

Një parashikim shumë i rëndësishëm është ai i parashikuar në nenin 16 “paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës juridike”, sipas të cilit personat, të cilët deklarojnë se përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore dhe të miturit përjashtohen nga detyrimi për paraqitjen e dokumentacionit shoqëruës. Në këto raste, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm. Përjashtimi nga detyrimi i paraqitjes së dokumentacionit shoqëruës lehtëson aksesin e grupeve vulnerabel në sistemin e drejtësisë. Në këtë nen parashikohet se, kur ofrimi i ndihmës juridike paraqet urgjencë, vërtetimi i plotësimit të kritereve mund të bëhet në një moment të mëvonshëm dhe ndihma juridike ofrohet menjëherë.

Këto ndryshime përbëjnë një zhvillim të rëndësishëm në lidhje me garantimin e të drejtës për ndihmë ligjore falas.

- **Ligj nr. 47/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, të ndryshuar.**

Me këtë ligj përcaktohet se, kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga: a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes; b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martesë dhe nuk ka ende vendim gjykate të formës së prerë.

Në nenin 41/1 të këtij ligji parashikohet e drejta e ankimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, pranë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore dhe kur aplikuesi gjykon se vendimi i marrë nuk është i drejtë, ankesa paraqitet me shkrim pranë drejtorit të zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

- **Ligj nr. 104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar .**

Ky ligj parashikon përfitimin e pensionit social nga çdo shtetas, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson

kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.

Në ligj parashikohet se “Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetë-punësuarin, paguajnë kontribut për barrë-lindje dhe për pensione mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi”.

Gjithashtu ligji parashikon se të drejtën e lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguruar, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna.

- **Ligj nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar”**

Me këtë ligj, ka ndryshuar emërtimi nga “Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Ky ligj përcakton kompetencat në fushën e mbrojtjes së të drejtës për informim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat lidhen me shqyrtimin e kërkesave në të cilat ngrihet pretendimi për shkelje të të drejtave të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e Informimit”, ankesave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike, vendosjes së sanksioneve administrative, kryerjes së monitorimeve, kryerjes së sondazheve, parashtrimit të mendimeve me shkrim për çështje që lidhen me të drejtën e informimit kur këtë e kërkon gjykata, etj.

- **Ligj nr. 161/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”**

Ky ligj përcakton Inspektoratin Shtetëror që mbulon fushën e punës dhe Inspektoratin Shtetëror që mbulon fushën e shëndetësisë si autoritete shtetërore përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe përgjegjësitë konkrete me të cilat ngarkohen.

- **Ligji Nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”**

Me këtë ligj janë përcaktuar kritere për ushtrimin e profesionit të punonjësit social, garantimin e standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të punonjësit social. Ligji përcakton organet kryesore të Urdhrit të Punonjësve Social si Asambleja e Urdhrit, Këshilli Kombëtar i Urdhrit, Kryetari i Urdhrit dhe Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.

- **Ligj nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”**

Ky ligj trajton çështje të plotësimit të vendeve të lira të krijuara në mënyrë të përkohshme, plotësimit të vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, të vlerësimit të rezultateve në punë, etj. Ky ligj parashikon se, vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse. Ligji parashikon regjistrimin e nëpunësve civilë në një listë pritjeje deri në sistemimin e tyre, në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, nëse rikthimi në detyrë është i pamundur. Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, të emërojë, fillimisht, me pëlqimin e tyre, nëpunësit civilë të regjistruar në listë. Ligji parashikon se këta nëpunës, me pëlqimin e tyre, mund të sistemohen edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Ky ligj ka pësuar ndryshime dhe po plotësohet me akte nënligjore.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18.3.2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë Ekzekutive*" i ka dhënë prioritet kandidatëve që përfshihen në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara dhe renditjes sipas gjinisë më pak të përfaqësuar. Kështu në Kreun IV, pika 13 parashikohet shprehimisht se "*Kandidatët me pikë të barabarta renditen sipas këtyre kriterëve: (a) Në rast se njëri prej kandidatëve përfshihet në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, atëherë ai për zgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër; (b) Në rast se kandidatët janë të gjinive të ndryshme, atëherë renditja bëhet duke u renditur i pari kandidati që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar në grupin për të cilin konkurrohet*".

- **Ligj nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e Shqipërisë”**

Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012 ka parashikuar si shkaqe të diskriminimit edhe “orientimin seksual”. Neni 5/ 1 i Ligjit nr.69/2012 “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë”, ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor para-universitar⁵. Në lidhje me garantimin e të drejtës së personave LGBTI për tu arsimuar, është e rëndësishme që informacionet për këtë komunitet të bëhen pjesë e kurrikulës dhe stafet akademike të trajnohen sistematikisht.

⁵ KMD, Raport i Veçante “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”, fq.13.

Neni 5, E drejta për arsimim 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar. 2. Në shkollat publike arsimit i detyrueshëm dhe arsimit i mesëm i lartë janë falas.

Neni 6, Parime të përgjithshme, 3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral⁶.

I.2. Situata e diskriminimit në Shqipëri

Në këtë pjesë paraqesim situatën në lidhje me disa nga llojet më të përhapura të diskriminimit, referuar në burimet ekzistuese dhe konstatimet nga veprimtaria e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Nga praktika e zbatimit të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, vit pas viti po vihet re një ndërgjegjësim më i madh i publikut të gjerë dhe grupeve të veçanta mbi mjetet ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo gjë reflektohet edhe në rritjen e numrit të ankesave të regjistruara, dhe zbatimin e ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” edhe në gjykata. Por, edhe pse numri i ankesave ka shënuar rritje, ndërgjegjësimi i popullsisë, mbetet ende një prioritet për KMD.

Në lidhje me situatën e diskriminimit në Shqipëri rezulton se përfaqësues të grupeve të ndryshme si përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, persona me aftësi të kufizuara, gra, përfaqësues të komunitetit LGBT, etj. përballen me forma të ndryshme të diskriminimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë mendim për Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe të planit të veprimit, për zbatimin e saj. Kjo Strategji është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1071, datë 23.12.2015.

I.2.1. Diskriminimi për shkak të racës

Shteti shqiptar i ka kushtuar vëmendje të veçantë përmirësimit të legjislacionit dhe politikave për minoritetet. Kështu, zhvillimet e legjislacionit në vitin 2015; integrimi i çështjeve të komunitetit rom dhe egjiptian në disa politika zhvillimi si Strategjia mbi Përfshirjen Sociale, Strategjia për Zhvillim dhe Integrim si edhe përpjekjet për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, me VKM, Nr.1072, datë 23.12.2015 krijojnë më shumë mundësi për fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri.

⁶ Ndryshuar me Ligj, Nr.56/2015, dt. 28.05.2015, botuar në FLZ Nr.105 datë 23.06.2015.

Por, pavarësisht hapave të ndërmarrë nga qeveria shqiptare në nivel kuadri ligjor dhe politikash, dhe përpjekjeve të vazhdueshme për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, situata e garantimit të të drejtave të këtij komuniteti në praktikë lë për të dëshiruar. Legjislacioni parashikon mundësi për gëzimin e të drejtave të romëve dhe egjiptianeve, por barrierat më të shumta konsistojnë në efektet e tërthorta që sjell zbatimimi i legjislacionit. Ndonëse kriteret në përfitime të caktuara janë neutrale, ato shpesh nuk mund të përmbushen nga pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian duke e përjashtuar këtë komunitet nga gëzimi efektiv i këtyre të drejtave.

Çështjet e komunitetit rom janë çështje prioritare edhe në kuadrin e përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe 5 prioritetet kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim. Një nga këto pesë prioritetet është mbrojtja e të drejtave të njeriut (përfshi politikën e mos-diskriminimit, komunitetin rom, si dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë)⁷.

Romët dhe egjiptianët përballen me barriera të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve, në trajtimin nga pjesa tjetër e popullatës dhe në marrëdhënien me institucionet shtetërore. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë në radhët e komunitetit rom është dy herë më i lartë se në pjesën tjetër të popullatës, ndërsa niveli i papunësisë është tre herë më i lartë se mesatarja⁸. Tridhjetë e nëntë për qind e banesave të romëve dhe 21 për qind e atyre ku banojnë egjiptianët nuk furnizohen me ujë të pijshëm⁹. Mesatarisht romët kanë një moshë vdekjeje të paktën dhjetë vjet më të re sesa popullsia tjetër jo-rome dhe kanë shkallë më të lartë të vdekshmërisë foshnjore¹⁰. Romët dhe egjiptianët përfundojnë mesatarisht 5-6 vjet arsim, krahasuar me mesataren kombëtare që është

⁷ Ministria e Integrimit, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, Qershor 2014.

⁸ Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome, *Raporti i monitorimit nga shoqëria civile për zbatimin e strategjisë kombëtare të integrimit të komunitetit rom dhe të planit të veprimit të dekadës rome në vitin 2012 në Shqipëri*, i përgatitur nga grupi i autorëve (Bajrami, Ivia; Cabiri, Ylli; Hasantari, Adriatik; Kazanxhiu, Latif; Koci, Renart; Mustafaj, Enver; Myrteli, Laver; Nuredin, Albana; Pegini, Hafize; Rama, Lindita; Rushiti, Selvie; Xega, Gerta; Ziu, Dritan), i publikuar në maj 2013, http://www.issueclab.org/click/download2/civil_society_monitoring_report_on_the_implementation_of_the_national_roma_integration_strategy_and_decade_action_plan_in_2012_in_albania, f. 20.

⁹ Të dhëna nga studimi social-ekonomik UNDP/WEB/EC 2011, të cituara në raportin e PNUD-it për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, f. 24-25.

¹⁰ Komisioni Evropian, *Raport mbi shëndetin e komunitetit rom: Gjendja shëndetësore e popullsisë rome dhe monitorimi i të dhënave të mbledhura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian*, prill 2014, http://ec.europa.eu/health/social_determinants/docs/2014_roma_health_report_en.pdf, f. 37.

10 vjet¹¹. Romët dhe Egjiptianët, hasin vështirësi dhe kanë probleme të shumta në lidhje me regjistrimin civil dhe pajisjen me dokumente identiteti, sidomos për fëmijët romë. Kjo për rastet e lindjeve në institucionet shëndetësore dhe ato jashtë institucioneve, brenda dhe jashtë vendit. Ky fakt sjell pengesa në pajisjen me dokumente të shërbimit të gjendjes civile dhe kur plotëson moshën edhe me dokumente identiteti.

Romët dhe më pak egjiptianët hasin barriera në shërbimin e gjendjes civile në rastet e ndryshimit të vendbanimit, për shkak të mungesës së certifikatës së pronësisë ose të kontratës së qirasë së banesës në bashkinë ku janë shpërngulur.

Varfëria dhe kushtet e jetesës ndikojnë gjithashtu në mundësitë e fëmijëve romë dhe egjiptianë për t'u arsimuar. Prindërit romë dhe egjiptianë që shpesh jetojnë nëpër periferitë e qytetit me infrastrukturë të keqe rrugore dhe lidhje të dobëta me transportin publik, nuk kanë mjete për pagesën e transportit të fëmijëve të tyre, të teksteve shkollore dhe materialeve të tjera shkollore. Këta prindër që shpesh edhe vetë nuk janë të arsimuar nuk mund të ndihmojnë fëmijët e tyre me mësimet, t'u japin udhëzime ose ndajnë përvojën e tyre personale nga kjo periudhë (jo atë negative, që ka të bëjë me përjashtimin dhe ngacmimet). Më pas, pamundësia për të paguar shpenzimet e jetesës bëhet pengesë për ndjekjen e arsimit më të lartë nga të rinjtë romë dhe egjiptianë. Shpesh ata detyrohen të kërkojnë punë dhe nuk mund ta përballojnë frekuentimin e mësimet me kohë të plotë.

Në kurrikulat mësimore, romët dhe egjiptianët portretizohen si grupe vulnerabël e jo si identitete më vete, gjë që sjell stigmatizimin e mëtejshëm dhe qëndrimet diskriminuese. Stafii i mësuesve dhe drejtorët e shkollave duhet të përmirësojnë njohuritë e tyre rreth identitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe të rrisin kapacitetet e tyre për mësimdhënien në një mjedis arsimor shumëkulturore dhe për menaxhimin e tij. Bashkëpunimi midis shkollës, shërbimeve sociale lokale dhe aktorëve të tjerë është i domosdoshëm për trajtimin e problemeve me të cilat përballen fëmijët romë dhe egjiptianë dhe për t'i bërë ata të ndihen të mirëpritur në mjedisin shkollore. Gjithashtu ka nevojë që romët dhe egjiptianët mos të jenë të regjistruar në klasa si komunitet me vete por të jenë të "shkrirë" me të gjithë pjesën tjetër. Arsimiti cilësor konsiston jo vetëm në veprimtaritë brenda shkollës, por edhe në aktivitetet në komunitet, ato të ndërgjegjësimit dhe veprimtari të tjera që promovojnë mirëkuptimin e përbashkët dhe dialogun ndërkulturore. Fëmijët romë dhe egjiptianë vuajnë paragjykimet dhe qëndrimet diskriminuese të fshehura, si në mjedisin shkollore, ashtu edhe jashtë tij, gjë që pengon përpjekjet për frekuentimin e shkollës prej tyre dhe më pas integrimin në shoqërinë e gjerë. Në studimin më të fundit të OSFA-së, 80% e familjeve romë kanë raportuar se flasin gjuhën romë në shtëpi (si gjuhë e parë), ndërsa 20% flasin shqip¹², kështu që sistemi arsimor duhet të promovojë bilingvizmin ndërkohë që lehtëson përfshirjen.

¹¹ Statistikat për romët dhe egjiptianët vijnë nga *Anketa social-ekonomike me romët dhe egjiptianët, 2011*, ndërsa mesatarja kombëtare është marrë nga raporti i regjistrimit të popullsisë 2011 nga INSTAT *Popullsia e Shqipërisë*.

¹² OSFA, *Censuri për banesat dhe popullatën romë në Shqipëri*, prill 2014, f. 18.

Nevojitet një kombinim mes masave kurrikulare dhe ekstrakurrikulare për nxitjen e dialogut ndërkulturor dhe për krijimin e një mjedisi shkollor përfshirës, ku diversiteti kulturor vlerësohet dhe për rrjedhojë të gjithë fëmijët të ndihen të barabartë pavarësisht identitetit të tyre të ndryshëm kulturor.

Komuniteti rom dhe egjiptian përballen me problematika të shumta që lidhen me:

Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP): Varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë, ul ndjeshëm interesin e romëve dhe egjiptianëve për të përfunduar AFP-në dhe programet e nxitjes së punësimit, si dhe i detyron ata të gjejnë zgjidhje alternative që shpesh janë informale. Sektorët informal, si p.sh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo aktivitetet e tjera që nuk kërkojnë trajnim të specializuar, gjenerojnë të ardhura më të larta krahasuar me pagën mujore minimale në sektorët formalë. Gjithashtu kultura e varfërisë dhe përjashtimit, mungesa e besimit të programet ekzistuese të punësimit, përvojat negative në të kaluarën etj., bëjnë që pjesa më e madhe e romëve dhe egjiptianëve që punojnë në sektorin informal detyrohen të vazhdojnë të mbeten aty (duke pranuar pasiguritë e tregut informal të punës) dhe nuk preferojnë të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit.

Nuk ka statistika zyrtare nga tregu i punës rreth nivelit të punësimit, të pjesëmarrjes ose të shkallës së papunësisë për romët dhe egjiptianët. Numri i romëve të papunësuar të regjistruar pranë zyrave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në të gjithë vendin është 9273 (nga 141 286 të papunë të regjistruar në total)¹³, por mendohet që ky numër në realitet të jetë edhe më i lartë. Nga studimi i OSFA-së rezultoi se 75% e të rriturve romë në moshë për punë ishin të papunë dhe qytetet më të prekura ishin Elbasani, Berat, Fieri, Gjirokastra, Vlora dhe Lezha¹⁴. Për shkak të periudhave të gjata të papunësisë dhe angazhimit të shpeshtë në punë informale dhe me pagë të ulët, familjet rome preken nga varfëria mbi dy herë më shumë sesa familjet jo-rome që jetojnë në afërsi të tyre¹⁵.

Romët që arrijnë të gjejnë punë merren kryesisht me tregti të vogla të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme, ndërsa popullsia egjiptiane është më tepër e përfshirë në sektorin e shërbimeve, të kujdesit familjar dhe të ndërtimit. Punësimi formal bazohet kryesisht në bujqësinë me të cilën sigurohen nevojat bazë (për komunitetet që banojnë në zonat rurale), e cila karakterizohet nga parcela të vogla toke, mungesa e infrastrukturës dhe e sistemit ujitës, si dhe

¹³ Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Drejtorja e Politikave të Punësimit dhe Migratore, të dhëna të siguruar në shtator 2014.

¹⁴ OSFA, *Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri*, prill 2014.

¹⁵ PNUD, *Romët në Shqipëri: Profili i vendit në bazë të anketës rajonale për romët të PNUD/BB/KE dhe me të dhëna specifike shtesë për vendin nga "Studimi i vlerësimit të nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri"*, qershor 2012

<http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>, fq. 2.

nga kostot e larta të mirëmbajtjes¹⁶. Nga studimi i PNUD-it për vlerësimin e nevojave rezultoi se 95,9% e të intervistuarve romëve dhe 88,7% e të intervistuarve egjiptianë të punësuar, nuk kishin kontrata pune dhe një raport i njëjtë nuk paguante kontributet shoqërore, gjë që kufizonte aksesin e tyre në mbrojtjen sociale dhe shërbime të tjera¹⁷. Siç u përmend edhe më lart, një numë i madh romësh dhe egjiptianësh punojnë si mbledhës të mbetjeve të riciklueshme, ndonjëherë në burim (p.sh. në restorante), por shpesh edhe nëpër kazanët e plehrave dhe në zonat e grumbullimit të mbetjeve. Me privatizimin e mundshëm të landfilleve, shumë prej tyre do të mbeten pa burimin e vetëm të jetesës, nëse nuk gjenden mekanizma për përfshirjen formale të tyre në mbledhjen e privatizuar të mbetjeve dhe në sistemet e klasifikimit të tyre. Gjithsesi, aktualisht nuk ka asnjë program shtetëror për mbështetjen ndaj sipërmarrësve dhe të vetëpunësuarve vulnerabël dhe me nivel të ulët aftësish¹⁸, megjithëse qeveria po mendon propozimin e një projekt-ligji për sipërmarrjet sociale. Romët dhe egjiptianët që prodhojnë produkte artizanale tradicionale kanë mundësi të pakta për shitjen dhe reklamimin e tyre, që vjen si rezultat i të ardhurave të kufizuara.

Romëve që jetojnë në zonat rurale shpesh u mungon dokumentacioni i duhur për vërtetimin e pronësisë mbi tokën që është një nga burimet e vetme të jetesës së tyre. Pasiguria e pronësisë buron nga të dhënat kontradiktore mbi pronësinë e tokës në komunat vendore dhe këshillat e qarqeve (zyra kadastrale e qarkut). Në disa raste, për shkak të nevojës imediate për të ardhura, romët shesin tokën pa ndjekur procedurat ligjore. Për rrjedhojë, ata vazhdojnë të mbeten të regjistruar si pronarë, gjë që ndikon në të drejtën e tyre për të përfituar nga programet e mbështetjes sociale” dhe në detyrimin për të paguar taksat, ndërkohë që në realitet ata nuk janë më pronarë të pronës.

Romët dhe egjiptianët përballen gjithashtu me barriera të fshehta në punësim, duke përfshirë distancën nga puna/shkolla, diskriminimin dhe stigmatizimin e të qenit rom/egjiptian, shpeshësinë e migrimit, mungesën e kartave të identitetit dhe të dokumenteve të tjera personale dhe administrative, mungesën e informacionit mbi ekzistencën e programeve të punësimit, etj¹⁹. Duke mos pasur informacionin e mjaftueshëm rreth avantazheve të regjistrimit si të papunë, shumë romë nuk kanë akses në masat e marra për arsimin dhe formimin profesional dhe në masat e tregut aktiv të punës. Pjesa më e madhe e zyrave të punës dhe e qendrave AFP nuk kanë asnjë të punësuar me origjinë rome ose egjiptiane, gjë që sjell keqkuptime mes administratës dhe komuniteteve dhe ndonjëherë edhe qëndrime diskriminuese gjatë ofrimit të shërbimit²⁰.

¹⁶ PNUD, *Vlerësimi i nevojave të individëve romë dhe egjiptianë për punësimin dhe sipërmarrjen në rrethin e Korçës, Beratit dhe Vlorës*, i përgatitur nga Krisela Hackaj, f. 29.

¹⁷ PNUD, *Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri*, shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, f. 41.

¹⁸ Ministria e Ekonomisë ka një program të limituar për promovimin e sipërmarrjes, por që nuk trajton grupet vulnerabël.

¹⁹ PNUD, *Vlerësimi i nevojave të individëve romë dhe egjiptianë për punësimin dhe sipërmarrjen në rrethin e Korçës, Beratit dhe Vlorës*, i përgatitur nga Krisela Hackaj, f. 21.

²⁰ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2015-2020

Strehimi dhe integrimi urban: Romët dhe egjiptianët jetojnë në kushte të këqija banimi ku shpesh mungojnë instalimet hidrosanitare, jetojnë në zona periferike dhe pa infrastrukturë pranë. Gjashtëmbëdhjetë për qind e familjeve rome nuk furnizohen me ujë të rrjedhshëm në shtëpitë e tyre dhe as jashtë saj, ndërkohë që 28% e familjeve rome jetojnë në banesa që nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza²¹. Nga një studim më i hershëm janë siguruar të dhëna të disagreguara për familjet rome dhe egjiptiane, sipas të cilave 38,8% e banesave të banuara nga romët nuk furnizohen me ujë të pijshëm, krahasuar me 20,8% të familjeve egjiptiane²². Përqindje të ngjashme përshkruajnë aksesin në shërbimin e kanalizimit të ujërave të zeza dhe të përdorura.

Gjithashtu familjet rome dhe egjiptiane shpesh banojnë në banesa nën standard dhe vuajnë pasigurinë e qiramarrjes. Sipas studimit të OSFA-së, 67% e familjeve rome jetojnë në shtëpi private përdhese, pesë për qind në banesa të përshtatura si ish-magazina, kapanone etj, 15% në baraka dhe vetëm 13% në blloqe apartamentesh. Në 38% të rasteve, të gjithë anëtarët e familjes jetojnë në një dhomë të vetme. PNUD konstatoi se shumica e romëve jetojnë në ndërtesa të dëmtuara (38,4%) ose në baraka (20,8%), krahasuar me 45,8% dhe 10,9% të egjiptianëve²³. Gjashtëdhjetë e tetë për qind e familjeve rome (2.967 familje në total) nuk posedojnë dokumente që vërtetojnë pronësinë mbi shtëpinë. Duke marrë parasysh madhësinë mesatare të familjeve, prej 4,4 anëtarësh, kjo do të thotë se 13.055 romë jetojnë me riskun për t'u nxjerrë nga shtëpitë dhe/ose për t'u kthyer në të pastrehë²⁴. Nuk ka të dhëna rreth pronësisë së familjeve egjiptiane mbi pronën.

Në pamje të parë kjo situatë duket e lidhur drejtpërdrejt me varfërinë, por në fakt është më komplekse se kaq. Personat që nuk mund të përballojnë strehimin në kushtet e tregut kanë të drejtën të përfitojnë nga strehimi social, por romët dhe një pjesë e egjiptianëve shpesh nuk mund të aplikojnë pasi nuk kanë të ardhurat e mjaftueshme dhe/ose burime të ardhurash të verifikueshme për t'u kualifikuar. Kjo i përjashton ata edhe nga marrja e kredive me interes të ulët për rikonstruktimin e banesave të tyre ekzistuese.

Banesat e romëve²⁵ dhe egjiptianëve shpesh ndërtohen në mënyrë të paligjshme dhe procesi i legalizimit është i pavolitshëm për t'u zhvilluar. Një studim i Entit Kombëtar të Banesave në vitin 2006, tregoi se vetëm 4,3% e familjeve rome kishin pronësi mbi tokën ose shtëpinë e tyre, 87% kishin uzurpuar tokë private (objekt i kthimit të pronave) dhe pjesa tjetër e banesave gjendeshin mbi tokë publike. Për rrjedhojë, romët dhe egjiptianët jetojnë në rrezikun e

²¹ OSFA, *Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri*, prill 2014.

²² Të dhëna nga studimi social-ekonomik PNUD/BB/KE 2011, të cituara në studimin e PNUD-it për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, f. 24-25.

²³ *Po aty*.

²⁴ OSFA, *Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri*, prill 2014.

²⁵ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2015-2020

vazhdueshëm të nxjerrjes me forcë nga banesat e tyre dhe nuk mund të përfitojnë nga kompensimi në rast se nxirren për shkak të punimeve publike. Të ngecur në këtë rreth vicioz, ata nuk mund të legalizojnë banesat e tyre ose të përfitojnë nga strehimi social, bashkia nuk siguron infrastrukturën për banesat e jashtëligjshme dhe kjo gjë kontribuon në përjetësimin e varfërisë. Gjithashtu Komisioneri ka trajtuar rastin e një familje rome të cilës për shkak të pamundësive financiare, prej shumë kohësh nuk ka paguar energjinë elektrike. Duhet theksuar se OSSHE ka ndërmarrë programe në ndihmë të komuniteteve në nevojë por këto programe nuk kanë pasor pasoja pozitive sepse shtresat në nevojë nuk kanë përfituar. Sipas përlllogaritjeve të Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri “rreth 175 familje rome jetojnë në baraka ose në kasolle të improvizuara në zona të ndryshme të Tiranës (Ish-Artistikja në Selitë, Shkozë, Liqeni Artificial, Bregu i Lumit në rrugën Halit Bega, Babrru poshtë urës, etj.)²⁶. Instituti gjithashtu ka bërë rekomandim për ngritjen e një sistemi për menaxhimin e rastit të familjeve që nuk plotësojnë kriteret e strehimit social dhe jetojnë në informalitet. Kjo mund “të hapë rrugën për ngritjen e një Fondi Social, të mbështetur te sipërmarrja publike, dhe të garantojë një sistem efektiv të mbrojtjes sociale i cili të fuqizojë përfituesit e tij dhe t'i bëjë ata të pavarur brenda një harku kohor të caktuar”²⁷.

Por, pavarësisht hapave të ndërmarrë nga qeveria shqiptare në nivel kuadri ligjor dhe politikash, dhe përpjekjeve të vazhdueshme për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Europian për Shqipërinë, situata e garantimit të të drejtave të këtij komuniteti në praktikë lë për të dëshiruar. Legjislacioni parashikon mundësi për gëzimin e të drejtave të romëve dhe egjiptianeve, por barrierat më të shumta konsistojnë në efektet e tërthorta që sjell zbatimi i legjislacionit. Ndonëse kriteret në përfitime të caktuara janë neutrale, ato shpesh nuk mund të përmbushen nga pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian duke e përjashtuar këtë komunitet nga gëzimi efektiv i të drejtave. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizëm dhe Autoriteti Kombëtar i Banesave kanë propozuar rritjen e numrit të banesave sociale për strehim të shtresave në nevojë. Në shkurt, ministria njoftoi një strategji e re të strehimit për të përfshirë romët dhe egjiptianët, me qëllim promovimin dhe legalizimin e vendbanimeve informal, si dhe për të përmirësuar qasjen në shërbime, sic është uji dhe kanalizimet²⁸.

Në Ditën Ndërkombëtare të Romëve në prill 2015, 100 familje rome në rrezik dëbimi nga lagjja “Selitë” në Tiranë demonstuan për të kërkuar strehim alternativ. Qeveria hodhi poshtë një ndryshim të propozuar në ligjin mbi legalizimin e ndërtimeve pa leje në maj, kërkuar në një petition të nënshkruar nga 6.000 romë dhe egjiptian, të cilët bënin thirrje për mbrojtje dhe ishin kundër dëbimit me forcë dhe strehimit alternativ²⁹. Në ankesën e ardhur pranë KMD shpjegimet e dhëna nga banorët të cilët pretendojnë se: Vendimi Nr. 230, datë 13.03.2015 i Këshillit të

²⁶ Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), *Rekomandimi për krijimin e një fondi social që gjeneron të ardhura nga sipërmarrja publike, duke reformuar sistemin e mbrojtjes sociale në vend*, shtator 2013, https://groups.yahoo.com/neo/groups/Roma_Shqiperia/conversations/messages/3354, f. 2.

²⁷ *Po aty*, f 4.

²⁸ Informacion nga MMSR, nuk ka akoma zhvillim.

²⁹ <https://www.amnesty.org/en/latest/research/2015/02/annual-report-201415/>

Ministrave “Për trajtimin me pagesë të qirave për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: *Unaza e madhe e Tiranës, segmenti, Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës*” është diskriminues pasi nuk është konsultuar më parë me subjektet për të cilët sjell pasoja dhe nuk jep zgjidhje përfundimtare të drejtës për strehim të këtyre familjeve si dhe ka neglizhuar e nuk ka vlerësuar disa çështje thelbësore, si më poshtë cituar:

1. Mungon plani për strehimin e përkohshëm të këtyre banorëve pasi nuk ofrohet asnjë zgjidhje nëse banorët nuk do jenë në gjendje të kontraktojnë me një qiradhënë.
2. Mungon plani afatgjatë për strehimin e mëtejshëm të këtyre banorëve, pas përfundimit të afatit 2 vjeçar.
3. Mënyra e dhënies së grantit nuk ofron garanci, pasi granti mund të tërhiqet nga kryefamiljari dhe të përdoret për arsye të tjera të ndryshme nga ai për të cilin është dhënë, duke lënë të pastrehë një numër relativisht të madh fëmijësh, interesi i të cilëve mbrohet nga shteti, pavarësisht vullnetit të prindërve. Gjithashtu nuk është konsideruar fakti që disa familje mund të jenë debitorë ndaj të tretëve dhe llogaria bankare të bllokohet për këtë arsye, duke mos realizuar qëllimin e grantit.
4. Në vendim nuk parashikohet një plan i detajuar i zhvendosjes së këtyre banorëve, përfshirë këtu transportin, gjetjen e një vendstrehimi të përkohshëm, përballimin e kostove të noterit, etj.
5. Nuk garantohet që do të sigurohet një numër i mjaftueshëm banesash në të njëjtën zonë, për të gjitha familjet, në mënyrë që të garantohet vazhdimësia e jetës atje ku janë edhe burimet e jetesës (mbledhje dhe tregim të materialeve të riciklueshme, shitja e veshjeve të përdorura në tregun pranë banesës aktuale, etj).
6. Ky vendim është tregues që Qeveria nuk po merr në konsideratë kompensimin e ndërtimeve të bëra nga banorët, të cilët kanë investuar kursimet e jetës në këto ndërtime dhe nuk kanë përfituar legalizim për shkak të mosveprimit prej një periudhë të gjatë nga ALUIZNI.

Zbatimi në praktikë i të drejtave të pronësisë mbetet një çështje që duhet të garantohet, dhe proceset e regjistrimit, kthimit dhe kompensimit të pronës nuk kanë përfunduar ende. Pakicat Rome dhe egjiptiane përballen me kushte shumë të vështira të jetesës dhe vuajnë nga përjashtimi social dhe diskriminimi i shpeshtë. Në fushën kundër diskriminimit, është e nevojshme që jurisprudenca të zhvillohet më tej³⁰.

Në korrik 2015, Komiteti për Drejtat e Njeriut të OKB-së ka kërkuar lëshimin e një Urdhëri mbrojtje të përkohshëm për pezullimin e prishjes së shtëpive të 7 familjeve rome e në Elbasan. Në pritje të shqyrtimit të ankesës së tyre, të cilët pretendojnë kompensim³¹.

³⁰ 11.11.2015, Progres Raporti 2015, fq. 5 <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2015&page=1>

³¹ <https://www.amnesty.org/en/latest/research/2015/02/annual-report-201415/>

Qeveria dështoi për të garantuar të drejtat ligjore të jetimëve të pastrehë të regjistruara deri në moshën 30 vjeç për një qasje prioritare për strehim social në banesa sociale. Në maj, në Ditën Kombëtare të Jetimëve, jetimët demonstrojnë duke bërë thirrje për arsim, strehim dhe ndihmën financiare të shtetit si tallëse për ta.³²

Gjatë muajit nëntor - dhjetor, KMD ka zhvilluar ditë të hapura kryesisht me banorët Rom dhe Egjiptian në disa qytete.

Ligji nr. 9232, dt. 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 9719/2007, ligjin nr. 54/2012, në nenin 24 të tij parashikon mundësinë e subvencionimit të qerasë. Ky nen, në pikën 2 të tij, parashikon se, familjet e komunitetit rom trajtohen me përparësi, në lidhje me subvencionimin e qirasë ose përfitimin e bonusit të strehimit. Sipas këtij ligji, familjet romë pa të ardhura mund të përfshihen vetëm në programin social të strehimit për subvencionimin e bonusit të strehimit dhe atë të granteve të vogla, ku ky i fundit arrin të financojë vetëm përmirësim të kushteve të banimit dhe jo strehim të kësaj kategorie. Gjithashtu programet e tjera sociale të parashikuara nga ky ligj kërkojnë që përfituesi të ketë *një kufi të caktuar të ardhurash* dhe duke qenë se këto familje jetojnë në informalitet është e vështirë matja e të ardhurave të tyre³³. Shumë nga familjet romë nuk plotësojnë kufirin e caktuar në ligj të të ardhurave. Shumë nga Romët dhe egjiptianët nuk arrijnë të përfitojnë nga programet e strehimit social. Jetesa në kushte jo të mira banimi dhe infrastruktura e keqe e shton izolimin e tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe luan rol pengues në arsimimin e fëmijëve të tyre³⁴

Komuniteti rom dhe egjiptian përballet me probleme të ndryshme ligjore që kërkojnë asistencën e një avokati falas. Ndonëse ligji nr. 10039 datë 22.12.2008, “Për Ndhmën Juridike”, i ndryshuar dhe aktet e tij nënligjore kanë parashikuar mundësinë e përfitimit të individëve që vërtetojnë se përfshihen ose plotësojnë kushtet për tu përfshirë në programet e mbrojtjes sociale, janë viktimat dhune ose viktimat të fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to, nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian që kanë përfituar ndihmë juridike falas nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike. Mungesa e informacionit në lidhje me mundësitë që ofron legjislacioni për përfitimin e ndihmës juridike falas dhe pengesa të tjera që lidhen me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim kanë sjellë barriera në gëzimin e kësaj të drejte nga anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian.

Me ndryshimet e ligjit nr.10039 datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar, gjatë vitit 2014, personat që deklarojnë se përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore dhe të miturit

³² <https://www.amnesty.org/en/latest/research/2015/02/annual-report-201415/>

³³ Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë Soros, Analizë e legjislacionit për problemet e strehimit, 9 shkurt 2015, fq.17. Ky studim është i vlefshëm në www.osfa.al

³⁴ Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve romë dhe egjiptiane në Shqipëri. Tiranë 2012, Ky studim është përgatitur me mbështetjen financiare të Programit Një OKB.

përjashtohen nga detyrimi për ti bashkëngjitur kërkesës për ndihmë juridike falas, dokumentacionin e nevojshëm. Në kushtet e ndryshimeve të fundit që ka pësuar ligji “Për ndihmën juridike”, (ligj nr. 77/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar) si përjashtimi i individit nga pagesa e taksës mbi aktet si dhe përjashtimi nga shpenzimet gjyqësore si në proceset civile ashtu edhe në ato administrative, nevojitet rritja e nivelit të informacionit të këtij komuniteti mbi këto të drejta dhe mbështetja e komunitetit për ti kërkuar këto të drejta. Në raste urgjente, një përfaqësues i komunitetit rom që përmbush kushtet e përfitimit të ndihmës juridike falas përfiton ndihmë menjëherë. Ngritja e zyrave vendore për ofrimin e shërbimit ligjor falas do të mundësonte rritjen e numrit të përfituesve nga komuniteti rom dhe egjiptian nga këto shërbime, jo vetëm në Tiranë por edhe në rrethe.

Aksesi në shërbimet publike, shoqërohet me problematika, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës.

Varfërinë, e cila është ende prezente dhe në nivele të larta, veçanërisht për romët. Një nga treguesit e saj janë të ardhurat mujore familjare të këtij komunitetit. Kështu, referuar Censurit të Popullsisë, “*Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri*”, rezulton se: “*Sipas vetë-deklarimeve të ardhurat mujore familjare paraqiten mjaft të ulta krahasuar dhe me pagën minimale, e cila në vitin 2014 rezulton 19,000 Lek në muaj. Kështu rreth 48% e familjeve rome deklarojnë se kanë më pak se 10,000 Lek të ardhura mujore e ndjekur me rreth 35% të familjeve që deklarojnë më pak se 20,000 Lek të ardhura në muaj. Rezultatet tregojnë se më pak se 1% e familjeve rome deklarojnë të ardhura deri në 50,000 Lek në muaj*”.³⁵

Gjendjen shëndetësore, të romëve dhe egjiptianëve, e cila është shumë më e ulët se ajo e popullsisë në shumicë, çka pasqyrohet edhe në jetëgjatësinë e tyre relativisht më të ulët. Shkaqet e kësaj gjendjeje jo të përshtatshme shëndetësore lidhen me varfërinë, kushtet e vështira të jetesës dhe mungesën e infrastrukturës bazë, qasjen e kufizuar në shërbimet shëndetësore, nivelin e ulët arsimor dhe disa forma të diskriminimit³⁶. Ndërkaq, këto studime tregojnë se, vetëm 58% e romëve dhe 76% e egjiptianëve shprehen se kanë librezë shëndetësore dhe marrin shërbime në qendrën shëndetësore.

Të dhënat e disponueshme aktualisht nuk tregojnë nëse ka dallime të konsiderueshme në gjendjen shëndetësore apo atë të varfërisë mes grupeve etnike në Shqipëri. Gjithsesi, kërkimi i kryer nga BE-ja tregon se “mesatarisht romët kanë një moshë vdekjeje të paktën dhjetë vjet më të

³⁵ Për më shumë në lidhje me censurin dhe metodologjinë shih: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Census 2014, Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri. I vlefshëm në www.osfa.al

³⁶ Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Census 2014, Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri. i vlefshëm në www.osfa.al

re sesa popullsia jo-rome, kanë akses më të ulët në shërbimet shëndetësore dhe kanë shkallë më të lartë të vdekshmërisë foshnjore”³⁷.

Shumë romë dhe egjiptianë nuk mund të shkojnë te mjeku i familjes ose të përfitojnë nga shërbimet e vaksinimit, për shkak të pamundësisë për të transferuar zyrtarisht vendbanimin e tyre ose mungesës së dokumenteve personale ose librezës shëndetësore. Shumë familje rome jetojnë në zonat e grumbullimit të mbetjeve ose në rrugë, kështu që nuk mund të pajisen me dokumentet e nevojshme dhe në të njëjtën kohë kanë risk të madh shëndetësor për shkak të kushteve të jetesës. Romët dhe egjiptianët përballen me probleme komunikimi³⁸, me diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe indirekt, kështu që kërkojnë ndihmë mjekësore vetëm në fazat e avancuara të sëmundjes. Ata nuk mund të paguajnë shërbimet shëndetësore dhe mjekimin, dhe ndonjëherë nuk janë të regjistruar në sistemin e mbrojtjes sociale, kështu që nuk mund të përfitojnë nga skemat e rimbursimit apo të uljes së çmimit.

Ndihmën ekonomike, pagesat e papunësisë, pensionet për fëmijët jetim, të cilat janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat familjare të përfaqësuesve të minoritetit rom. Sistemi i ri i pikëzimit është shoqëruar me ankesa nga përfaqësues të këtij komuniteti për përjashtimin në përfitimin e ndihmës ekonomike. Një numër anëtarësh të komunitetit rom nuk përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike ose e humbasin atë për shkak të mungesës së një banimi të përhershëm. Romët dhe egjiptianët punojnë në tregun informal të punës, ndaj nuk mund të përfitojnë nga skemat e sigurimeve shoqërore. Me ndryshimet e legjislacionit të sigurimeve shoqërore, ligjit nr. 7703 datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH” me ligjin nr. 104 datë 31.7.2014, është parashikuar pensioni social, por përfitimi i tij fillon në moshën 70 vjeç, për të gjithë të moshuarit, rezident në Shqipëri gjatë 5 viteve të fundit, të cilët nuk përmbushin kushtet që nevojiten për të përfituar pension.

Strehimin, një çështje ende e pazgjidhur, e cila e ka detyruar komunitetin rom të gjej zgjidhje alternative duke u “vetë-sistemuar”, gjë e cila pason me krijimin e informalitetit, shpesh i inkurajuar edhe nga mungesa e reagimit të autoriteteve që i lë në këtë situatë informaliteti për një kohë të gjatë. Kjo situatë e kombinuar me një kuadër ligjor të papërshtatshëm për akomodimin e kësaj pjese të shoqërisë ka sjellë diskriminim të saj. Largimi nga vendbanimet pa i ofruar një mundësi të përshtatshme strehimi dhe mungesa e rregullimeve ligjore në lidhje me ofrimin e akomodimit të përshtatshëm para dëbimit, ngrenë çështje të diskriminimit të anëtarëve të këtij komuniteti dhe mos përmbushje të standardeve ndërkombëtare. Shumë nga romët dhe egjiptianët

³⁷ Komisioni Evropian, *Raport mbi shëndetin e komunitetit rom: Gjendja shëndetësore e popullsisë rome dhe monitorimi i të dhënave të mbledhura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian*, prill 2014, f.37. http://ec.europa.eu/health/social_determinants/docs/2014_roma_health_report_en.pdf.

³⁸ Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome, *Raporti i monitorimit nga shoqëria civile për zbatimin e strategjisë kombëtare të integritit të komunitetit rom dhe të planit të veprimit të dekadës rome në vitin 2012 në Shqipëri*, maj 2013, f. 10.

nuk arrijnë të përfitojnë nga programet e strehimit social. Jetesa në kushte jo të mira banimi dhe infrastruktura e keqe e shton izolimin e tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe luan rol pengues në arsimimin e fëmijëve të tyre³⁹. Edhe Progres Raporti 2014 për Shqipërinë vë theksin tek fakti se: *“Ende nuk është identifikuar një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme për strehimin e këtyre personave të dëbuar. Ligji i ri për legalizimin e pronave u miratua në maj pa konsultim paraprak me grupet e interesit, dhe ka rritur rrezikun e dëbimeve të mëtejshme të familjeve romë nga vendbanimet e tyre informale, gjë që përbën shqetësim të veçantë”*.

Programet e strehimit social tërheqin familjet me të ardhura mesatare 6 deri në 8 herë më të larta se kufiri i varfërisë¹⁰ (UNDP, 2014a). Një prej programeve më të mëdha (programi me banesa me kosto të ulët) nuk është i përballueshëm për të varfrit; për këtë arsye, të varfrit nuk përfitojnë nga ky program. Gjithashtu, procedurat bankare janë tepër të gjata dhe të kushtueshme; nëpunësit e njërive vendore dhe punonjësit e bankave shpesh u japin përparësi miqve dhe nëpunësit e njërive vendore i nxisin individët të bëjnë kërkesë për strehim social edhe nëse këta nuk i përmbushin kriteret e vendosura me ligj. Programi i banesave sociale me qira ka më shumë gjasa të ketë në fokus familjet me të ardhura të ulëta. Por megjithatë, njerëzit që jetojnë afër ose nën kufirin e varfërisë nuk mund ta përballojnë këtë program. Përveç kësaj, programi i banesave sociale me qira nuk trajton nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Programi më i vogël është ai i subvencioneve të strehimit. Subvencionet e strehimit shihen si zgjidhje e përkohshme e problemeve të strehimit. Nuk ka ndonjë rregull për të dekurajuar varësinë ndaj programit. Subvencionet e strehimit jo gjithmonë përdoren nga grupet në pozita të pa favorizuara për shkak të diskriminimit që hasin nga pronarët e apartamenteve⁴⁰.

Asistencën juridike falas, ose avokati pa pagesë, e cila do t'i afronte më shumë anëtarët e komunitetit egjiptian dhe atij rom në veçanti, drejt informimit dhe ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre. Ndonëse ligji nr. 10039 datë 22.12.2008, *“Për Ndhmën Juridike”*, i ndryshuar dhe aktet e tij nënligjore kanë parashikuar mundësinë e përfitimit të individëve që vërtetojnë se përfshihen ose plotësojnë kushtet për tu përfshirë në programet e mbrojtjes sociale, janë viktimat dhune ose viktimat të fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to, nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian që kanë përfituar ndihmë juridike falas nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike. Mungesa e informacionit në lidhje me mundësitë që ofron legjislacioni për përfitimin e ndihmës juridike falas dhe pengesa të tjera që lidhen me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim kanë sjellë barriera në gëzimin e kësaj të drejte nga anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian. Me ndryshimet e ligjit nr.10039 datë 22.12.2008, *“Për ndihmën juridike”*, i ndryshuar, gjatë vitit 2014, personat që deklarojnë se përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore dhe të miturit përjashtohen nga detyrimi për ti bashkëngjitur kërkesës për ndihmë juridike falas,

³⁹ Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve romë dhe egjiptiane në Shqipëri. Tiranë 2012, Ky studim është përgatitur me mbështetjen financiare të Programit “Një OKB”.

⁴⁰ http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/userfiles/Plane_pune_dhe_Strategjiite/Strategjia_e_Strehimit_Social.pdf.

dokumentacionin e nevojshëm. Ngritja e zyrave vendore për ofrimin e shërbimit ligjor falas do të mundësonte rritjen e numrit të përfituesve nga komuniteti rom dhe egjiptian nga këto shërbime, jo vetëm në Tiranë por edhe në rrethe. Problemi i rritjes së aksesit në sistemin e drejtësisë është një problem edhe për grupet e tjera në nevojë, i cili është ngritur si shqetësim edhe në Progres Raportin për Shqipërinë 2014. Kështu, në këtë raport citohet se: *“Për sa i përket aksesit në drejtësi, duhet të përmirësohet funksionimi i Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike dhe duhet të zbatohen dispozitat e miratuara rishitas për ndihmën juridike që parashikojnë ngritjen e zyrave vendore për ndihmën juridike. Tarifat gjyqësore frenojnë shumë qytetarë dhe procedurat e aplikimit janë shumë të ngadalta. Vazhdon të jepet ndihmë juridike falas, kryesisht nga organizatat joqeveritare me financim të donatorëve”*⁴¹.

Arsimimin, i cili bëhet i vështirë për shkak të largësisë së shkollave nga vendbanimi, mungesa e mbulimit në praktikë të transportit falas për nxënësit rom, kur shkollat janë më shumë se 2 km larg vendbanimit të tyre, stereotipet se vajzat rome duhet të martohen në moshë të hershme, varfëria në familje janë disa nga problematikat me të cilat përballen fëmijët rom dhe egjiptian. Ndonëse, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 709 datë 5.10.2011 *“Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”*, parashikon detyrimin e mbulimit të shpenzimeve për transportin e nxënësve për distance mbi 2 km, në praktikë rezulton se, largësia e shkollës nga vendbanimi është një arsye tjetër që pengon arsimimin e fëmijëve, çka theksohet nga 18% e prindërve romë dhe 8% e atyre egjiptianë⁴². Ligji nr. 69, datë 29.6.2012 *“Për sistemin arsimor para-universitar”* synon të vendosë standarde gjithëpërfshirëse në arsimin para-universitar, por përmbushja e këtyre standardeve lë për të dëshiruar. Masa të veçanta të përkohshme janë ndërmarrë nga Shteti Shqiptar si përjashtimi i fëmijëve rom nga pagesa e depozitës së garancisë⁴³, nga pagesa e bordeve të prindërve romë në të gjithë vendin, në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët rom në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jo-universitare profesionale, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë (2014 – 2015)⁴⁴.

Disa masa pozitive, duke pasur si qëllim nxitjen e arsimimit të fëmijëve të pakicave kanë rezultuar në krijimin e situatave segreguese, si në Korçë dhe në Berat.

Është zgjeruar numri i përfituesve të librave falas për pakicat rome, por shpesh zbatimi me vonesë është një pengesë për ta. Ka një udhëzim të veçantë që lejon regjistrimin e fëmijëve rom

⁴¹ Komisioni European, Progres Raporti 2014 për Shqipërinë, I vlefshëm në ëëë.integrimi.gov.al

⁴² Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri. Tiranë 2012, Ky studim është përgatitur me mbështetjen financiare të Programit Një OKB.

⁴³ Udhëzimi nr. 21/8.8.2014 *“Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”*

⁴⁴ Udhëzimi nr. 34, datë 30.09.2014 *“Për kriteret, procedurat e përzgjedhjes, regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, romët dhe egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jo-universitare profesionale, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë (2014 – 2015)”*.

dhe egjiptian edhe pa pasur dokumenta identifikimi. Megjithatë ka raste që pranë Komisionerit janë paraqitur ankesa të cilat janë zgjidhur me ndërmjetësim.

Gjithashtu, një numër i madh nxënësish rom braktisin arsimin e detyruar jo vetëm si rezultat i qëndrimeve diskriminuese, mungesës së mbështetjes dhe ngacmimeve në shkollë, por edhe për shkak të nevojës për të ndihmuar prindërit e tyre në aktivitete që gjenerojnë të ardhura⁴⁵. Duke konsideruar këto barrierë shumica e prindërve romë që përballen me përjashtimin social besojnë se vajza e tyre do të jetë më e mbrojtur nëse e braktis shkollën në vitet para të adoleshencës dhe të përgatitet për të krijuar familjen e saj⁴⁶, sesa të mbetet pas me mësim, të trajtohet me inferioritet nga bashkëmoshatarët e saj jo-rom e mbi të gjitha të nisë një sjellje jo të hijshme. Sipas studimit të kryer nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), bashkitë më të prekura nga braktisja e arsimit të detyrueshëm janë Tirana, Korça, Elbasani, Fieri, Durrësi dhe Berati⁴⁷.

Gjithashtu, përqindja e ulët e fëmijëve romë dhe egjiptianë që frekuentojnë arsimin parashkollor i gjen ata të papërgatitur për mjedisin shkollor, duke bërë që të mbeten mbrapa dhe duke braktisur përfundimisht shkollën. Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, 42% e fëmijëve romë të moshës 3-6 vjeç frekuentojnë arsimin parashkollor⁴⁸, krahasuar me afërsisht 50% të fëmijëve në të gjithë vendin⁴⁹. Nuk disponohen statistika për fëmijët egjiptianë.

Rekomandime në kuadër të përmirësimit të situatës së minoriteteve në fushën e arsimit janë:

- Drejtoritë Arsimore Rajonale në përmbushje të detyrimeve që dalin nga Plani Kombëtar i Veprimit të Dekadës së Përfshirjes Rome, 2010-2015, duhet të zbatojnë dhe monitorojnë të gjitha masat e përcaktuara për sigurimin e teksteve dhe mjeteve shkollore falas për fëmijët romë që ndjekin arsimin e detyruar.
- Drejtoritë Arsimore Rajonale duhet të kujdesen dhe të marrin masat e duhura për të evituar veçimin dhe segregimin e fëmijëve romë në zona, shkolla apo klasa të caktuara.
- Drejtoritë Arsimore Rajonale në zbatim të detyrimeve që dalin nga Plani Kombëtar i Veprimit të Dekadës së Përfshirjes Rome, 2010-2015, duhet të zbatojnë dhe monitorojnë të gjitha masat e përcaktuara për të evidentuar numrin e fëmijëve romë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, sipas largësisë së qendrës së banimit me shkollën dhe të bëjnë propozimet pranë institucioneve përgjegjëse për sigurimin e transportit falas për këta fëmijë.
- Shumë prej fëmijëve romë mund të gjenden në situatën kur këta fëmijë nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë. Mjaft e përhapur është edhe situata e braktisjes së shkollës nga ana e nxënësve romë. Për të garantuar të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve romë dhe për të

⁴⁵ Sipas studimit të OSFA-së, 4% e fëmijëve të moshës 6-17 vjeç janë të angazhuar në punë të ndryshme.

⁴⁶ Sipas Anketës social-ekonomike të vitit 2011, 31% e vajzave romë dhe 13,6% e vajzave egjiptiane midis moshës 13 dhe 17 vjeç ishin të martuara.

⁴⁷ OSFA, *Censusi për banesat dhe popullatën romë në Shqipëri*, prill 2014,

eëë.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf

⁴⁸ Të dhëna të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të siguruar në nëntor 2014.

⁴⁹ INSTAT, të dhëna të vitit 2005.

siguruar akses të barabartë, Drejtoritë Arsimore Rajonale duhet të zbatojnë me përparësi për komunitetin romë edhe udhëzimet e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr. 29, datë 02.08.2013 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme” dhe udhëzimin nr. 31, datë 02.08.2013, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë”.

- Masa të veçanta të përkohshme janë ndërmarrë nga shteti shqiptar si përjashtimi i fëmijëve rom nga pagesa e depozitës së garancisë⁵⁰ në Tiranë, nga pagesa e bordeve të prindërve romë në të gjithë vendin, në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët rom në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jo-universitare profesionale, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë (2014 – 2015)⁵¹. Edhe Udhëzimi nr. 21/2014 i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS) për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë ka parashikuar përparësi në regjistrimin e fëmijëve dhe lehtësi në lidhje me regjistrimin e tyre në kopshtet pranë vendbanimit të fëmijës rom. Në këtë kontekst CRCA po zbaton projektin “çdo fëmijë rom në kopësht”, me qëllim integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Ndonëse, kuadri ligjor në fuqi garanton të drejtën për arsimim të shtetasve shqiptarë pa diskriminim për shkak të racës, ky komunitet përballet me probleme dhe barriera të ndryshme në gëzimin de facto të kësaj të drejte. Arsimimi i fëmijëve rom dhe egjiptian përballet me sfida dhe vështirësi të ndryshme. Jetesa në kushte jo të mira banimi dhe infrastruktura e keqe e shton izolimin e tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe luan rol pengues në arsimimin e fëmijëve të tyre⁵². Largësia e shkollave nga vendbanimi, mungesa e mbulimit në praktikë të transportit falas për nxënësit rom, kur shkollat janë më shumë se 2 km larg vendbanimit të tyre, stereotipet se vajzat rome duhet të martohen në moshë të hershme, varfëria në familje janë disa nga problematikat me të cilat përballen fëmijët rom dhe egjiptian. Pengesat institucionale gjithashtu sjellin efekte në arsimimin e fëmijëve rom dhe egjiptian. Pengesat institucionale përfshijnë mungesën e kapaciteteve, cilësinë e arsimit, largësinë e shkollës nga vendbanimi dhe elemente të diskriminimit⁵³.

Pakicat Rome dhe egjiptiane përballen me kushte shumë të vështira të jetesës dhe vuajnë nga përjashtimi social dhe diskriminimi i shpeshtë. Në fushën kundër diskriminimit, është e

⁵⁰ Udhëzimi nr. 21/8.8.2014 “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”

⁵¹ Udhëzimi nr. 34, datë 30.09.2014 “Për kriteret, procedurat e përzgjedhjes, regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, romët dhe egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jo-universitare profesionale, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë (2014 – 2015)”.

⁵² Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri. Tiranë 2012, Ky studim është përgatitur me mbështetjen financiare të Programit Një OKB.

⁵³ Sinani Gj., Taho B., Country Assessment Albania, Roma Education Fund, 2011.

<http://www.romaeducationfund.hu/>

nevojshme që jurisprudenca të zhvillohet më tej. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës mbeten ende të dobëta. Sistemi i drejtësisë për të miturit nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare⁵⁴.

Fëmijët rom kanë qenë në vëmendjen e veprimtarisë së KMD gjatë vitit 2015. Duke i konsideruar problematikat me regjistrimin e fëmijëve rom si shqetësuese dhe që ndikojnë në uljen e aksesit të fëmijëve rom në gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, KMD ka mbajtur një qëndrim aktiv në lidhje me zgjidhjen e tyre. Në shkresën nr. ---Prot, datë ----, *“Dërgohen rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin e vitit shkollor 2015-2016 në sistemin arsimor para-universitar”*, dërguar Ministres së Arsimit dhe Sportit, KMD ka ngritur çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit në shkolla, në lidhje me fëmijët rom dhe egjiptian.

I.2.2. Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuara

Të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara dhe garantimi i tyre në praktikë sanksionohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Është ratifikuar Konventa e OKB-së *“Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”*, me ligjin nr. 108/2012. Konventa *“Për të drejtat e personave me aftësi të Kufizuar”* ka si qëllim të nxisë, mbrojtje dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Disa nga parimet e kësaj Konvente janë parimi i mosdiskriminimit, mundësive të barabarta, pjesëmarrja dhe përfshirja e plotë dhe efektive në shoqëri, etj. Në kuadrin e barazisë dhe mosdiskriminimit, Konventa kërkon nga shtetet palë marrjen e masave specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuar.

Ligji kuadër nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*, ka qëllim nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të PAK në kushte të barabarta dhe pa diskriminim. Një nga parimet që përshkon ligjin është realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cënuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

⁵⁴Progres Raporti i vitit 2015 për Shqipërinë. <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2015&page=1>

Ligji parashikon ngritjen e komisioneve multidisiplinare me qëllim vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe identifikimin e nevojave për shërbime. Gjithashtu, ky ligj parashikon ngritjen e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK), organ këshillimor i cili kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, ndër të cilët 5 përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe 2 të organizatave për personat me aftësi të kufizuara. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*⁵⁵. Pavarësisht se ekziston një kuadër ligjor që garanton të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, zbatimi i këtij kuadri ligjor përbën një domosdoshmëri për të gjithë aktorët përgjegjës. Zbatimi i ligjit të ri kornizë kërkon përmirësime të konsiderueshme në infrastrukturë dhe qasje të barabartë në shërbime⁵⁶. FSHDPAK ka ngritur shqetësimin e mbështetjes financiare në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tij nënligjore⁵⁷. Reformimi i komisioneve aktuale të KMCAP-ve dhe ngritja e komisioneve multidisiplinare dhe në përputhje me modelin bio-psiko-social të Konventës Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara duhet të jetë një nga prioritetet e zbatimit të këtij ligji, pasi në këtë mënyrë do të garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë. Pranë KMD është paraqitur një ankesë në të cilën Subjekti ankues kërkon marrjen e masave së detyrimit të autoriteteve për të bërë vlerësimin e aftësisë së kufizuar të ankuesit si dhe cilat janë ndërhyrjet e nevojshme që duhet të bëhen në infrastrukturë apo programatiken e institucionit në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja efektive dhe e barabartë e tij në aktivitetet kulturore për të cilat ai është kontraktuar dhe vlerësuar si i aftë ti kryejë. Por duhet theksuar se akoma nuk janë ngritur Komisionet Multidisiplinare, kjo e dhënë sipas shkresës së ardhur nga MMRS me Prot. 154.”.

Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* rregullon zbatimin e parimit të barazisë përveç të tjerave edhe në lidhje me aftësinë e kufizuar. Përveç përcaktimeve të diskriminimit të drejtpërdrejtë, diskriminimit të tërthortë, diskriminimit për shkak të shoqërimit, etj, ky ligj përcakton *“Mohimin e një përshtatje të arsyeshme”*⁵⁸ si një formë diskriminimi. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në raportin mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, evidenton probleme në lidhje me garantimin në praktikë të të drejtave të PAK. Në raport theksohet se: *“Një tjetër kategori e cila meriton vëmendje të veçantë janë personat me aftësi të kufizuara. Mosdiskriminimi dhe integrimi i tyre në komunitet është detyrë dhe mision i përbashkët i autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile, duke mundësuar akses, për këtë kategori, në jetën sociale dhe hapësirat e nevojshme për arsimin dhe punësim. Në shkollë vazhdon të ketë ende problem për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, për shkak të mungesës së mjeteve apo infrastrukturës përkatëse, ose pengesave për pranimin e disa të miturve*

⁵⁵ Ligji kuadër nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”*, neni 16, *“Monitorimi”*.

⁵⁶ Komisioni European, Progres Raporti për Shqipërinë 2014. I vlefshëm në www.integrimi.gov.al

⁵⁷ FSHDPAK, Objektivat e programit qeverisës dhe planet për aftësinë e kufizuar. Raport vëzhgimi. Tiranë 2014, fq.23. Ky raport u përgatit me mbështetjen e Civil Rights Defenders.

⁵⁸ Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, neni 3, pika 7.

*që janë me aftësi të ndryshme. Personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të përballen me vështirësi në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale. Përfaqësimi apo përfshirja e tyre në vendim-marrje është ende në nivele të ulëta. Pavarësisht se është miratuar përdorimi i gjuhës së shenjave në mediat vizive, për personat me aftësi të kufizuar në dëgjim, institucionet shtetërore ende nuk kanë sjellë ndonjë përmirësim. KShH vlerëson se raste të tilla, të bëra publike dhe nga mediat si ai në Njësinë Bashkiake Nr. 11 në kryeqytet, ku mbi 1600 invalidë, prej dy muajsh nuk kishin marrë pagesën e paaftësisë, nuk duhet të përsëriten më. Për të garantuar këtë, raste të tilla duhen analizuar me përgjegjësi dhe duhet të shoqërohet me masa disiplinore e ndëshkuese për personat përgjegjës”.*⁵⁹

Ndonëse ligji nr. 7995, dt. 22.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” (i ndryshuar), në nenin 15 parashikon se: “Çdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës të personelit të tij. Inspektorati Shtetëror i Punës kontrollon zbatimin e këtij neni”, por punëdhënësit shpesh nuk e përmbushin këtë detyrim. Nevojitet që Inspektorati Shtetëror i Punës të kontrollojë zbatimin e këtij neni, jo vetëm nga subjektet private, por edhe nga institucionet publike në nivel qendror dhe vendor. Kjo situatë rezulton edhe nga Raporti i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për punësimin e personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) në institucionet e pushtetit qendror e lokal⁶⁰. Nga ky raport ka rezultuar se: 0.17% e të punësuarve në nivel qendror janë PAK nga 2334 nëpunës gjithsej dhe 3.1% e të punësuarve në nivel lokal janë PAK nga 1096 të punësuar gjithsej.

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore në punësim, arsim, transport, qasje në kujdes shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve të tjera shtetërore. Përkundër këtyre ndalesave ligjore, punëdhënësit, shkollat, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe ofruesit e shërbimeve të tjera shtetërore ka raste që janë të përfshirë në diskriminim. Ligji mandaton që ndërtesat e reja të jenë të mundshme për personat me aftësi të kufizuara, por qeveria vetëm në mënyrë sporadike ka zbatuar ligjin . Sipas regjistrimit të vitit 2011, 24% e personave me aftësi të kufizuara nuk kanë vijuar shkollën dhe 65 për qind e personave të tillë ishin femra. Varfëria e përhapur gjerësisht, kushtet e parregulluara të punës dhe kujdesi i dobët shëndetësor përbënin problem domethënëse për shumë persona me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të kufizuar të marrin pjesë në çështjet qytetare edhe pse kufizimet e burimeve dhe mungesa e infrastrukturës ka bërë të vështirë për ta, për të marrë pjesë plotësisht në shumë aktivitete. Qeveria ka ngritur agjenci të shërbimeve sociale për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, por agjencitë shpesh nuk kanë fonde për zbatimin e programeve të tyre. Ligji nuk e kufizon të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar, por qendrat e votimit shpesh janë të vendosura në objekte që nuk krijojnë kushte infrastrukturorë për votim nga ana e tyre. Misioni i OSBE / ODIHR ka raportuar se gjatë zgjedhjeve të qershorit 2013, rreth 44% e qendrave të votimit ishin të pamundura për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.

⁵⁹ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2015.

⁶⁰ Avokati i Popullit, Raport i Veçantë, “Raporti i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për punësimin e personave me Aftësi të Kufizuar (PAK) në institucionet e pushtetit qendror e lokal”, Tiranë 2013.

Në korrik, parlamenti miratoi një ligj kuadër që zgjeron kategoritë e personave me aftësi të kufizuara për ndihmë, nga ana e qeverisë përfshirë ata me autizëm, sindromën Down, dhe paftësi të tjera më pak të njohura zakonisht.

Në qershor, qeveria ndërmoi reforma në programin e mirëqenies sociale në mënyrë që mujore pagesat të ndihmës sociale për familjet të paguhen dhe për gratë, e jo vetëm për kreun e familjes, i cili tradicionalisht është mashkull⁶¹.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248/30.4.2014, “*Programi i nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara*”, krijohen lehtësi për punëdhënësit që punësojnë punëmarrës me aftësi të kufizuara dhe për vetë punëmarrësit me aftësi të kufizuara. Zyra e Punës financon punëdhënësit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara jo vetëm me një financim mujor në masën deri në 100 % të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit, por edhe me një financim për të pajisur siç duhet vendin e punës/transport (përshtatja e arsyeshme) të personit me aftësi të kufizuara dhe për t’i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën. Në kuadrin e këtij programi, Zyra e Punës financon punëmarrësin, punëkërkuesin e papunë, person me aftësi të kufizuara, me një financim mujor në masën deri në 100 % të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi, deri për 6 (gjashtë) muajt e parë të punësimit dhe me një financim mujor në masën deri në 50 për qind të nivelit të pagës minimale në shkallë vendi deri për 6 (gjashtë) muajt e dytë të punësimit. Por, numri i kompanive që kanë përfituar nga ky program është shumë i kufizuar ashtu si edhe vetë numri i punëkërkueseve të papunë që kanë përfituar nga ky program.⁶² KMD në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të punësimit, Tiranë dhe ADRF, kanë qenë për dy vite pjesë e këtij programi, të cilat i kanë dhënë mundësi individëve me aftësi ndryshe të fitojnë eksperiencë pranë këtij institucioni, që kanë rezultuar pjesërisht edhe për punësimin e përhershëm të tyre.

Realizimi i përshtatjes së arsyeshme të ambienteve të punës për personat me aftësi të kufizuara si nga institucionet e pushtetit qendror e lokal ashtu edhe subjektet private është imediate. Përshtatja e arsyeshme e ambienteve të punës për personat me aftësi të kufizuara do të krijonte mundësi të barabarta në marrëdhëniet e punës. Sigurimi në përqindje të ulëta i transportit të përshtatur nga punëdhënësit sjell efekte në punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Politikat e aftësisë së kufizuara nuk do të kuptohen më si politika për pakicat, por objektivat e tyre të bazuara në parimet e barazisë, mosdiskriminimit, përfshirjes dhe vetëvendosjes do të konsiderohen një pjesë e rëndësishme e një përjasjeje të të drejtave civile ndaj politikës, duke qenë të bindur se këto politika kanë një efekt pozitiv jo vetëm për personat me aftësi të kufizuara,

⁶¹ <http://www.state.gov/documents/organization/236704.pdf> Raporti i DASH për Shqipërinë ⁶¹

⁶² Risi Albania, Partner for Growth, MMSR, “Programet për Nxitjen e Punësimit në Shqipëri: vlerësimi i cilësisë së tyre në proceset e formulimit dhe zbatimit (2008-2014)”, Tiranë 2014.
<http://www.kerkojpunë.gov.al/publikime-shkp/>

por edhe për grupe të tjera të shoqërisë, si p.sh. të moshuarit. Kjo politikë është një sfidë e gjithë shoqërisë, sepse ajo duhet të konsiderohet si një detyrë e shoqërisë për të ndërtuar struktura që sigurojnë përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në të gjithat fushat e jetës së përditshme. Aksesit për personat me të kufizuara, përfshinë mundësinë që qytetarët të sigurojnë informacion dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë, si dhe të ndërveprojnë për të përmirësuar jetën. Për t'u përfshirë plotësisht në shoqëri, personat me aftësi të kufizuar kanë nevojë për qasje të plotë.

Në lidhje me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, KMD i ndërgjegjshëm për rëndësinë e garantimit të kësaj të drejte në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, ka rekomanduar marrjen e masave të nevojshme. Kështu, KMD ka dërguar rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin e vitit shkollor 2015-2016 në sistemin arsimor para-universitar, duke rekomanduar në mënyrë urgjente krijimin dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Mungesa e aksesit në hapësirat publike mbetet ende një çështje që kërkon vëmendje. Mungesa e aksesit fizik në disa prej ndërtesave publike shkakton gjithashtu diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në *fushën e të mirave dhe shërbimeve*, veçanërisht mund të çënojë aksesin në institucionet shëndetësore, shërbime të cilat janë jetike për personat me aftësi të kufizuara. Sigurimi i të drejtës së votës është i lidhur ngushtësisht me përshtatjen e arsyeshme të ambienteve të qendrave të votimit. Nevojiten ndryshime në Kodin Zgjedhor me qëllim që të mundësohet votimi i personave me aftësi të kufizuara që nuk dalin nga shtëpia. KMD ka dërguar rekomandim për marrjen e masave ligjore për të siguruar votimin e personave me aftësi të kufizuara që nuk dalin nga shtëpia.

Numri i ankesave nga personat me aftësi të kufizuara ka ardhur duke u rritur në vite, por në raport me situatat diskriminuese me të cilat përballen është i ulët.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka konstatuar se: *“Nga vëzhgimi i situatës konstatohet që PAK e kanë shumë të vështirë inicimin personalisht të rasteve të diskriminimit, kjo marrë në një sërë aspektesh: jo vetëm për shkak që në shumë raste inicimi i një ankese pranë Komisionerit apo në gjykatë është edhe i kushtueshëm nga ana financiare, pasi personat me aftësi të kufizuara kërkojnë më shumë të ardhura që nga moment i daljes nga shtëpia për shkak të jo përshtatshmërisë, apo p.sh. kthimit të ankesës në versionin braille, apo marrjes së përkthyesit të shenjave për personat që nuk dëgjojnë, por nga ana tjetër, jo në çdo*

rast janë të informuar për natyrën dhe mekanizmat ligjorë që duhet të ushtrohen në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen nga diskriminimi”⁶³.

Problematikat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri janë identifikuar edhe përmes shqyrtimit të ankesave dhe çështjeve të nisura me iniciativë nga KMD. Objekti i ankesave që ngrenë pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar lidhet me mohimin e përshtatjes së arsyeshme, ofrimin e të mirave dhe shërbimeve dhe moszbatimin e legjislacionit në lidhje me përfitimin e rimbursimit të tarifës së shkollimit në arsimin e lartë, dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm.

Në lidhje me integrimin e personave me aftësi të kufizuara, gjuha e shenjave u miratua si gjuhë zyrtare për personat e shurdhët. Shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara mbeten të përjashtuar nga shkolla dhe arsimi profesional. Personat me aftësi të kufizuar vazhdojnë të përballen me vështirësi aksesit në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale dhe vendimmarrje⁶⁴.

Mbledhja e të dhënave të përshtatshme statistikore dhe kërkimore për aftësinë e kufizuar, nga INSTAT dhe strukturat e tjera përgjegjëse do të ndihmonte në hartimin e politikave përfshirëse dhe efektive. Tërheqje e vëmendjes së pushtetit gjyqësor ndaj problematikës së PAK. Trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve për trajtimin e rasteve të diskriminimit të PAK.

I.2.3. Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor

Neni klasik i barazisë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë garanton barazinë e shtetasve para ligjit. Komuniteti i Lezbikeve, Gejve, Biseksualëve e Transgjisorëve në Shqipëri, duhet të gëzojë të drejtat kushtetuese si të gjithë individët e tjerë dhe pa diskriminim.

Mbrojtja e të drejtave të personave LGBT është aktualisht pjesë e Udhërrëfyesit për 5 Prioritetet e Rekomanduara nga Komisioni Europian, dhe konkretisht për zbatimin e prioritetit 5 “*Të drejtat e Njeriut*”.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” në nenin 12 të tij ndalon diskriminimin e personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim, neni 17 ndalon çdo dallim, kufizim ose përjashtim në fushën e arsimit dhe neni 20 ndalon diskriminimin e një personi fizik ose juridik, në formën e refuzimit për t’i dhënë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime, ndër të tjera edhe për shkak të orientimit seksual.

⁶³ Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, “*Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e aftësisë së kufizuar*”, Tiranë 2014, fq. 38. Ky raport u realizua me mbështetjen e Civil Rights Defenders.

⁶⁴ Progres Raporti 2015 <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2015&page=1>

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka evidentuar se duhet ndërhyrë në kuadrin ligjor ekzistues për të realizuar një përafrim të legjislacionit ekzistues me Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, gjë që do të rrisë garancitë ligjore edhe për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT⁶⁵. Kështu janë bërë ndryshime ligjore në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës së RSH-së dhe ligje të tjera me qëllim përafrimin e legjislacionit me Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Por, pavarësisht standardeve ndërkombëtare të pranuara, përmes ratifikimit të konventave për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionit të brendshëm, KMD vlerëson se situata e komunitetit LGBTI ka nevojë për përmirësime.

Raporti i Komisionit European për vitin 2015 thekson se: Streha e parë për personat lesbike, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI), u hap në Tiranë në dhjetor. Në maj, kuvendi miratoi rezolutën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, që kërkon një plan veprimi, ndryshime legjislative dhe masa të tjera për të mbrojtur personat LGBTI, dhe bëri Avokatin e Popullit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të tij. Dita Ndërkombëtare Kundër Homofobisë u festua në maj, me një sërë aktiviteteve sensibilizuese megjithatë sensibilizimi publik mbetet i ulët. Shqipëria nënshkroi Deklaratën e Përbashkët të Ministrave të rajonit në forumin IDAHO 2015. Parada e dytë e krenarisë u zhvillua në qershor pa incidente. Diskriminimi ndaj personave transgender dhe ndërgjinorë duhet të hiqet nga legjislacioni.⁶⁶

Organizata jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut kanë ngritur çështje shqetësuese me të cilat përballlet ky komunitet. Kështu, ka pasur ankesa mbi ofrimin e shërbimeve këtij komuniteti, ku dallohet haptazi se ka diskriminim në shërbime si lokale apo ambiente publike. Sidomos këto probleme vërehen më shumë tek komuniteti i Transgjinjorëve.

Personat LGBT vuajnë nga shërbime të dobëta mjekësore dhe psikologjike, duke qenë se sistemi mjekësor shqiptar është shumë i papërgatitur për adresimin e nevojave dhe problemeve të këtij komuniteti. Edhe aksesin nga shërbimet sociale është i kufizuar. Ankesat e paraqitura për shqyrtim pranë KMD dhe çështjet e nisura kryesisht nga institucioni kanë patur si pretendime diskriminimin në lidhje me të drejtat për punësim, arsim dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve apo probleme të garantimit të së drejtës për strehim, komenteve homofobike si edhe shprehjeve kundër martesave gay dhe paradave LGBT. Analiza e çështjes së garantimit de facto të të drejtave të komunitetit LGBTI kërkon të dhëna në lidhje me aksesin e personave LGBTI në punësim, arsim, shërbimet shëndetësore të përfituara, shërbimet sociale, etj, të cilat aktualisht nuk janë të mjaftueshme.

⁶⁵ KMD, RAPORT I VEÇANTE “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”, fq.7.

⁶⁶ Progres Raporti 2015 <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2015&page=1>

Referuar shërbimit shëndetësor, përfaqësues të komunitetit në një studim të realizuar shprehen se: *Ne intervistuar doktorë dhe infermierë që punojnë në shëndetësinë primare. Një nga gjetjet kishte të bënte me perceptimet e doktorëve dhe infermierëve rreth individëve LBT. Gjetëm se perceptimet e doktorëve dhe infermierëve për “identifikimin” e individëve LBT ishin krejtësisht të bazuara në stereotipe: mënyra e veshjes, paraqitja e jashtme, mënyra se si ulen, e kështu me radhë. Me përjashtim të një infermiereje nga Vlora, asnjë nga pjesëmarrësit nuk kishte hasur ndonjë rast dhune bazuar në orientimin seksual. Shumica dërrmuese kishin pak ose aspak informacion mbi abuzimin dhe dhunën me të cilën përballen femrat LBT. Për më tepër, shumica dërrmuese pranuan se burimet e tyre të informacionit përfshinin median (sidomos atë të huaj), internetin, televizionin, ose atë çka kishin dëgjuar nga biseda informale me miq, të njohur, ose informacion të marrë nga disa organizata. Vetëm dy nga 13 doktorët e intervistuar thanë se kishin marrë pjesë në trajnime⁶⁷ që fokusohen në dhunën ndaj LBT⁶⁸. Perceptimet e mësuesve për studentët LBT⁶⁹ bazoheshin gjithashtu në stereotipe: mënyra se si duken, vishen, ecin, flasin, 10 Zvogëlimi i Dhunës ndaj Grave me Fokus në Komunitetin LBT në Shqipëri e kështu me radhë. Dy nga 13 mësuesit e intervistuar, një që jep mësim në qytetin e Shkodrës dhe një në një fshat të Tiranës, përmendën se kishin hasur raste dhune kundër studentëve LBT. Pjesa tjetër e mësuesve nuk kishte hasur raste të tilla. Përgjigja e mësuesit të Tiranës ndaj kësaj dhune ishte që duhej t’i qëndronim pranë studentit. Ajo gjithashtu përmendi faktin se prindërit kishin refuzuar të flisnin për këto çështje kur ishin kontaktuar nga mësuesja. Ndërkohë që në rastin e Shkodrës, mësuesja nuk e kishte referuar rastin askund, sepse, sipas saj, shkolla nuk kishte psikolog, dhe nuk kishte dijeni për ndonjë organizatë që mund të asistonte individët LBT. Mungesa e informacionin rreth organizatave që asistojnë individët LBT u përmend gjithashtu nga pjesëmarrës të tjerë në studim. Për më tepër, sipas mësueses, studenti refuzoi të pranonte orientimin e tij/saj seksual. Problemi i refuzimit nga ana LBT për të pranuar se janë abuzuar për shkak të orientimit të tyre Vetëm tre nga tetë psikologët e intervistuar, kishin identifikuar raste abuzimi ndaj studentëve LBT. Dy nga psikologët, një në Shkodër dhe një tjetër në periferi të Tiranës, kishin identifikuar raste të abuzimit verbal dhe emocional në ambientet shkollore. Një tjetër kishte identifikuar tre raste të abuzimit të studentëve nga familjet e tyre, ku nënat i kishin bërë presion vajzave të tyre për të ndryshuar sjelljen dhe veshjen, në mënyrë që të visheshin në mënyrë më “femërore”.*

Komuniteti LGBTI⁷⁰ përballlet me paragjykime, diskriminim, abuzim verbal dhe fizik. Kjo ndodhte pavarësisht nga qyteti apo komuna. Këto përbëjnë pengesa serioze për individët LGBTI

⁶⁷ Titulli i Projektit ishte: Prurja e Ndryshimit dhe zgjati një vit. Fokusi ishte shpërndarja e informacionit mbi çështjet e abuzimit si edhe dhunës në përgjithësi. Trajnimi i cili ishte pjesë e projektit, targetonte edhe abuzimin, dhe dhunën ndaj LGBT. Trajnimi u krye në tre seanca. Një seancë u krye me stafin. E dyta u krye me personat që ishin pjesë e Mekanizmave të Referimit mbi çështjet e dhunës. E treta u krye me fokus në rastet e dhunës. Pjesëmarrësit në seancën e tretë ishin mësues shkollash. Pas përfitimit të trajnimit, mësuesit do të ktheheshin në shkollë dhe do të raportonin mbi këto diskutime.

⁶⁸ Lezbike, Biseksual dhe Transgjjinor.

⁶⁹ Zvogëlimi i Dhunës ndaj Grave me Fokus në Komunitetin LBT në Shqipëri, vitin e botimit 2015, fq 13.

⁷⁰ Lezbike, Gay, Biseksual, Transgjjinor dhe Interseks, Zvogëlimi i Dhunës ndaj Grave me Fokus në Komunitetin LBT në Shqipëri ALEANCA KUNDER DISKRIMINIMIT LGBT Aleanca LGBT Tiranë, Nëntor 2015.

të cilët janë abuzuar apo i rrezikohen abuzimit për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor, dhe kanë nevojë për asistencë nga institucione shëndetësore dhe arsimore. Të dhënat⁷¹ treguan se duhet të punohet shumë për t'i kthyer këto institucione shëndetësore dhe arsimore. Për sa i përket shëndetësisë, ekziston një nevojë e madhe për t'i informuar doktorët dhe infermierët mbi dhunën kundër LGBTI. Kjo do t'i mundësojë ata të kuptojnë dhe sigurojnë asistencë për individë LGBTI të cilët janë përballur me dhunë në familje. Në mënyrë të ngjashme, mund të thuhet se ekziston nevoja për të rritur informacionin dhe njohuritë e mësuesve dhe psikologëve mbi dhunën dhe mënyrën e sjelljes ndaj këtij komuniteti. Duhet të ndërmerren hapa të vërtetë për t'i kthyer shkollat në institucione më tolerante dhe të hapura, ku individët e abuzuar mund të ndihen të sigurtë dhe të vetëdijshëm se mund të kenë të gjithë ndihmën e nevojshme nga personeli shkollor, mësuesit dhe studentët, miqtë e tyre.

I.2.4. Diskriminimi për shkak të gjinisë

Askush nuk mund të diskriminohet në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Sipas nenit 7 nën titullin 'Mbrojtja nga diskriminimi', përbën diskriminim, çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash. Pra gjinia është një ndër shkaqet për të cilat ofrohet mbrojtje. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Nga Vrojtimi Kombëtar me bazë popullatën, "Dhuna në familje në Shqipëri", rezulton se 59.4 % e grave (më shumë se 1 në 2 gra) janë shprehur se kanë pësuar dhunë në familje në martesë/marrëdhënie intime "gjatë jetës", dhe 53.0 % e grave (1 në 2 gra) po përjetonin dhunë në familje "aktualisht" (brenda 12 muajve para intervistës)⁷².

Barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi janë parime që përshkojnë të drejtën ndërkombëtare dhe legjisllacionin tonë të brendshëm për të drejtat e njeriut. Por, ndërsa barazia është një komponent thelbësor i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, pabarazitë gjinore vazhdojnë të jenë prezente në shoqërinë tonë. Një nga shkeljet më të rënda të barazisë gjinore është dhuna ndaj grave. Dhuna

⁷¹ Lezbike, Gay, Biseksual, Transgjinor dhe Interseks.

⁷² INSTAT, Vrojtım Kombëtar me bazë popullatën, "Dhuna në Familje në Shqipëri", 2013, fq.33.

ndaj gruas është një formë e diskriminimit e cila i ka rrënjët në pabarazinë gjinore dhe e përforcon atë. Në aktet ndërkombëtare në nivelin e OKB, nivelin e Këshillit të Evropës dhe të drejtës së BE përfshihen akte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.

Në qershor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë publikoi një përmbledhje për rishikimin e rasteve të dhunës në familje në 38 gjykata dhe rekomandoi ndryshimet në ligjin dhe praktika gjyqësore. Ata konstatuan se procedurat gjyqësore për raste të tilla kriminale ngadalësoheshin nga gjykatat duke shkelur afatet kohore për shqyrtimin dhe lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Deri në fund të shtatorit 2015 janë numëruar 3094 incidente të dhunës në familje të raportuara në polici, ndërsa gratë përbëjnë shumicë e viktimave. Pak më shumë se një e treta (1.292) të këtyre raportimeve përbëjnë vepra penale kriminale. Deri në fund të shtatorit, 1882 gra kanë kërkuar urdhra mbrojtjeje nga gjykata. Në Tiranë për shembull më shumë se 2/3 e kërkesave për urdhra mbrojtjeje janë tërhequr ose ndërprerë. Edhe aty ku janë lëshuar urdhra mbrojtjeje, ato nuk zbatohen⁷³.

Si rrjedhojë e roleve stereotipike gjinore dhe e diskriminimit, femrat janë dukshëm në pozitë të pafavorshme, që karakterizohet nga pjesëmarrja e ulët në forcën e punës dhe nga një shkallë e lartë pasiviteti, që shkaktohet prej roleve të tyre të paracaktuara si ofrueset parësore të përkujdesjes brenda familjes. Mungesa e politikave që mbështesin balancimin e punës dhe përgjegjësisive familjare për gratë, i pakëson punësimin dhe mundësitë e tyre të 58 Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi karrierës, si edhe i vendos ato në profesione më të ulëta dhe më pak të paguara, kushte të cilat ruajnë ose përforcojnë stereotipat gjinorë në punësim. Megjithatë, pasojat e ndarjes gjinore në programet arsimore, mundësitë e kufizuara për punësim, vendet e punës me produktivitet të ulët, hendeku i zgjeruar në paga, dhe përjetësimi i roleve gjinore që pengojnë aktivitetin ekonomik të femrave, emancipimin dhe fuqizimin e tyre, shpesh nuk kuptohen plotësisht nga vendimmarrësit. Sidoqoftë, politikat që shpërfillin faktorin “gjini” çojnë drejt uljes së produktivitetit, shtimit të pabarazisë dhe në fund të fundit drejt thellimit të varfërisë, duke kufizuar ose duke shkurajuar pjesëmarrjen e forcës femërore të punës. Nga ana tjetër, një gjë e tillë bën që për shembull, sistemi aktual i AFP-së e përforcon ndarjen gjinore në vend që të parandalojë. Politikat e ndjeshme ndaj faktorit gjinor dhe aktivitetet e qëllimta, të cilat synojnë zvogëlimin e këtyre kufizimeve dhe krijojnë kushtet në të cilat si femrave ashtu dhe meshkujve u ofrohen mundësi të barabarta për përfshirje në arsimim dhe ekonomi, përbëjnë një nevojë më se të qartë⁷⁴.

KMD ka kontribuar në përbërje të Grupit Ndërministror të Punës, ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr.112/2014, në përgatitjen e Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, miratuar me VKM

⁷³ <https://www.amnesty.org/en/latest/research/2015/02/annual-report-201415>

⁷⁴ http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/15-01-14-02-54-

53Strategjia__Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi,__Plani__Veprimit_24_11_2014_(KM).pdf

nr. 806, datë 26.11.2014. Përmes materialit të dërguar për përgatitjen e këtij raporti, KMD ka ngritur disa shqetësime me të cilat përballen gratë në Shqipëri: *Në fushën e të mirave dhe shërbimeve*, gratë përballen me pabarazi dhe forma të drejtpërdrejta e të tërthorta diskriminimi. Diskriminimi në ofrimin e shërbimeve, furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, ka sjellë në vëmendjen e KMD-së, nevojën për një rishikim të kontratave tip të hartuara nga entet rregullatore, sidomos dispozitat mbi “*klientin familjar*”, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kush përfshihet në këtë koncept. Për këtë qëllim KMD i ka dërguar rekomandim kompanisë CEZ Shpërndarje Sh.a, për rishikimin e kontratës tip, me qëllim shmangien e trajtimit të pabarabartë mes burrave dhe grave në ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike⁷⁵. Përmes këtij rekomandimi, KMD synon që vendimet që janë marrë në lidhje me çështjen konkrete, të kenë një rëndësi strategjike dhe të ndryshojnë, jo vetëm situatën në të cilën ndodhet një grua, por situatën e grave dhe vajzave si grup gjinor. Nga shqyrtimi i ankesave nga KMD rezulton se *objekti i ankesave me pretendim diskriminimi për shkak të gjinisë, përgjithësisht ka qenë mosrespektimi i të drejtave në fushën e të mirave dhe shërbimeve, në fushën e punësimit si nga institucionet publike ashtu dhe subjektet private.*

Akresi i grave në përfitimet nga skemat sociale dhe ekonomike, lë për të dëshiruar. Vitet e fundit janë ndërmarrë masa pozitive për fuqizimin e grave, kryesisht në sektorin ekonomik. Megjithatë vihet re se sipas të dhënave nga INSTAT sa më të mëdha bëhen ndërmarrjet, aq më shumë ulet përqindja e femrave që i drejtojnë ato. Vetëm 14,4% e ndërmarrjeve me 50 e më shumë të punësuar menaxhohen nga femrat, ndërkohë që 29% e ndërmarrjeve me 1-4 punëtorë drejtohen nga femrat, që përgjithësisht janë dyqane veshjesh, ose tregtimi ushqimor, parukeri, estetikë etj. Numri më i madh i femrave në nivele drejtuese është mbizotërues në kryeqytet. 30,4% e ndërmarrjeve në Qarkun e Tiranës menaxhohen nga femrat, ndërsa përqindja më e ulët është në Qarkun e Kukësit, me 15,1%. Femrat kanë qenë aktive në biznes edhe gjatë vitit të kaluar. 29,3% e ndërmarrjeve të krijuara gjatë vitit 2013 menaxhohen nga femrat. Së fundmi Qeveria ka hartuar “*Planin e veprimit për sipërmarrjen e grave në Shqipëri, 2014-2020*”. Ky plan parashikon, ndër të tjera, hartimin e projekt-vendimit “Për krijimin e fondit në mbështetje të grave sipërmarrëse”, ku mbështetja parashikohet për një periudhë zbatimi për 4 vjet, me vlerë totale 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë. Zbatimi i skemës filloi në vitin 2014 me vlerë 2.500.000 lekë.

Ndërkohë që gratë nuk arrijnë të kenë përfaqësinë e duhur në postet menaxheriale, numri i tyre në poste të mesme është rritur shumë në 20 vitet e fundit. Këtë përfundim e ka nxjerrë studimi më i fundit i Organizatës Ndërkombëtare për Punonjësit (ILO).

⁷⁵ Rekomandimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi drejtuar Entit Rregullator të Energjisë, për rishikimin e kontratës tip mbi “*Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë*”.

Aksesi i kufizuar i grave, në format e kreditit financiar, është i lidhur ngushtësisht edhe me një praktikë të përhapur në shoqërinë tonë, ku prona regjistrohet më së shumti në emër të mashkullit, i cili vepron edhe në cilësinë e kryefamiljarit. Pikërisht për aksesin e grave në prona, hua dhe kredi, është realizuar në vitin 2012 nga UN Women, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, një studim mbi të drejtat pronësore të grave në Shqipëri, në të cilin është konstatuar e njëjta problematikë: “... E drejta për pronë është një e drejtë themelore. Të dhënat tregojnë se në praktikë kjo e drejtë nuk gjejnë zbatim të barabartë për burrat dhe gratë. Ndodh që të afërmit e tyre, familjarët, ose autoritetet shtetërore u cënojnë këto të drejta. Madje dhe vetë gratë i mohojnë vetvetes të drejtat e tyre dhe nuk i kërkojnë ato. Prandaj ndërgjegjësimi i tyre për të kërkuar të drejtat që u njih ligji mbi pronën mbetet një detyrë për të gjithë...”⁷⁶.

KMD ka ngritur shqetësimin se pavarësisht arritjeve në shfuqizimin e ligjeve diskriminuese ende mbetet për të bërë në këtë drejtim. Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, në nenin 4 pika 10, vendos një kriter diskriminues bazuar në gjininë e personit përmes përkufizimit që bën për termin “Kryetar të familjes”, duke vendosur babain në krye të hierarkisë, për t’u cilësuar kryetar familje e për pasojë edhe si personi që përfiton ndihmën ekonomike. Sipas renditjes që bën ky ligj, automatikisht kryefamiljar është burri dhe vetëm në mungesë të tij radha kalon tek gruaja-nëna. Komisioneri në zbatim të kompetencave të tij, ka përgatitur rekomandimet përkatëse për ta sjellë këtë ligj në përputhje me Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁷⁷. Kjo çështje është konstatuar edhe në Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, i cili ka bërë thirrje për fuqizimin e përdorimit të masave të përkohshme dhe të veçanta, në pajtim me Nenin 4, paragrafi 1, të Konventës CEDAW. Ky Komitetet ka rekomanduar që: “Masat e përkohshme dhe të veçanta të zbatohen me qëllim që të sigurojnë barazinë e grave dhe burrave në mundësimin e pasurisë, kapitalit dhe kredive, shërbimeve të kujdesit shëndetësor, strehimit dhe në përgjithësi të gjithë përbërësit e një standardi të përshtatshëm të jetesës, veçanërisht në lidhje me gratë që u përkasin grupeve të privuara, duke përfshirë gratë dhe vajzat që u përkasin minoriteteve gjuhësore dhe etnike, gratë e moshuara, gratë me aftësi të kufizuara, dhe gratë që banojnë në zonat rurale dhe të largëta.”⁷⁸.

Në vitin 2009, Parlamentin Shqiptar u zgjodhën 23 gra, ndërkohë që në vitin 2005 në Kuvendin e Shqipërisë kishte vetëm 10 gra deputete. Kemi një rritje nga 7.1 % në 16.4 %. Vendi që mbanin kandidatet gra në listë influenconte suksesin e tyre.⁷⁹ Në zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit 2013, u zgjodhën 25 gra deputete nga 140 gjithsej, ose 18%, me një rritje prej 11% në

⁷⁶ Të drejtat pronësore dhe gruaja. Broshurë informuese. Tiranë, 2014

⁷⁷ Raporti Vjetor i KMD, 2014

⁷⁸ Vërejtje Përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, par.23, Sesioni i dyzetëegjastë 12- 30 korrik 2010.

⁷⁹ Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve “Zgjedhjet Parlamentare, 28 qershor 2009”

krahasim me vitin 2005 dhe gati 2% në krahasim me vitin 2009. Kjo shifër tregon progres në përfaqësimin e grave në politikë, megjithëse duhen hapa të mëtejshëm për të garantuar barazinë reale midis burrave dhe grave.

Duhet theksuar fakti se, me gjithë angazhimin për vendosjen e kuotës gjinore, sipas parashikimeve në nenin 67/6 të Kodit Zgjedhor, në praktikë një parashikim i tillë tregoi se kishte një boshllëk ligjor. Nisur nga kjo, KMD ka dërguar Rekomandim për rishikimin e këtij neni dhe zbatimin e qëllimit për të cilin është parashikuar kjo masë pozitive në Kodin Zgjedhor⁸⁰. Formula e vendosur për listat shumë emërore të kandidatëve “*të paktën tridhjetë për qind e listës shumëemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëemërore duhet t’i përkasë secilës gjini*”, nuk ka garantuar respektimin e kuotës gjinore prej 30%. Lidhur me këtë problematikë dhe më gjerë, Komisioneri përgatiti dhe i dërgoi Kuvendit të Shqipërisë një rekomandim legjislativ, gjatë muajit qershor të vitit 2014.

Barazia gjinore, është minuar nga funksionimi i dobët i mekanizmave për të adresuar barazinë gjinore dhe dhunën gjinore. Sistemi online për raportimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës gjinore vazhdon të jetë funksional në 29 nga 61 bashki. Numri i raportimeve të shkeljeve të rënda dhe rastet e dhunës në familje ndaj grave janë shtuar, duke treguar rritje të besimit në sistem, por pjesa më e madhe e çështjeve vazhdon të mbetet e pa raportuar. Numri i procedimeve penale për dhunën në familje është rritur. Gjykatat kanë filluar të ndjekin penalisht raste të dhunës në familje më efektivisht - veçanërisht në Tiranë. Numri i strehave kombëtare dhe shërbimet e ri-integrimit kanë nevojë të rriten, dhe strehat ekzistuese vullnetare mbeten për t’u mbështetur nga autoritetet. Për shkak të burimeve të pakta financiare dhe njerëzore, mekanizmi kombëtar i referimit për dhunën në familje është funksional në shumë pak bashki, dhe aplikon kriteret pranimit që s’ka pse të jenë aq të shtrënguara. Shërbimet për viktimat e dhunës në familje duhet të përmirësohen në cilësi, sasi, aksesueshmëri dhe shpërndarje gjeografike dhe duhet të bëhet më shumë punë për ri-integrimin dhe fuqizimin ekonomik⁸¹.

Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të shfuqizuar dispozitat diskriminuese me bazë gjinore në disa sektorë si edhe për të adresuar paragjykimin gjinor në vendimet e gjykatave dhe institucionet ligjzbatuese. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor u miratuan në prill dhe sigurojnë 50% kuota gjinore si kusht për listat e kandidatëve në këshillat bashkiakë, dhe refuzimin e listave të cilat nuk përmbushin këtë kuotë. Dhjetë për qind e kandidatëve për kryebashkiakë në zgjedhjet elektorale të qershorit, ishin gra dhe nëntë gra u zgjodhën si kryebashkiake, duke shënuar një rritje të konsiderueshme. Në 2015, nga 140 deputetë të Kuvendit, 29 ishin gra (21%)⁸².

Ndryshimet e bëra së fundmi në Kodin Zgjedhor, me ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, në nenin 67, pika 6 përcakton: “*Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës*

⁸⁰ Rekomandim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*”, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012

⁸¹ Progres Raporti 2015 <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2015&page=1>

⁸² Progres Raporti 2015 <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2015&page=1>

shumemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaroi vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimit e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaroi vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimit e përjashtimit, sipas paragrafit të dytë të pikës 2, të nenit 164 të këtij Kodi". Po ashtu neni 164, pika 2, lidhur me kalimin e mandateve parashikon: "Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë të gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk aplikohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar".

Duke vëzhguar listat e këshilltarëve të zgjedhur në Zgjedhjet Vendore 2015, rezultoi se pavarësisht ndryshimeve ligjore të Kodit Zgjedhor (Miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015), në shumë bashki të vendit numri i grave të zgjedhura lë për të dëshiruar por duhet theksuar se në disa bashki si Durrësi ka numrin më të madh me 26 gra këshilltare të zgjedhur në Zgjedhjet Vendore 2015. Në disa qarqe numri i grave është i papërfillshëm.⁸³ Kështu në Bashkinë e Bulqizës janë vetëm 3 gra këshilltare të zgjedhura. Vërejmë se dhe në rang qarku numri i grave është në një diferencë të theksuar me burrat. Kjo është lehtësisht e kuptueshme nga një vërtetim i përgjithshëm që mund të bëjmë listave të Këshilltarëve vendor.

I.2.5. Diskriminimi i shumëfishtë

Edhe rastet e individëve që përjetojnë diskriminim për më shumë se një shkak janë prezente. Raporti i Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri ngre disa shqetësime në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi të grave me aftësi të kufizuara, grave të moshuara, grave LGBT, grave rome dhe egjiptiane, etj. Përballja e tyre me diskriminimin mund të ngrejë në të njëjtën kohë çështje të diskriminimit për shkak të moshës dhe gjinisë, ose racës dhe gjinisë, ose racës dhe gjendjes ekonomike, etj.

⁸³ http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210_-_DTI_-_keshilltaret_2015.htm

KAPITULLI II

VEPRIMTARIA E KMD-SË NË MBROJTJEN NGA SJELLJET DISKRIMINUESE DHE PROMOVIMIN E BARAZISË

II.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim

Bazuar në Ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, asistenca ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

1. Shqyrtimit të çështjeve nga KMD;
2. Asistencës së viktimave në gjykatë.

II.1.1. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD

Bazuar në **Ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë: të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi; të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues; të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

II.1.1.1. Procedura e shqyrtimit të ankesave

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal (neni 33 i ligjit). Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim si dhe shpjegime dhe fakte që disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri. Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij. Komisioneri nuk vepron për ankesat anonime.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t’u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të ligjit. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni

lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspektime apo seanca dëgjimore mes paleve. Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar ne procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim pas 90 ditëve nga data e ardhjes se ankesës, apo e seancës dëgjimore, nëse është zhvilluar një e tillë. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas Kodit të Procedurës Civile.

II.1.1.2. Çështjet e trajtuara nga KMD gjatë vitit 2014

Në periudhën nga 1 janar 2015 deri në 31 dhjetor 2015, KMD ka trajtuar gjithsej **288 çështje**, (268 ankesa dhe 20 çështje ex-officio). Nga këto 197 (180 ankesa dhe 17 çështje ex-officio) të regjistruara në vitin 2015, si dhe 91 (88 ankesa dhe 3 çështje ex-officio) të mbartura nga viti 2014. KMD ka dalë me vendim për 169 çështje të trajtuara gjatë vitit 2015, duke dhënë vendim për çështjet e mbartura nga viti 2014, si dhe duke vendosur sanksione me gjobë për 14 çështje, për mosplotësim të rekomandimeve të Komisionerit apo edhe kur nuk është dhënë informacion nga ana e subjekteve.




Tabela 1. Ndryshimi i numrit të çështjeve të shqyrtuara nga KMD ndër vite

II.1.1.3. Ankuesit

Bazuar në nenin 32, pika 1/a/b, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesit janë: individ, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime.

Gjatë vitit 2015, ka filluar shqyrtimi i 180 ankesave, nga të cilat 170 janë nga individ të ndryshëm, 7 kanë ardhur nga organizata me interesa legjitime dhe 3 ankesa janë paraqitur nga grupe personash.




Tabela 2. Tabela sipas ankuesve

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2015 përveç ankesave individuale, janë paraqitur edhe 7 ankesa nga organizata me interesa legjitim dhe 3 ankesa nga grupe personash. Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e komunitetit rom, egjiptian në fushën e arsimit etj. Falë bashkëpunimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe këtyre organizatave, për disa prej ankesave të ngritura prej tyre nga Komisioneri janë dhënë rekomandime në fushën e arsimit, për rivendosjen e të drejtës së shkelur, të cilat janë zbatuar, ndërkohë që disa prej tyre janë zgjidhur me ndërmjetësim. Vlen të theksohet fakti se, këto bashkëpunime kanë qënë mjaft të efektshme për evidentimin e rasteve të pretenduara për diskriminim, ndërgjegjësimin e përmirësimin e situatave. Në disa raste informacioni i sjellë nga organizatat e shoqërisë civile ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për inicimin kryesisht të çështjeve.

II.1.1.4. Shpërndarja rajonale e ankesave

Edhe gjatë vitit 2015 ka pasë një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminim, të paraqitura pranë KMD-së. Qytetet nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave me pretendim diskriminim pranë KMD-së janë Korça, Pogradeci, Tirana, Elbasani, Lezha, Fieri, Mati dhe zonat përreth tyre.

II.1.1.5. Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara

Ligji nr.10221,datë 04.02.2010“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënie, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër(neni 1).

Në Zyrën e KMD-së, për vitin 2015 janë paraqitur ankesa për shkaqet e parashikuara në ligj, por ka pasë dhe ankesa në të cilat subjektet nuk ishin në gjendje të identifikonin shkaqet. Duhet theksuar se ligji ka parashikuar një listë të hapur të shkaqeve duke përfshirë dhe rastet “çdo shkak tjetër”, duke patur parasysh këtu shkaqe që lidhen me cilësi individuale të personave. **Në disa prej ankesave të ardhura pranë zyrës së Komisionerit subjektet kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi.**

Më poshtë do gjeni të pasqyruar tabelën me shpërndarjen e ankesave të vitit 2015 të ndarë sipas shkaqeve:

• Gjinia	9
• Raca	88
• Ngjyra	4
• Etnia	12
• Gjuha	1
• Identiteti gjinor	1
• Orientimi seksual	4
• Bindja politike	14
• Bindja fetare	1
• Gjendja ekonomike	26
• Gjendja arsimore	17
• Gjendja shoqërore	5
• Shtatzënia	4
• Mosha	7
• Gjendja familjare	7
• Gjendja martesore	2
• Gjendja shëndetësore	15
• Aftësi e kufizuar	17
• Përkatësia në grup të veçantë	5
• Çdo shkak tjetër	23

Siç shihet, raca vazhdon të mbetet shkaku kryesor për të cilin pretendohet diskriminim, por ka një rritje të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, shtatëzaniisë dhe moshës. Mbeten në të njëjtin nivel ankesat për diskriminim për shkaqet e orientimit seksual, aftësisë së kufizuar dhe gjendjes martesore.



Tabela 3. Pasqyrimi në përqindje e shpërndarjes së shkaqeve sipas ankesave

➤ **Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të racës⁸⁴**

Për vitin 2015 janë trajtuar 88 ankesa dhe 7 çështje të nisura kryesisht me iniciativë të Komisionerit me pretendim diskriminim për shkak të racës. Duhet të theksohet fakti se ankesat individuale janë marrë kryesisht gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ditëve të hapura që Komisioneri ka organizuar me grupe të komunitetit Rom dhe Egjiptian në rrethe të ndryshme të vendit. Organizimi i ditëve të hapura, ka qënë një komponent i projekteve ndërjegjësuëse të KMD-së, ku komuniteti Rom dhe Egjiptian ka qënë në fokus dhe është informuar lidhur me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kompetencat dhe mënyrën se si mund të ankohesh pranë institucionit të Komisionerit. Mbështetur në informacionin e grumbulluar në këto takime, KMD ka dërguar rekomandime drejt institucioneve përkatëse për problematikat e ngritura nga ky komunitet.

⁸⁴ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

Problematikat e parashtruara në këto ankesa kanë të bëjnë me pretendimet për: mospërfitim në mënyrë të padrejtë të trajtimit me ndihmë ekonomike sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, caktimit jo korrekt të masës së përfitimit së ndihmës ekonomike, ndërprerjes së ndihmës ekonomike⁸⁵, probleme të trajtimit jo të barabartë në fushën e punësimit si në sektorin shtetëror ashtu dhe në atë privat, të nënvlerësimit të ankesave të bëra nga ky komunitet si dhe ankesa në drejtim të autoriteteve vendore në drejtim të respektimit të së drejtës së tyre për strehim dhe mosprishjes së banesave të tyre që janë në proces legalizimi.

Bazuar në ankesat vërejmë se pjesëtare të këtij komuniteti ankohen për diskriminim në fushën e punësimit, strehimit, arsimit, të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe në atë të shërbimeve.

Gjatë vitit 2015 ka përfunduar shqyrtimi i çështjeve për 62 ankesa të bëra nga subjektet dhe 5 çështje të nisura kryesisht nga Komisioneri⁸⁶. Në përfundim të shqyrtimit të këtyre ankesave janë dhënë vendimet sipas tabelës së mëposhtme:

Gjithashtu për vitin 2015 janë paraqitur një numër ankesash me shkak racën, të cilat nuk janë pranuar për shqyrtim, pasi nuk plotësonin kriteret që parashikon ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, por për këto raste Komisioneri ka sugjeruar dhe rekomanduar që subjektet ankuese t’i drejtohen institucionit kompetent. Në 45 raste është konstatuar mosdiskriminim dhe kjo në shumicën e rasteve për shkak se ankuesit pretendojnë diskriminimin për ushtrimin e të drejtave për të cilat nuk kanë ndjekur aplikimet dhe procedurat e duhura ligjore. KMD në disa raste, ka ofruar asistencë për komunitetin rom dhe egjiptian, në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike, për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkolla, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin nga banesat sociale, dhe përfitimin nga tarifat studentore, etj.

Vihet re, që vazhdon të jetë i pranishëm diskriminimi i strukturuar që nuk i referohet një individi, por të gjithë grupit. Nga analiza e bërë mbi rastet e trajtuara, evidentohet se anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, nuk janë të mirë informuar për të drejtat dhe shërbimet që përfitojnë apo rrugët për të siguruar këto shërbime.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, nga Shoqata “Qëndistarët”, Korçë dhe nga Qendra Evropiane për të Drejtat Rome në Shqipëri, pretendohet se në Shkollën 9-vjeçare “Naim Frashëri” Korçë, prej disa vitesh regjistrohen vetëm fëmijë të cilët i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare kanë ofruar për fëmijët e

⁸⁵ Pavarësisht se nuk ka ndryshuar situata dhe kushtet e aplikimit

⁸⁶ Ndërkohë, në 1 rast subjekti ankues ka tërhequr ankesën, në 13 raste çështjet nuk janë pranuar, në 1 rast është dhënë vendim me gjobë për mosdhënie informacioni dhe në 2 raste është pushuar shqyrtimi i ankesës për shkak të pamundësisë.

shkollës, në mënyrë të veçantë për fëmijët me probleme të forta ekonomike dhe sociale, ushqim, veshje dhe bazë materiale. Si rezultat i ofrimit të këtyre kushteve, numri i fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian ka ardhur në rritje deri në momentin që në këtë shkollë mësojnë vetëm fëmijë të këtyre dy komuniteteve. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave nëpërmjet vendimeve të tij, ka parashikuar bursa dhe kuota ushqimore vetëm për fëmijët rom dhe egjiptian të kësaj shkolle. Ofrimi i një vakti ditor për nxënësit, ka rritur në dukje frekuentimin e shkollës, por në të njëjtën kohë ka bërë që vetëm nxënësit e këtij komuniteti të regjistrohen në këtë shkollë. Në këtë mënyrë, veçimi i fëmijëve të këtij komuniteti, mund të sjellë një numër më të madh të fëmijëve, të cilët nuk vijnë më tej studimet, rezultate të ulta etj. U konstatua se DAR Korçë, pavarësisht faktit se ka qenë në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe ka qenë e ndërjegjeshme që zbatimi i këtij projekti pilot, ka patur efekt segregimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në shkollën “Naim Frashëri”, nuk ka njoftuar MAS për efektet që ka sjellë zbatimi i këtij projekti. DAR Korçë me veprimet dhe mosveprimet e saj ka bërë që fëmijët e këtyre dy komuniteteve të vihen përballë një situatë segregimi apo veçimi. Ndërkohë që edhe fëmijët që nuk janë pjesë e këtij komuniteti dhe vijnë nga familjeve në nevojë, janë ndjerë të diferencuar në trajtim dhe si rezultat gradualisht janë larguar nga kjo shkollë.

Komisioneri, konstatoi se nuk ka një tendencë të veçimit apo përqendrimit të fëmijëve rom në një shkollë të vetme, por Vendimet e Këshillit të Ministrave të miratuara çdo vit, të paanshme në dukje, kanë sjellë si pasojë veçimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në një shkollë dhe diskriminimin e tyre për shkak të racës dhe etnisë. Komisioneri vendosi: **konstatimin e diskriminimit të tërthortë të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian të Shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, për shkak të racës dhe etnisë, nga MAS dhe DAR Korçë; detyrimin e MAS dhe DAR Korçë të marrë masa të menjëhershme, me qëllim përmirësimin e situatës dhe ndryshimin e raportit të nxënësve që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe komuniteteve të tjera, në Shkollën “Naim Frashëri”, Korçë; detyrimin e MAS dhe DAR Korçë, të marrin masa të menjëhershme për sensibilizimin e stafit të institucioneve arsimore në varësi, në mënyrë që të shmangët veçimi apo segregimi i fëmijëve rom/egjiptian në shkolla apo klasa të caktuara. Në zbatim të rekomandimit të KMD-së, MAS dhe DAR Korçë informoi dhe vuri në dispozicion të gjithë materialin me anë të të cilit pasqyroheshin hapat e ndërmarrë nga këto institucione.**

Shoqata “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, informon Komisionerin, se nga verifikimet e bëra prej tyre në terren, janë evidentuar disa probleme dhe vonesa në procesin e shpërndarjes së teksteve falas për komunitetin rom dhe egjiptian. Në këto kushte, procesi i shpërndarjes së teksteve ka patur probleme në të gjitha shkollat e rrethit të Gjirokastrës, ku ndjekin procesin mësimor fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, pasi deri në fillim të muajt Tetor 2015, ata nuk ishin të pajisur me tekste shkollore. Përsa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, filloi procedurën e shqyrtimit kryesisht të çështjes së shpërndarjes së librave falas për vitin

shkollor 2015-2016, për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, në shkollat 9-vjeçare në rrethin e Gjirokastrës. Nisur nga dinamika e ngjarjeve, si dhe nga informacionet e marra nga DAR Gjirokastër, përfaqësues të Shoqatës "Observatori për të Drejtat e Fëmijëve", dhe prindër të komuniteti rom e egjiptian, rezultoi që kjo situatë pas ndërhyrjes së Komisionerit u zgjidh, pasi procesi mësimor vijoi normalisht dhe nxënësit ishin pajisur me tekste shkollore falas.

Komisioneri ka vendosur konstatimin e diskriminimit të tërthortë, të kategorisë së nxënësve romë dhe egjiptianë, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe që përfitojnë të pajisen me tekste shkollore falas, për shkak të dërgimit me vonesë të tyre pranë shkollave të arsimit 9-vjeçar, të rrethit të Gjirokastrës, si dhe ndërprerjen e procedurës hetimore, për shkak se pas ndërhyrjes së Komisionerit, situata është zgjidhur në favor të kategorisë së nxënësve romë dhe egjiptianë. Komisioneri u ka rekomanduar DAR Gjirokastër dhe Drejtorive të shkollave të arsimit 9-vjeçar të rrethit të Gjirokastrës, në bashkëpunim me shtëpitë botuese përkatëse, të marrin masa që për vitin e ardhshëm akademik, pajisja me tekste falas për kategorinë e nxënësve romë dhe egjiptianë, të bëhet në kohë, duke shmangur çdo vonesë të mundshme që ndikon në fillimin dhe ecurinë normale të procesit mësimor.

➤ **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2015 ka trajtuar, 11 çështje (10 ankesa dhe 1 çështje të nisura kryesisht), për shkak të aftësisë së kufizuar, nga të cilat në 4 ankesa është konstatuar diskriminim⁸⁷.

Ankesat me pretendim diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar ndër të tjera kishin të bënin me mohimin e përshtatjes së arsyeshme, për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve dhe moszbatimin e legjislacionit në lidhje me përfitimin e rimbursimit të tarifës së shkollimit në arsimin e lartë.

Shtetasi A. S. është invalid paraplegjik dhe për shkak të gjendjes shëndetësore të tij, është i detyruar që të bëjë kontrole periodike pranë Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve, Paskuqan, Tiranë. Qendra Shëndetësore ka një rampë, për të cilën A.S. pretendon se është e papërshtatshme për shfrytëzimin e saj nga personat me aftësi të kufizuara dhe e ndërtuar në kundërshtim me standartet e kërkuara. Edhe pse ndërtesa e qendrës shëndetësore, sipas informacionit të depozituar nga ana e A. S., ka qënë objekt rikonstruksioni, nuk është marrë parasysh përshtatja e infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara. Ankuesi për të aksesuar në poliklinikë i duhet gjithmonë të kërkojë ndihmë, çka çënon në mënyrë të drejtëpërdrejtë

⁸⁷ Ndërkohë, në 2 ankesa është konstatuar mosdiskriminim, në 3 raste ankesat nuk janë pranuar, në 2 raste në bashkëpunim me institucionet përkatëse është arritur qëllimi për të cilin ishte bërë ankesa.

pavarësinë e tij dhe e vendos atë në kushte denigruese.

Mjediset e brendshme të qendrës shëndetësore janë gjithashtu të papërshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Në këto kushte konsulta mjeksore realizohet formalisht në koridoret e qendrës shëndetësore dhe në prani të pacientëve të tjerë që ndodhen aty. U konstatua se në Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve Paskuqan, pavarësisht faktit që i gjithë stafi mjeksor dhe personeli, ishin vënë në dijeni që personave me aftësi të kufizuara ti ofrohet shërbimi në ambjentin e caktuar në katin e parë të ndërtesës, në ambjentet e qendrës shëndetësore nuk ishte afishuar asnjë njoftim për të orientuar personat me aftësi të kufizuara, lidhur me ambjentin në të cilin ku do t'i ofrohet shërbimi.

Komisioneri gjykoj se ankuesi dhe të gjithë individët me aftësi të kufizuara, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e Qendrës, për shkak të aftësisë së kufizuar. Komisioneri gjykoj se Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Paskuqan, duhet të kishte marrë masat që personave me aftësi të kufizuara t'u krijoheshin kushtet e përshtatshme për të aksesuar në mënyrë të barabartë me të tjerët ambjentet e qendrës shëndetësore. Pas vendimit të dhënë nga KMD, nga ana e Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve Paskuqan, u morën masat e menjëhershme për modifikimin e rampës dhe përshtatjen e saj për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuara.

➤ **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të gjendjes ekonomike**

Numri i çështjeve për të cilat KMD ka dalë me vendim, gjatë vitit 2015, me pretendim diskriminim për shkak të gjendje ekonomike është 7 (shtatë), nga të cilat për 5 (pesë) prej ankesave është konstatuar diskriminim⁸⁸.

Shtetasi O. S. sqaron se i përket komunitetit Rom/Egjiptian. Familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike në masën 4300 lekë në muaj dhe bashkëshortja për shkak të një sëmundje të rëndë është e paaftë për punë. Ankuesi dhe pjestarët e tjerë të familjes janë të rregjistruar në Zyrën Rajonale të Punësimit Elbasan, si punëkërkuar të papunë, por ende nuk janë punësuar. Ndërmjet tij dhe OSHEE-së është lidhur kontratë, për furnizimin me energji elektrike. Duke qënë se ankuesi është debitor në vlerën 406.368 lekë, ndaj OSHEE-së, një grup pune i Drejtorisë Rajonale të OSHEE-së Elbasan, kanë ndërprerë energjinë në banesën e tij. Në vijim O. S. sqaron se energjia elektrike në banesën e tij mund t'i rilidhet vetëm pasi ai të ketë shlyer detyrimin që ka ndaj OSHEE-së, gjë që për të është e pamundur. Më datë 01.12.2014, Këshilli Mbikqyrës i OSHEE-së ka miratuar një lehtësi për personat që kanë detyrime të prapambetura, duke i ofruar

⁸⁸ Ndërkohë, 1 ankesë nuk është pranuar pasi nuk plotësonte kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, 1 ankesë është pushuar pasi ankuesi ka braktisur çështjen.

zbritje në masën 80 % të kamat vonesës për ata që do të paguajnë të gjithë shumën e detyrimit brenda datës 28.02.2015. Ankuesi referuar këtij vendimi sqaron se nuk është në gjendje të përfitojë nga këto lehtësira për shkak të pamundësisë ekonomike, pasi gjatë këtij afati 3-mujor ai mund të siguroj deri në 12900 lekë të ardhura, të cilat edhe nëse i kursen plotësisht, nuk mundet të paguajë të gjithë detyrimin që ka ndaj OSHEE-së. Në përfundim të ankesës O. S., ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e OSHEE-së, për shkak të gjendjes ekonomike, si dhe rekomandimin e OSHEE-së për marrjen e masave lidhur me zgjatjen ose heqjen e kufirit kohor të pagesës së shumës së debisë, si kusht për të përfituar zbritjen e 80 % të kamatës.

Komisioneri gjykoi se, vendimi i marrë nga ana e Këshillit Mbikqyrës të OSHEE-së, i paanshëm në dukje, ka sjellë vendosjen në kushte të disfavorshme të O. S. si përfitues i ndihmës ekonomike, në raport me konsumatorët familjarë të cilët kanë mundësi ekonomike për të shlyer të gjithë detyrimin e debisë që i detyrohen OSHEE-së dhe për të përfituar nga falja e 80 % të kamat vonesës. Në këto kushte, O. S. dhe kategoria e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, duke u vënë në pozita diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike të tyre. ***Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Shoqërisë OSHEE sh.a, të O. S. dhe familjeve që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, për të përfituar nga falja e 80 % e kamat vonesës. Subjekti, OSHEE sh.a ka ankimuar vendimin e Komisionerit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjykata ka vendosur lënien ne fuqi të vendimit të diskriminimit.***

➤ Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të gjinisë

Për vitin 2015, KMD për 11 (njëmbëdhjetë) ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të gjinisë, ka vendosur për 2 (dy) raste është konstatuar diskriminim⁸⁹.

Objekti i ankesave me pretendim diskriminimin për shkak të gjinisë, përgjithësisht ka qënë mosrespektimi i të drejtave në fushën e të mirave dhe shërbimeve dhe në fushën e punësimit, nga ana e institucioneve publike. Referuar individëve që janë ankuar pranë KMD-së, vërehet një rritje e numrit të ankueseve femra krahasuar me vitin e kaluar si dhe me numrin e ankuesve meshkuj.

⁸⁹ Ndërkohë, 3 (tre) ankesa nuk janë pranuar pasi nuk plotësojnë kërkesat e ligjit “Per mbrojtjen nga Diskriminimi, 1 (një) ankesë është mbyllur me konstatimin e mosdiskriminimit, në 2 (dy) raste ankuesit janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës, në 3 (tre) raste është pushuar shqyrtimi i ankesave pasi po shqyrtoheshin në sistemin gjyqësor.




Tabela 4. Ndarja gjinore sipas ankuesve

A. K. ka qenë në marrëdhënie pune me Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (ALSSH-së) Has, në detyrën “Inspektore Bujkut Privat për Komunitat Fajza e Gjinaj”. Është larguar nga puna, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH-së) Kukës, më datë 18.02.2014, me motivacionin e shkurtimit të vendit të punës. Ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të gjinisë, pasi është zëvendësuar me një punonjës, të gjinisë tjetër.

Gjatë verifikimit dhe këqyrjes së dokumentacionit, parë në një këndvështrim krahasues, Komisioneri konstatoi se: Në strukturën e vjetër të DRSSH-së Kukës, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) Inspektorë Bujku gjithsej, (të emëruar në komuna të ndryshme), 4 (katër) prej tyre ishin femra. Në strukturën e re të DRSSH-së Kukës, nga 11 (njëmbëdhjetë) Inspektorë Bujku gjithsej, (të emëruar në komuna të ndryshme), nuk ka asnjë femër në pozicionin e punës si Inspektore Bujku. Për më tepër, janë larguar punonjëset femra me arsim të lartë, të cilat janë zëvendësuar me punonjës meshkuj pa arsimin e kërkuar sipas pozicionit përkatës në Strukturë. (Arsimi i lartë ka qenë kriter si në strukturën e re ashtu edhe të vjetrën).

Po kështu, kontradiktor ishte edhe motivacioni i largimit nga puna i A. K. Referuar procesverbalit të datës 05.05.2014, të Degës së Administrimit të DRSSH Kukës, thuhet se: “...shkaku i justifikuar i zgjidhjes së kontratës (ndërkohë që kontratë të nënshkruar mes palësh nuk ka fare) është ristrukturimi i institucionit, pasi bazuar në strukturën e re të miratuar me urdhërin e ISSH-së nr. 398, datë 12.02.2014, pozicioni i punës Inspektor Bujku, nuk ekziston më”. Ky pretendim i DRSSH-së Kukës nuk qëndron, pasi në Strukturën e re organizative të këtij

institucioni, S. Xh. figuron në pozicionin e punës Inspektor Bujku në Komunën Fajza-Gjinaj, pozicion që më parë e mbante A. K. Kjo faktori pavërtetësinë e pretendimit të DRSSH-së Kukës, që ky pozicion nuk ekziston më. Këtu thjesht kemi zëvendësim personash.

Komisioneri, konstatoi se subjekti ankues është diskriminuar nga punëdhënësi DRSSH Kukës, për shkak të gjinisë, lidhur me largimin e saj nga puna. Lidhur me këtë Komisioneri ka i rekomanduar DRSSH –së Kukës të bëjë rikthimin e saj në vendin e punës. Duke qenë se DRSSH Kukës nuk zbatoi rekomandimin, Komisioneri ka ndërmarrë masën e sanksionit me gjobë.

➤ **Ankesa me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve politike**

Gjatë vitit 2015, KMD ka dalë me vendim për 26 ankesa ku pretendohet diskriminim për shkak të bindjeve politike, nga të cilat për 9 (nëntë) raste është konstatuar diskriminim⁹⁰.

Shtetasja F.R ka paraqitur ankesë kundër Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “Bindjes Politike”. Ankuesja ka shpjeguar se drejtuesi i institucionit ka urdhëruar largimin e menjëhershëm nga puna të saj pa asnjë referencë ligjore, por për motive politike. Njohja me veprimtarinë politike të subjektit ankues vërtetohet me anë të dokumentit të paraqitura nga F.R që është: Autorizimi në cilësinë e vëzhgueses për subjektin PD gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 23.06.2013. Drejtoria e Shëndetit Publik Mat nuk ka sjellë asnjë fakt që të hedhë poshtë pretendimet e subjektit ankuesit dhe të vërtetojë se trajtimi ndryshe i saj ka ardhur për shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkak të bindjes politike të F.R.

Komisioneri ka vlerësuar se urdhri për largimin nga puna të F.R për shkak të bindjes politike ishte një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Gjithashtu, Komisioneri ka vlerësuar se tendenca për lirim dhe menjëhershëm nga puna të F.R pa respektuar procedurat ligjore për lirim dhe punonjësve nga puna bie ndesh dhe me Urdhrin nr. 506, datë 18.09.2013 të Ministrit të Shëndetësisë, i cili në pikën 1, Urdhëron: “Pezullimin, deri në një urdhër të dytë, të procedurave të marrjes dhe largimit nga puna, të punonjësve në institucionet shëndetësore”. **Komisioneri ka vendosur konstatimin e diskriminimit të F.R, nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Mat, për shkak të bindjes politike dhe ka rekomanduar kthimin e F.R në vendin e punës. Me Vendimin nr.02,**

⁹⁰ Ndërkohë, në 5 (pesë) rast është konstatuar mosdiskriminim, 2 (dy) vendime për pushimin e çështjes, pasi çështja po shqyrtohej edhe në gjykatë, 9 (nëntë) vendime për mosplotësim të kriterëve të përcaktuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në 1 (një) rast subjekti ankues ka braktisur shyrtingin e çështjes.

datë 11.03.2015, Drejtoria e Shëndetit Publik Mat ka informuar Komisionerin për zbatimin e rekomandimit duke rikthyer në detyrë shtetasen F.R.

➤ **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të bindjeve fetare**

KMD ka shqyrtuar gjatë vitit 2015 vetëm 1 (një) ankesë me pretendim diskriminimin për shkak të bindjeve fetare.

Ankuesja J. R., ka mbaruar klasën e 10-të, në Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, gjatë vitit shkollor 2013-2014. Në muajin qershor të vitit 2014, nxënësja J. R., e cila i përket besimit fetar musliman, ka vendosur mbulesë. Me fillimin e vitit shkollor 2014-2015, ajo është paraqitur në shkollë, por nga ana e stafit i është mohuar e drejta të ndjekë mësimin e mbuluar, me arsyetimin se shteti është laik dhe nuk mund të lejohet të përdoren simbole fetare në institucionet arsimore publike.

Rezultoi e provuar se ka një diferencë në trajtimin e nxënësës J. R., e cila ndryshe nga nxënës të tjerë, të cilët kanë ose jo besime të ndryshme apo të njëjta fetare, i është mohuar e drejta e ndjekjes së mësimin në mënyrë të barabartë me të tjetër, për shkak të mbulesës, dhe ky kufizim është i pa u bazuar në ligj, mbështetur në akte nënligjore të paqarta dhe të diskutueshme. Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë në fushën e arsimit, për shkak të bindjeve fetare të nxënësës J. R., nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë dhe Drejtorisë së Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, Pogradec dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive që japin dispozitat ligjore në fushën e arsimit për të siguruar ecurinë mësimore të nxënësës J. R. me të njëjtin nivel me nxënësit e tjerë. Komisioneri rekomandoi që Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të marrë hapat e duhur për të bërë amendimet e nevojshme në legjislacionin për arsimin parauniversitar, duke parashikuar aktet ligjore dhe nënligjore, të formuluar me saktësi, të kuptueshme dhe sa më të qarta, në mënyrë që qytetarët të jenë të vetëdijshëm për sjelljet që duhet të mbajnë. Në zbatim të rekomandimit të Komisionerit, DAR Korçë dhe Drejtoria e Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Muharrem Çollaku”, rikthyen në shkollë nxënësen J. R. dhe shfrytëzuan të gjitha mundësitë për të siguruar ecurinë mësimore të saj me të njëjtin nivel me nxënësit e tjerë.

➤ **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të gjendjes shëndetësore**

Gjatë vitit 2015, pranë KMD-së, janë trajtuar dhe është dalë me vendim për 6 (gjashtë) ankesa në të cilat pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, nga të cilat për 3 (tre) çështje është konstatuar diskriminim dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse⁹¹.

⁹¹ Ndërkohë, 1 (një) çështje nuk është pranuar pasi nuk i plotësonte kriteret e parashikuara në ligjin “Per mbrojtjen nga diskriminimi”, për 1 (një) çështje është dhënë vendim pushimi, pasi është bërë i pamundur sigurimi i informacionit për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, në 1 (një) çështje është tërhequr subjekti ankues.

K.T ka paraqitur ankesë pranë KMD-së, në të cilën pretendon për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe të bindjeve politike, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë. Ankuesja ka filluar punë në DRT Tiranë, në Sektorin e Kontrollit në Terren, në vitin 2010. Në fillim të muajit Janar është emëruar drejtori i ri i DRIT-së. Brenda 10 ditëve të para të emërimit të tij, K. T. ka marrë një masë disiplinore për largim nga puna me argumentimin “për shkelje të detyrës”.

*E gjithë dinamika e ngjarjeve, duke filluar që nga marrja e masave disiplinore dhe mungesa e transparencës në gjithë këtë procedim administrativ, bën që ankueses t’i mohohet e drejta e aksesit si palë, për t’u informuar dhe për t’u dëgjuar. Pala ndaj së cilës, znj.K.T ankohet, ka patur dijeni për gjendjen e saj shëndetësore, përmes raporteve mjekësore, dhe megjithatë ka vazhduar procedimin administrativ pa i bërë njoftimin e detyrë, që ajo të mund të përfaqësohej me përfaqësues ligjor. Në përfundim të procedurës hetimore, **Komisioneri ka vendosur: 1.Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses për shkak të bindjeve politike. 2. Konstatimin e diskriminimit të ankueses nga ana e DRT Tiranë për shkak të gjendjes së saj shëndetësore.***

➤ **Ankesa me pretendim diskriminimin për shkak të vendbanimit**

Komisioneri, bazuar në informacionin e marrë nga shtetasi D.D, banues në Mbretërinë e Bashkuar, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes lidhur me masën e tarifës së pajisjes me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë që banojnë në shtete të ndryshme të Evropës dhe mënyrës së pagesës së kësaj tarife në Mbretërinë e Bashkuar. Nga ana e këtij shtetasi është ngritur shqetësimi se shtetasit shqiptarë, që banojnë në Mbretërinë e Bashkuar, janë të detyruar të paguajnë tarifë më të lartë për tu pajisur me pasaportë biometrike, gjë që vendos këto shtetas në pozita të pabarabarta në raport me shtetasit Shqiptarë që banojnë në shtete të tjera. D.D informon se shtetasit Shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar në diferencë me shtetasit Shqiptarë me banim në Itali dhe Greqi janë të detyruar që pagesat për pajisjen me pasaportë ti kryejnë vetëm nëpërmjet pagesës me (Postal order) dhe jo në forma të tjera gjë që ngarkon me pagesë ekstra këto shtetas për tu pajisur me pasaportë biometrike.

*Pas gjithë korrespondencës zyrtare me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka konstatuar se: Nga ana e Komisionerit janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe informacion të detajuar mbi përbërësit e kostos së pasaportave biometrike për shtetasit shqiptarë që banojnë në shtete të ndryshme të Evropës në mënyrë që Komisioneri të kishte një bazë krahasimore dhe të shqyrtonte këtë ankesë në mënyrë sa më objektive dhe të paanshme. **Komisioneri ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme me dijeninë e plotë nuk ka dhënë asnjëherë informacionin dhe shpjegimet e***

kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim. Për këtë arsye ka rezultuar e provuar se Ministria e Punëve të Brendshme, ka shkelur nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke mos e mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, duke mos i dhënë informacionin që i nevojitet për shqyrtimin e çështjes. Për këtë arsye, **Komisioneri ka vendosur sanksion me gjobë ndaj Ministrisë së Punëve të Brendshme për mosdhënie të informacionit të kërkuar zyrtarisht nga KMD. Ky vendim është lënë në fuqi dhe nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.**

Lidhur me pretendimin se shtetasit shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar në diferencë me shtetasit shqiptarë me banim në Itali dhe Greqi janë të detyruar që pagesat për pajisjen me dokumente identifikimi ti kryejnë vetëm nëpërmjet pagesës me (Postal order) dhe jo në forma të tjera, Komisioneri vlerësoi se referuar mënyrës së pagesës të publikuar në ambasadat Shqiptare në shtetet Itali, Greqi dhe Mbretëria e Bashkuar vërehet se praktika e ndjekur nga ambasadat shqiptare në këto shtete në dukje nuk i diferencojnë/pengojnë shtetasit shqiptarë nga pajisja me dokumente identifikimi për shkak të vendbanimit, por shtetasit shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar për shkak të çmimit të blerjes së “Postal Order-it” vendosen në pozita më pak të favorshme krahasuar me shtetasit shqiptarë me banim në Itali dhe Greqi. **Kufizimi i pagesës vetëm me “Postal Order” është në fakt një praktikë diskriminuese për shkak të vendbanimit.** Shtetasit shqiptarë me banim në Itali dhe Greqi duke qenë se kanë mundësi të kryejnë pagesat nëpërmjet bankës, si rrjedhim dhe çmim më të ulët janë më të favorizuar se shtetasit shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar që duhet të paguajnë një çmim më të lartë për tu pajisur me dokumente identifikimi. **Komisioneri, në mungesë dhe të një justifikimi të arsyeshëm nga ana e Ministrisë së Jashtme, vendosi konstatimin e diskriminimit të tërthortë të shtetasve shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe rekomandoi që shtetasve Shqiptarë me banim në Mbretërinë e Bashkuar ti ofrohen mundësi pagese nëpërmjet sistemit bankar apo formave të tjera. Në përgjigje të rekomandimit të KMD-s, Ministria e Punëve të Jashtme me shkresën nr. 20147, datë 26.11.2015, informoi Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të rekomandimit.**

➤ **Ankesa me pretendim diskriminim për shkaqe të tjera**

Gjatë vitit 2015 KMD ka dalë me vendime për çështje, në të cilat pretendohet diskriminim për shkak të denoncimeve, mëmësisë, gjuhës, identitetit gjinor, shtatëzanië etj.

Mbështetur në ankesën e depozituar nga D.Ç, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi hetimin administrativ, mbi pretendimin për diskriminim të ankueses, për shkak të bindjeve politike, shtatëzanië dhe për çdo shkak tjetër.

Komisioneri gjykoj se D. Ç, ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e DRSSH Kukës, në krahasim me punonjës të tjerë të këtij institucioni. Ky trajtim, kishte lidhje të drejtpërdrejtë, së pari me gjininë e saj si femër dhe së dyti me faktin e të qënurit nënë e re, e cila si e tillë ka qenë e detyruar t'i përkushtohet foshnjës së saj, duke marrë lejen e lindjes për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë, leje e cila është e mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore. Një fakt i tillë nuk ishte marrë në konsideratë nga DRSSH Kukës, por ankuesja ishte diskriminuar duke e larguar nga puna, menjëherë pas përfundimit të lejes së barrë lindjes, si dhe duke e zëvendësuar atë me një punonjës të seksit mashkull, i cili ishte komanduar për ta zëvendësuar ankuesen gjatë lejes së barrë lindjes. **Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjinisë dhe për shkak të mëmësisë, të D.Ç., nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës.** Njëkohësisht, Komisioneri kërkoi marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, për sistemimin e D. Ç. në pozicionin e mëparshëm të punës, pranë këtij institucioni. Vendimi i Komisionerit nuk u zbatua nga DRSSH Kukës dhe si pasojë, në bazë të dispozitave përkatëse të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ky institucion u ndëshkua me gjobë.

Gjatë vitit 2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dalë me vendim për **15 ankesa, ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes arsimore**, nga të cilat për 4 (katër) prej këtyre ankesave është dhënë vendim për konstatim diskriminimi⁹².

E.G ankohet kundër administratorit të kompanisë Albpetrol sh.a, duke pretenduar për diskriminim për shkak të lidhjes familjare. Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë E.G deklaroi se largimi nga puna dhe veprimet diskriminuese ndaj tij dhe familjes së tij kanë filluar pas denoncimeve që prindërit e tij, M.G dhe L.G kanë bërë në drejtim të punëdhënësit E.P në cilësinë e administratorit të kompanisë Albpetrol sh.a.

Në bazë të rezultateve të hetimit u konkludua se administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a, ka qenë tendencioz në vendimin për largimin e z.E.G nga vendi i punës, pasi edhe pse ishte në dijeni se shoqëria Albpetrol kishte investuar vlera monetare për kualifikimin akademik si dhe kishte një kontratë pune individuale me afat dy vjeçar me E.G, përsëri ka ndërmarrë veprimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Pretendimi se largimi nga puna është kryer për shkak të lidhjes familjare konstatohet dhe nga fakti se pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me E.G, shoqëria Albpetrol sh.a, ka emëruar në punë dhe dy punonjës të tjerë në pozicionin e juristit. Fakti i qëndrimit diskriminues ndaj E.G përforcohet dhe me veprimin e mosinformimit dhe mos pagesës së pagës për periudhën Shtator-Nëntor 2015 nga ana e punëdhënësit me arsyetimin se

⁹² Ndërkohë, në 3 (tre) raste është konstatuar mosdiskriminim, 3 (tre) ankesa nuk janë pranuar për shkak të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", 4 (katër) ankesa janë pushuar për shkak se po shqyrtoheshin nga Gjykata, 1 (një) prej ankuesve është tërhequr nga shyrtimi pranë KMD-së.

punëmarrësi nuk është paraqitur në punë. Referuar Vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 30.09.2014, është vërtetuar se E.G ka qenë në punë si përfaqësues i shoqërisë Albpetrol sha në çështjen gjyqësore me paditës: K.Ll dhe të paditur Albpetrol sha. Prania në punë e z. E.G përforcohet dhe me faktin që në datë 25.09.2014 në mjediset e Albpetrol sh.a është mbajtur proces verbali mbi dorëzimin e dosjes gjyqësore (me palë paditëse K.Ll dhe të paditur Albpetrol sha) të dorëzuar juristit R.M. Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka vendosur konstatimin e diskriminimit të shtetasit E.G, për shkak të lidhjes familjare në formën e viktimizimit, nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a dhe ka rekomanduar rikthimin e E.G në vendin e mëparshëm të punës.

Gjatë vitit 2015, pranë KMD-së ka dalë me vendim për 5 ankesa, ku pretendohet diskriminim për shkak të moshës, nga të cilat për 2 (dy) raste është konstatuar diskriminim⁹³.

II.1.1.6. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat

Për vitin 2015 janë trajtuar pranë zyrës së Komisionerit 197 çështje të ndara sipas fushave kryesore në arsim, punësim dhe në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Më poshtë paraqitja grafike e shpërndarjes së ankesave.

⁹³ Ndërkohë, 3 (tre) ankesa nuk janë pranuar pasi nuk plotësojnë kërkesat e ligjit “Per mbrojtjen nga Diskriminimi, në 1 (një) rast është pushuar shqyrtimimi i ankesave pasi po shqyrtoheshin në sistemin gjyqësor.




Tabela 5. Ndarja sipas fushave në të cilat janë paraqitur ankesat

➤ **Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve**

Ankesat në fushën e të mirave dhe shërbimeve kanë qënë më të mëdha në numër, referuar dy fushave të tjera, pasi në fushën e të mirave dhe shërbimeve përfshihen përfitimi i të mirave dhe shërbimeve të ofruar nga administrata publike dhe subjektet private. Kryesisht ankesat e paraqitura në këtë fushë kanë të bëjnë me shërbimet të cilat nuk janë ofruar nga njësitë vendore (p.sh. personat me aftësi të kufizuara pretendojnë se njësitë vendore nuk kanë përshtatur mjediset e vendbanimit ku jetojnë për personat me aftësi të kufizuara) apo nga subjekt private, shëndetësia, administrata publike etj. Përgjithësisht ankesat kanë pasur të bëjnë me përshtatjen e arsyeshme, vonesat në pagesat e pensioneve të invaliditetit, vonesat në marrjen e masës mujore të ndihmës ekonomike etj. Kjo është dhe arsyeja pse kjo fushë përmbledh 62 % të ankesave të përgjithshme.

Shtetasi F. N., pretendon se është diskriminuar për shkak të racës dhe gjendjes shëndetësore, nga ana e Bashkisë Elbasan, për shkak se nuk merr ndihmë ekonomike. Familja F. N. përbëhet nga 2 anëtarë, përkatësisht dy bashkëshortë, aplikimi i të cilëve është refuzuar nga sistemi elektronik i shërbimit social, për katër herë, ndërkohë që në aplikimin e pestë kanë rezultuar përfitues të ndihmës ekonomike, pavarësisht se kushtet e tyre ekonomike kanë qënë të njëjta dhe janë konsideruar familje ne nevojë. Familja F.N. përbëhet nga 2 anëtarë, përkatësisht dy bashkëshortë, aplikimi i të cilëve është refuzuar nga sistemi elektronik i shërbimit social, për katër herë, ndërkohë që në aplikimin e pestë kanë rezultuar përfitues të ndihmës ekonomike, pavarësisht se kushtet e tyre ekonomike kanë qënë të njëjta dhe janë konsideruar familje ne

nevojë. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se sistemi elektronik i shërbimit social ka nevojë t'u nënshtrohet përmirësimeve, në mënyrë që të mos ketë trajtim të ndryshëm, në kushte të njëjta të familjeve në nevojë dhe në gjendje të vështirë ekonomike. Këtu vihet theksi tek kategoritë më pak të favorizuara nga ky sistem, të tilla si: gratë kryefamiljare, vajzat nëna, njerëz të vetmuar mbi moshë pune që nuk përfitojnë pensione, vajza të papuna të mbetura në trungun familjar, apo edhe familjet rome dhe egjiptiane.

Në rastin konkret Komisioneri gjykoj, se nëpërmjet mosveprimit të Bashkisë Elbasan janë krijuar baza për mohimin e barazisë të familjes F. N., duke e ekspozuar këtë familje, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, për shkak të gjendjes ekonomike, në krahasim me grupe të tjera personash. Në përfundim, **Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjendjes ekonomike, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, të F. N., nga ana e Bashkisë Elbasan dhe konstatimin e diskriminimit të tërthortë, për shkak të gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, të F. N., nga ana e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimit Social Shtetëror.**

➤ **Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit**

Ankesat e paraqitura me pretendim diskriminim në fushën e punësimit janë ankesa të bëra si kundër institucioneve shtetërore ashtu dhe kundër subjekteve private. Kryesisht ato kanë të bëjnë me procedurat e ndjekura prej tyre në lidhje me punësimin. **Numri i përgjithshëm i tyre për vitin 2015, është 55.** Ankesat që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë patur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, përkatësinë në një grupim të veçantë, gjendjen arsimore, racën, moshën. KMD në fushën e punësimit, në disa prej çështjeve të përfunduara ka dhënë vendim diskriminimi dhe rekomandimet përkatëse për rregullimet dhe masat që duhet të marrë subjekti i cili ka kryer diskriminimin.

Shtetasi V. K. sqaron nga muaji Maj 2006 deri në muajin Maj 2010 ka punuar në pozicionin e punës Shef i Zyrës Juridike, pranë Drejtorisë Zonale Burrel (Cez). Nga muaji Maj 2010 e në vijim ka punuar si Specialist pranë Drejtorisë Ligjore Cez Shpërndarje Tiranë, sot emërtuar si OSHEE sh.a. Me datë 05.11.2014, është bërë njoftimi për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëherëshme nga ana e OSHEE sh.a, me motivacionin “mosprezencë e pajustificuar në punë, për më shumë se 3 (tre) ditë dhe pa vënë në dijeni eprorët e tij”. Ankuesi pretendoi se kjo kishte ardhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai është anëtar i PD-së dhe argumentoi faktin se 3 ditët e pretenduara nga ana e OSHEE-së, kishte qenë me punë jashtë zyre, si përfaqësues i OSHEE-së në gjykatë. Në përfundim të procedurës së ndjekur lidhur me shqyrtimin e rastit, Komisioneri vlerësoi se, pretendimet e ankuesit se largimi i tij nga puna ishte bërë për motive të ndryshme nga ato të cituara në shkresën, pasi ai solli si provë kopje të

*shkresave, (procesverbalëve) me të cilat vërtetoi se në datat e pretenduara nga OSHEE sh.a për mosprezencë në vendin e punës, ai kishte qenë në gjykatat respektive, për efekt të çështjeve gjyqësore të ndjekura prej tij. Nga ana tjetër, OSHEE-ja nuk solli asnjë shkresë apo fakt, që të vërtetonte të kundërtën. Nuk kishte asnjë procesverbal për kontroll të ushtruar për verifikimin e prezencës në punë të V. K. Nga verifikimi i procedurës së rekrutimit të punonjësit të ri, në vend të ankuesit, E. A., Komisioneri doli në konkluzionin se në momentin e lidhjes së marrëdhënieve të punës mes tij dhe OSHEE sh.a ai nuk plotësonte kriterin e eksperiencës në punë. Pra, OSHEE sh.a kishte larguar nga puna ankuesin që plotësonte kriteret e kërkuara dhe kishte emëruar një tjetër pa kriteret përkatëse. Në përfundim, **Komisioneri është shprehur me vendim për konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë të V. K. për shkak të bindjeve politike, nga ana e OSHEE sh.a Tiranë, dhe si masë rregulluese ka rekomanduar rikthimin e tij në punë. Duke qenë se OSHEE-ja nuk zbatoi rekomandimin, Komisioneri ka ndërmarrë masën e sanksionit me gjobë.***

Institucioni i Komisionerit, bazuar në informacionin e marrë nga gazeta “Tirana Observer”, në artikullin me titull: “Farmacistët kundër urdhrit të ri për daljen në pension: Është diskriminues”, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes në lidhje me efektet diskriminuese të ndryshimeve në nenin 19 të statutit të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë nga ana e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve. Në rrugë elektronike pranë Komisionerit janë paraqitur dhe dy ankesa të tjera nga një grup farmacistësh pensionistë të qytetit të Pogradecit dhe një grup farmacistësh pensionistë, anëtarë të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, të cilët pasi u informuan për ndjekjen kryesisht të çështjes nga ana e Komisionerit, kërkuan tërheqjen nga ankesa. Nga ana e farmacistëve është përcjellë shqetësimi lidhur me ndryshimet e kryera në Statutin e Urdhrit, ku një ndër pikat që lidhet me të drejtën e ushtrimit të profesionit të drejtuesit teknik, diskriminon ata që mbushin moshën e pensionit dhe që nuk janë të vetëpunësuar, ndërsa ata drejtues teknikë në moshë pensioni që kanë bizneset e tyre lejohen të ushtrojnë profesionin e drejtuesit teknik.

*Komisioneri në analizë të legjislacionit ka vlerësuar që kufizimi i vendosur nga Statuti i Urdhrit të Farmacistëve është në tejkalim të legjislacionit që rregullon ushtrimin e profesionit të farmacistëve, duke vlerësuar që funksionet që kryen drejtuesi teknik janë të lidhura ngushtësisht me aftësitë profesionale të farmacistit dhe nuk ndikohen aspak nga statusi “i punësuar” apo “vetëpunësuar”. **Komisioneri ka vendosur konstatimin e diskriminimit të tërthortë të farmacistëve drejtues teknikë në moshë pensioni që nuk janë të vetëpunësuar nga vendimi i marrë nga Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë dhe ka rekomanduar që Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë të konstatojë pavlefshmërinë e pjesshme të vendimit. Në përgjigje të rekomandimit të KMD-s, urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, informoi Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të rekomandimit.***

➤ **Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit**

Gjatë vitit 2015, KMD ka trajtuar 19 çështje në fushën e arsimit. Rastet në fushën e arsimit kanë pasur përgjithësisht shkaqe diskriminimi racën, gjëndjen shëndetësore, gjëndjen ekonomike dhe aftësinë e kufizuar. Pjesa më e madhe e këtyre rasteve ka të bëjë me mospranimin e integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme dhe mospranimin e regjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe shpërndarjen e teksteve shkollore falas në shkollat 9-vjeçare, për familjet në nevojë.

Komisioneri shqyrtoi ankesën e depozituar nga A. P., kundër M. P., Drejtor pranë Shkollës së Bashkuar Vau i Dejës, ku pretendohet për diskriminim të djalit të saj që vuan nga autizmi, për shkak të aftësisë së kufizuar. M. P., ndjek klasën e tretë pranë kësaj shkolle, por prej 2 javësh nuk ka frekuentuar më mësimin. Nëna e tij, e cila është mësuese pranë kësaj shkolle, ka theksuar faktin se shkak për këtë mosfrekuentim, është kërkesa e drejtorit të shkollës për ta larguar djalin e saj nga shkolla, pasi ai përbën problem për fëmijët e tjerë, për shkak se vuan nga autizmi. Ndër të tjera, nëna e M.P. kërkon ndërhyrjen e Komisionerit me qëllim që djalit të saj t'i sigurohet një mësues ndihmës.

*Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit u ngarkon detyra të rëndësishme njërive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëllor si të gjithë fëmijët e tjerë, dhe për të integrohen në institucionet arsimore të zakonshme. Nga hetimet e kryera, rezultoi se si drejtori i Shkollës ashtu edhe DAR Shkodër nuk kishin zbatuar detyrimet ligjore që rridhnin nga zbatimi i Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”. Komisioneri konstatoi se DAR Shkodër nuk kishte ngritur Komisionin Multidisiplinar, i cili vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe ndjek ecurinë e tij. Ndërkohë, Drejtori i Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës, Shkodër nuk kishte ngritur komisionin e posaçëm për nxënësit me aftësi të kufizuara. **Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të nxënësit M. P., nga ana e DAR Shkodër dhe Shkolla 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër.** Komisioneri kërkoi marrjen e masave të menjëherëshme nga ana e DAR Shkodër, për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit dhe dhënien e vlerësimit përkatës për nxënësin, marrjen e masave të menjëherëshme nga ana e DAR Shkodër, për caktimin e një mësuesi ndihmës, për nxënësin, ngritjen e Komisionit pranë Shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër dhe përgatitjen e programit edukativ individual për këtë nxënë. **Rekomandimet e Komisionerit janë plotësuar nga drejtuesi i shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës Shkodër. Komisioneri e ndërshkoi me gjorbë DAR Shkodër, për moszbatim të rekomandimeve të tij.***

Mbështetur në informacionin e dërguar pranë Zyrës së Komisionerit, nga ana e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe Qendrës Europiane për të Drejtat Rome, ku Komisioneri është bërë me dije, lidhur me faktin se në shkollën vartëse “Avdyl Avdia”⁹⁴, Moravë, Berat, mësojnë vetëm nxënës që i përkasin komunitetit rom, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka filluar kryesisht hetimin dhe shqyrtimin e çështjes në fjalë.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, Komisioneri konstatoi se pranë shkollës vartëse “Avdyl Avdia”, të lagjes Stan, të fshatit Moravë, Berat, që prej krijimit të saj në vitin 2002 e në vijim, mësojnë nga klasa e parë deri në klasën e pestë, fëmijët e komunitetit rom që jeton në këtë lagje. Të gjithë nxënësit që mësojnë në këtë shkollë i përkasin komunitetit rom, ndërkohë që stafi mësimor nuk i përket këtij komuniteti. Komisioneri konstatoi se situata e segregimit të fëmijëve romë në lagjen Stan, të fshatit Moravë, Berat ishte e evidente. Ky fakt ishte pranuar edhe nga DAR Berat, e cila nga viti 2002 e deri më sot nuk ka ndërmarrë asnjë masë efektive për shmangien e veçimit apo disegregimit të ndodhur në këtë shkollë. **Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në fushën e arsimit, nga ana e MAS dhe DAR Berat, për krijimin e situatës së segregimit dhe veçimit të nxënësve romë pranë shkollës vartëse “Avdyl Avdia” në lagjen Stan, Moravë, Berat.** Komisioneri kërkoi marrjen e masave të nevojshme nga ana e MAS dhe DAR Berat, për ndalimin e gjendjes së segregimit të nxënësve romë pranë shkollës vartëse “Avdyl Avdia” në lagjen Stan, Moravë Berat dhe marrjen e masave të menjëherëshme nga DAR Berat, për sigurimin e transportit falas për të transportuar nxënësit e shkollës “Avdyl Avdia”, për në shkollën kryesore, si edhe një përfaqësues të komunitetit, që t’i shoqërojë nxënësit. Brenda afatit ligjor, DAR Berat njoftoi për mbylljen e shkollës vartëse “Avdyl Avdia”, të lagjes Stan, të fshatit Moravë, Berat, ndërkohë që nuk kishte siguruar transportin falas për nxënësit romë, në mënyrë që këta të fundit të ndiqnin mësimin pranë Shkollës “Shaban Sollaku”, Moravë. Për këtë arsye, DAR Berat u ndërkohua me gjorbë nga Komisioneri.

II.1.1.7. Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara

Duke u bazuar në nenin 33 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, fillimisht ankesat i janë nënshtruar një shqyrtimi paraprak, lidhur me kushtet e pranimit. Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit ose ka patur mungesë të informacionit që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që të plotësojë kriteret e kërkuar nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qënë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me njësitë vendore, subjekteve ankues u është ofruar ndihmë nga

⁹⁴Shkolla vartëse “Avdyl Avdia” është në vartësi të Shkollës 9-vjeçare “Shaban Sollaku”, Moravë, Berat.

njësitë vendore, për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015 ka marrë 184 vendime(diferenca mes numrit të çështjeve të shqyrtuara dhe numrit të vendimeve lidhet kryesisht me faktin se një pjesë e konsiderueshme e ankesave janë marrë gjatë takimeve që KMD realizon me komunitetin në muajt nëntor dhjetor). Referuar vendimeve të dhëna dëshirojmë të theksojmë se:

Janë dhënë 41 vendime konstatim diskriminimi dhe 61 vendime konstatim mosdiskriminimi. Theksojmë faktin se në 3 çështje të përfunduara me arritje qëllimi, situata diskriminuese e konstatuar është rregulluar gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, nëpërmjet hapave që KMD ka ndërmarrë në mbështetje të ligjit.

Janë dhënë **16 vendime me gjobë**, ndër të cilat 13 për shkak se subjektet nuk kanë zbatuar rekomandimet e dhëna nga KMD dhe 3 për subjektet që nuk kanë vënë në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar prej tij, bazuar në Ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Theksojmë se janë dhënë **13 vendime për pushimin e çështjes, ndër të cilat 10 për shkak se ankesat po shqyrtohen në Gjykatë**, (2 për pamundësi të sigurimit të informacionit dhe një ankesë për shkak se KMD po e shqyrton në kuadër të një ankese tjetër).

Ndërkohë, theksojmë që mbetet i ndjeshëm numri i vendimeve të mospranimit të ankesave(45 vendime). Në një analizë të çështjeve të trajtuara, konstatojmë se në shumicën e tyre ankesat nuk janë pranuar pasi nuk kanë informacionin e mjaftueshëm ose pretendimi për diskriminim ka të bëjë me një të drejtë (zakonisht bëhet fjalë për shërbime si ndihma ekonomike, banesa sociale, etj), për të cilat nuk kanë informacionin e mjaftueshëm si të aplikojnë, përfitojnë etj⁹⁵.

Mbështetur në nenin 33, pika 8 e Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka parë të përshtatshme, që në vijim të shqyrtimit të **ankesave të zhvillojë seanca dëgjimore publike, në 32 raste**, ku ka ftuar palët dhe çdo person tjetër të interesuar për të parashtruar pretendimet e tyre. Vlen të theksohet fakti që Komisioneri ka dalë me vendim diskriminimi për 13 raste, pas zhvillimit të seancave dëgjimore.

Referuar vendimeve për diskriminim të dhëna nga Komisioneri, konstatohet se në 20 vendime subjekti ankues ka qenë femër, në 12 vendime subjekti ankues ka qenë mashkull, në 2 vendime subjekti ankues ka qenë OJF dhe në 7 vendime çështja është iniciuar kryesisht nga Komisioneri (ex-officio).

⁹⁵ Ndërkohë, janë dhënë 7 vendime për ndërprerje të procedurave për shkak se ankuesit janë tërhequr, 1 vendim pushimi, pasi ankuesi ka braktisur shqyrtimin çështjes.




Tabela 6. Pasqyrim i vendimeve të Komisionerit

II.1.2. Trajtimi i çështjeve me objekt diskriminimi në gjykatë

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar zbatimin e tij, jo vetëm në rrugë administrative, nëpërmjet shqyrtimit administrativ të ankesave apo çështjeve ex-officio të iniciuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi si institucion i specializuar, por edhe në rrugë gjyqësore. Kështu, nëpërmjet një padie civile, subjekti që pretendon se është viktimë e sjelljeve diskriminuese mund të rivendosë të drejtën e cenuar, por mund të kërkojë edhe dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar.

Ky ligj e vendos KMD në një raport të gjerë me gjykatën, duke parashikuar mjaft kompetenca përta i takon pjesëmarrjes së institucionit në proceset gjyqësore. Kështu, Komisionerit i është dhënë kompetenca të përfaqësojë subjektet që pretendojnë se janë viktima të sjelljeve diskriminuese në gjykatë.⁹⁶ Gjithashtu, ligji parashikon detyrimin e gjykatës për ta njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t'i

⁹⁶ Neni 34, pika 3 e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcakton se “Një organizatë me interes të ligjshëm ose Komisioneri mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që Komisioneri ose organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi”.

kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të procedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen (Neni 36, pika 4 dhe neni 32, pika1/gj).

Gjatë vitit 2015, KMD ka marrë pjesë në 37 procese gjyqësore, nga ku vihet re një rritje e ndjeshme e pjesëmarrjes në proceset gjyqësore në krahasim me vitet e mëparshme.

Si më poshtë paraqiten në mënyrë tabelore, statistika krahasuese lidhur me pjesëmarrjen e KMD në proceset gjyqësore nga 2012-2015 dhe roli i KMD-së në gjykim ndër vite.

	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Numri i proceseve gjyqësore për vit	3	6 <i>(3 çështje të mbartura nga 2012)</i>	18	37

Tabela Nr. 1: Numri total i pjesëmarrjes së KMD në proceset gjyqësore 2012 – 2015

	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Person i tretë	1	3	3	16
Dhënie Mendimi me shkrim për gjykatën	1	-	6	4
Palë e paditur	1	3	6	14
Kërkesa për Urdhra Ekzekutimi	-	-	3	3

Tabela Nr. 2: Roli i KMD në proceset gjyqësore 2012- 2015

Gjatë vitit 2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë në 37 procese gjyqësore, si:

II.1.2.1. Person i Tretë në gjykim në 16 procese gjyqësore

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë në 16 procese gjyqësore në cilësinë e personit të tretë, nga të cilat:

- në 13 raste kërkohet dëmshpërblimi për diskriminim në gjykatë;
- në 1 rast kërkohet rivendosje në afat për kundërshtimin e vendimit të KMD;
- në 1 rast kërkohet pavlefshmëri absolute e akteve administrative të palës së paditur;
- në 1 rast kërkohet kundërshtim i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, që kishte vendosur lidhur me një vendim të KMD.

Nga 13 çështje gjyqësore ku kërkohet në objekt konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblimi në gjykatë, rezulton se: në 2 raste është njohur dëmi i pësuar nga diskriminimi me vendim gjyqësor të shkallës së parë, në 5 raste është vendosur rrëzimi i padisë duke mos e njohur dëmin nga gjykimi në shkallë të parë (vendime këto të ankmuara në apel), 1 çështje është pushuar, 1 vendim mos-kompetence dhe 4 çështje janë ende në proces.

II.1.2.2. Dhënie Mendimi me Shkrim nga KMD për Gjykatën në 4 procese gjyqësore⁹⁷

KMD, si organ i specializuar, ka krijuar një raport të rëndësishëm me gjykatat, fakt ky që kontribuon në zbatimin efektiv të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në sistemin gjyqësor dhe trajtimin e çështjeve të diskriminimit nga gjykatat bazuar në standartet e këtij ligji.

Tre nga çështjet në të cilat KMD është thirrur nga gjykata për parashtrimin e një mendimi të specializuar me shkrim, kishin të bënin me zgjidhjen e kontratës së punës nga punëmarrësit pa shkaqe të arsyeshme (por për motive abuzive dhe shkaqe diskriminuese). Në këto çështje, gjykata e ka bërë pjesë të interpretimit të vendimit gjyqësor mendimin e KMD-së.

Çështja tjetër ka në objekt kërkesën për shmangien e diskriminimit dhe rillojaritjen e pensionit të parakohshëm.

Këto çështje nuk kanë qenë të shqyrtuara më parë nga KMD. Është në vullnetin e vetë ankuesit për të ndjekur rrugën administrative apo atë gjyqësore për rivendosjen e së drejtës së cënuar.⁹⁸

Konkluzione

Përmes këtyre çështjeve janë identifikuar dy probleme në lidhje me zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”:

1. *Gjykata nuk e njofton Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim, siç parashikohet në nenin 36, pika 3, “Procedura para gjykatës”;*

⁹⁷ Në Ligjin nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 36 pika 4 parashikohet se “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”.

⁹⁸ Madje, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon se kjo e drejtë nuk kushtëzohet nga detyrimi për të shfrytëzuar më parë rrugën administrative pranë Komisionerit (34, pika 2) dhe as detyrimin e të dëmtuarit që të njoftojë Komisionerin para se të paraqesë një padi për diskriminim në gjykatë (neni 36, pika 2).

2. Vendimi përfundimtar i gjykatës nuk ju komunikua Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, detyrim ky i përcaktuar nga neni 37/2 i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
3. Përdoret mendimi i Komisionerit në argumentimin e vendimit gjyqësor, por jo në dispozitivin e tij për konstatimin apo jo të diskriminimit, bazuar në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

KMD vlerëson se:


- kërkohet njohja dhe zbatimi i detyrimit ligjor nga ana e gjyqtarëve për njoftimin e KMD për çështjet me objekt diskriminimi
- në hartimin e kërkesë-padive, avokatët duhet të vendosin në objekt kërkesën për konstatimin e diskriminimit, duke e referuar në bazë ligjore të kërkesë padisë Ligjin 1022/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Vlerësojmë se kjo do të sillte zbatimin e duhur dhe efikas të këtij ligji edhe nga gjykatat.

II.1.2.3. Palë e Paditur në 14 çështje gjyqësore

Vendimet e KMD janë akte administrative të cilat sipas ligjit mund të ankimohen në gjykatë. Bazuar në legjislacionin në fuqi, subjektet kanë kundërshtuar vendimet me konstatim diskriminimi apo vendimet për vendosjen e sanksioneve me gjobë të nxjerra nga KMD.

KMD ka marrë pjesë në 14 procese gjyqësore si palë e paditur, ku është kërkuar në objekt pavlefshmëria absolute apo shfuqizimi i vendimeve të KMD-së, nga ku gjykata ka vendosur: në 7 çështje rrëzimin e kërkesës duke lënë në fuqi vendimet e Komisionerit, -1 vendim për kthimin e kërkesë-padisë pa veprim, për arsye procedurale, - 1 mospranim për mos-plotësimin e kushteve formale të kërkesës, - në 2 çështje është vendosur pranimi i kërkesë-padisë dhe 3 çështje janë në proces. Përsa më lart, **konstatojmë se, nga vendimet gjyqësore në lidhje me çështjet me objekt kundërshtimin e vendimit të KMD-së, në përqindjen më të lartë të rasteve gjykata ka rrëzuar kërkesë-padinë e palës paditëse, duke lënë në fuqi vendimet e KMD si të bazuara në ligj dhe në prova.**



II.1.2.4 Kërkues për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit në 3 procese gjyqësore

Për vendimet me gjobë të cilat nuk janë ankimuar apo për ato vendime të cilat janë ankimuar dhe vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë, KMD ka filluar procesin e ekzekutimit të gjobave, duke kërkuar fillimisht lëshimin e urdhrave të ekzekutimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” nuk ka parashikuar se vendimi me gjobë i KMD-së është titull ekzekutiv. Për të kërkuar përpara gjykatës lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për vendimet me gjobë, KMD ka arsyetuar përpara gjykatës së edhe në mungesë të një parashikimi të drejtpërdrejtë nga LMD, për vendimet me gjobë të KMD gjejnë zbatim parashikimet e ligjit “Për kundërvajtjet administrative”.

KMD i është drejtuar gjykatës kompetente si kërkues për lëshimin e 3 Urdhrave të Ekzekutimit. Në përputhje me parashikimet ligjore, institucioni i është drejtuar gjykatës me kërkesa për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit për vendimet e KMD që vendosin sanksione me gjobë, me qëllim që të ekzekutohen gjobat nga subjektet të cilët, me vendim të Komisionerit, kanë kryer sjellje diskriminuese dhe nuk kanë ndrequr situatën diskriminuese, sipas rregullimeve apo masave të urdhëruar nga Komisioneri, vlerësuar rast pas rasti.

II.2. Rekomandime Legjislative dhe Opinione

II.2.1. Rekomandime Legjislative

Në zbatim të kompetencës ligjore të parashikuara nga neni 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit “P r Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku thuhet se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar dy rekomandime legjislative autoriteteve kompetente dhe një opinion Gjykatës Kushtetuese, si më poshtë:

Tabela e mëposhtme tregon numrin e Rekomandimeve Legjislative të KMD me qëllim përafrimin e legjislacionit të brendshëm me Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”:

Viti	Numri i Rekomandimeve Legjislative
2012	4
2013	2
2014	7
2015	3

Tabela Nr. 11: Numri i Rekomandimeve Legjislative të KMD nga 2012-2015

II.2.1.1. Rekomandime për Ligjin nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”

KMD ka dërguar rekomandim për ndryshime mbi Ligjin nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”. Rekomandimi i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ka si qëllim rishikimin e neneve 16 e 17 të ligjit (këto dispozita rregullojnë përcaktimin apo ndryshimin e vendbanimit), për eliminimin e dispozitave që sjellin pasoja diskriminuese për shkak të gjinisë. Ky rekomandim erdhi si pasojë e bashkëpunimit të KMD me Qendrën për Nisma Ligjore dhe Qytetare.

II.2.1.2 Rekomandim “Për marrjen e masave për eliminimin e situatës diskriminuese në lidhje me trajtimin me karburant dhe lubrifikantë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik”

KMD ka dërguar rekomandim “Për marrjen e masave për eliminimin e situatës diskriminuese në lidhje me trajtimin me karburant dhe lubrifikantë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik.” Ky rekomandim i është drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe erdhi si pasojë e bashkëpunimit të KMD me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (ADRF). Në analizë të legjislacionit dhe praktikës së ndjekur rezultoi se:

- ekzistonte një situatë diskriminuese brenda kategorisë së personave me aftësi të kufizuara në lëvizje, siç janë personat paraplegjik dhe tetraplegjik që gëzojnë statusin e invalidit të punës në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, të ndryshuar dhe atyre që kanë statusin në bazë të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar ;
- ekzistonte një situatë diskriminuese brenda kategorisë së personave paraplegjik dhe tetraplegjik që kanë statusin e invalidit të punës në bazë të ligjit 7889/14.12.1994, në varësi të kohës se kur e kishin fituar këtë status.

Institucioneve përkatëse iu rekomandua:

- ndryshimi i menjëhershëm i procedurave të ndjekura pasi bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994, të ndryshuar , Rregulloren nr. 7, datë 24.12.2009 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar”, të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe VKM nr. 723, datë 19.11.1998 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”
- rishikimin me qëllim qartësimin dhe shmangien e keqinterpretimeve të Rregullores nr. 7 datë 24.12.2009 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar”, të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve shoqërore dhe

VKM-së nr. 723, datë 19.11.1998 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”

- marrjen e masave urgjente nga ana e MMSR për plotësimin e legjislacionit me qëllim bërjen të mundur që kategoritë e personave me aftësi të kufizuar paraplegjik dhe tetraplegjik, pavarësisht nëse ata kanë statusin e invalidit të punës sipas ligjit 7889/1994 apo statusin si invalid paraplegjik dhe tetraplegjik sipas ligjit nr. 8626 datë 22.06.2000, të marrin të njëjtat përfitime nga ana e shtetit.

II.2.2. Opinione

II.2.2.1. Opinion për Gjykatën Kushtetuese

Në mars të 2015, Gjykata e Lartë, ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë me objekt: “Shfuqizimi i nenit 113 të Kodit Penal si nen që vjen në kundërshtim me Kushtetutën”. Me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, KMD ka parashtruar opinionin e tij lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, duke mbështetur kërkesën e Gjykatës së Lartë për shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2012 një rekomandim për: “*Shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal me qëllim që viktimat e trafikimit të mos bëhen subjekte të ndjekjes penale dhe ndëshkimit*”. Në ndryshimet që Kuvendi i Shqipërisë i bëri Kodit Penal me ligjin nr. 23/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk e shfuqizoi nenin 113, por këtij neni i shtoi një paragraf të dytë, nëpërmjet të cilit ndëshkohej edhe personi i cili ofronte shpërbllim për përfitim personal të prostitucionit. Gjykata Kushtetuese, me vendimin 71/2015, vendosi rrëzimin e kërkesës.

II.2.2.2. Opinion për projektligjin “Për shërbimet shoqërore”

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë mendime për projektligjin “Për shërbimet shoqërore” Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, më datë 27.11.2015 gjatë takimit të grupit të punës.

Në ligjin 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Kreu IV, “Ndalimi i diskriminimit në fushën e të mirave e shërbimeve”, neni 20 “Të mirat e shërbimet”, është ndër nenet më të kompletuar të ligjit, te cilit mund t’i referoheni, si më poshtë:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku;

b) mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

ç) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor;

d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim;

dh) shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera;

e) shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim;

ë) lehtësi për argëtim, çlodhje e freskim;

f) lehtësi për transport ose udhëtim;

g) shërbimet e profesioneve të lira.

3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit.

5. Nuk përbëjnë diskriminim dallimet në shpërblime dhe përfitime, të vendosura për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, kur këto dallime janë të arsyeshme dhe në përpjesëtim me një rrezik, i cili vlerësohet në bazë të të dhënave aktuale dhe statistikore të vërtetueshme dhe të lidhura ngushtë me rrezikun.

6. Kostot lidhur me shtatzaninë dhe amësinë nuk mund të rezultojnë shkak për dallime në shpërblimet dhe përfitimet e individit.

7. Ndalimi i diskriminimit nuk zbatohet për caktimin e një moshe të veçantë për mundësi të përfitimeve sociale, të të mirave, lehtësive dhe shërbimeve, nëse ekzistojnë kritere të arsyeshme e objektive për caktimin, pa cenuar thelbin e së drejtës për përfitime dhe kur caktimi synon të

arrijë një qëllim të ligjshëm për një interes publik, ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, gjithmonë në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar caktimin".

Për sa më sipër, KMD i rekomandoi Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të përfshihet parimi i mosdiskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve si një parim më vete, në referencë të plotë të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

II.2.2.3. Opinion nga Drejtoria e Çështjeve, Procedurale Ligjore dhe Marrëdhëniet me Jashtë për kalimin e çështjeve në shqyrtim nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit

Drejtoria e Çështjeve, Procedurale Ligjore dhe Marrëdhëniet me Jashtë mori në shqyrtim informacionin e ardhur nga Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci⁹⁹, ku parashtrohen problematikat e mëposhtme:

- 1) Kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara të grupit të parë të përfituesve*** (si personat e prekur nga autizmi apo sindromi down) ***nuk përfitojnë sigurime shoqërore***, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë apo sëmundje profesionale, por vetëm pagesën e kujdestarisë.
- 2) Kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara të grupit të parë të përfituesve*** (si personat e prekur nga autizmi apo sindromi down) ***nuk përfitojnë lehtësira në transportin publik apo privat***. Sipas tyre, ky grup, ndryshe nga grupet e tjera të përfituesve dhe shoqëruesit e tyre, nuk kanë të drejtë të udhëtojnë falas në transportin urban, me librezën e invaliditetit.

Trajtimi i këtyre problematikave kërkon analizë të thelluar të kuadrit ligjor për mbrojtjen në të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ku përfshihen Kushtetuta e R.Sh., Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ligji kuadër nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK" dhe aktet nënligjore, si dhe kuadrin ligjor që rregullon fushat respektive, në të cilat pretendohet diskriminimi.

Duke qenë se KMD ka një praktikë të vitit 2014 lidhur me transportin qytetas falas për kategorinë e personave më dëshmi invaliditeti-pune, duke dhënë vendim diskriminimi¹⁰⁰

⁹⁹ Përmes shkresës me Nr. 57 Prot, datë 23.11.2015, protokolluar me tonën me Nr. 973 Prot, datë 24.11.2015.

¹⁰⁰ Gjatë vitit 2014, rezultoi që Komisioneri ka shqyrtuar ankesën sipas informacionit të mëposhtëm të përmbledhur: *Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë, ka paraqitur pranë KMD-së ankesën kundër Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas, me pretendimin e diskriminimit për shkak të "aftësisë së kufizuar". Me datë 01.07.2014, një numri të madh invalidësh i ishte mohuar e drejta për të udhëtuar falas në urbanët e linjave qytetase të Tiranës duke ushtruar ndaj tyre dhunë psikologjike dhe fizike nga ana e faturinove. Nga administrimi i fakteve dhe provave, Komisioneri konstatoi se pretendimi i Shoqatës së Invalidëve të Punës të Shqipërisë, ishte i vërtetë. Pavarësisht kësaj situatë, çështja për të cilën filloi ankesa e ardhur pranë KMD-së, u zgjidh në favor të kësaj kategorie personash, pasi gjatë periudhës së shqyrtimit, kjo kategori ka udhëtuar falas. Në përfundim të procedurës*

Drejtoria vlerësoi se duhet të analizohet legjislacioni si dhe zbatimi i tij në praktikë edhe për kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, duke marrë shkas nga informacioni i ardhur nga Qendra, e cila e ka ndeshur si problematikë. Gjithashtu, duhet analizuar edhe çështja e përfitimit të sigurimeve shoqërore nga ana e kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara të grupit të parë të përfituesve (si personat e prekur nga autizmi apo sindromi down), përveç asaj të kujdestarisë.

Për sa më sipër, bazuar në shpjegimet e pretenduara, vlerësoi se:

- Ka informacion të mjaftueshëm për hetim administrativ dhe
- Propozoi inicimin e 2 (dy) çështjeve *ex-officio*, sipas dy problematikave të parashtruara nga Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, sipas kompetencës Drejtorisë së Hetim-Inspektimit.

II.3. Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjësit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar nëpërmjet një serë kompetencash për këtë qëllim, si - nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; - adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; - informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; - zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Ndërgjegjësimi realizohet kryesisht përmes:

II.3.1. Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuëse dhe manualeve trajnuëse

Hartimi, publikimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuëse e manualeve trajnuëse

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka hartuar dhe botuar, gjatë 2015, një sërë materialesh informuese dhe ndërgjegjësuëse, nga ku listojmë:

hetimore, Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, ndaj kategorisë së personave më dëshmi invaliditeti-pune, nga ana e operatorëve privatë të shërbimit të transportit qytetas të Tiranës, si dhe pushimin e çështjes për shkak se situata është zgjidhur në favor të kësaj kategorie. Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas iu rekomandua të kishte në vëmendje, zbatimin me korrektësi të gjithë kuadrit ligjor të cituar në vendim, që në të ardhmen të mos ketë sërish përsëritje të situatave të ngjashme në dëm të kësaj kategorie personash.

- Botimi i "Përmbledhje e Vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në 1200 kopje.
- Broshura informative mbi ligjin "P r Mbrojtjen nga Diskriminimi" në fushën e punësimit në 1000 kopje.
- Broshura informative mbi ligjin "P r Mbrojtjen nga Diskriminimi" në fushën e shërbimeve në 1000 kopje.
- Broshura informative mbi ligjin "P r Mbrojtjen nga Diskriminimi" në fushën e arsimit në 1000 kopje.

Publikime të tjera, që janë përgatitur gjatë viteve, dhe që KMD i ka shpërndarë në aktivitete të ndryshme gjatë 2015, në institucionet qendrore dhe vendore, gjykata, organizatat ndërkombëtare dhe universitete, janë:

- Botimi shqip dhe anglisht i "*Përmbledhje e vendimeve të KMD-së dhe Opinioneve të Bordit të Ekspertëve*", shpërndarë 634 copë.
- Botimi me përkthime "*Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Organeve të Barazisë*" shpërndarë 443 copë.
- Studim "*Mbi problematikën e diskriminimit të komunitetit Rom në Shqipëri*", shpërndarë 341 copë.
- "*Diskriminimi në arsim në këndvështrimin e Komisionerit p r Mbrojtjen nga Diskriminimi*", shpërndarë 254 copë.
- Raport i Veçantë "*P r mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri*", shpërndarë 546 copë.
- Broshurë informative mbi ligjin "P r Mbrojtjen nga Diskriminimi" në fushën e arsimit (për sistemin arsimor parauniversitar), shpërndarë 323 copë.
- Fletëpalosje informuese, shpërndarë 360 copë.
- Ligj "*P r Mbrojtjen nga Diskriminimi*", shpërndarë 1009 kopje në shqip dhe 146 në anglisht.

II.3.2. Organizimi i trajnimeve, takimeve, workshop dhe Ditëve të Hapura

- Gjatë 2015, KMD ka ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësuëse në sistemin arsimor, konkretisht në shkollat 9-vjecare dhe te mesme të qarkut të Tiranës. Deri në muajin mars, KMD ka realizuar 8 takime informuese me nxënësit dhe stafin mësimor të shkollave të përzgjedhura.
- Me datë 24 prill 2015, KMD në bashkëpunim me Ambasadën PINK/LGBT Pro Shqipëri dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë organizuan workshop-in me temë "5 vjet anti-

diskriminim dhe masat e mëtejshme". Në këtë workshop u prezantuan raste studimore nga KMD dhe gjithashtu ndërgjegjësimi i bërë këto 5 vjet për ligjin.

- Me datë 30 prill 2015 KMD dhe Gjimnazi Petro Nini Luarasi ka organizuar workshopin me temë "*Stop Diskriminimit - Ndryshimi Fillon Nga Ne*".
- Me datë 14 maj 2015 KMD ka organizuar një tryezë të rrumbullakët pranë ambienteve të KMD me studentet e Fakultetit të Shkencave Sociale që janë praktikant pranë "Institute of Romani Culture in Albania".
- Në datën 25 maj 2015 KMD në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, organizuan "*Trajnimin e Policisë së Shtetit mbi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi*".
- Gjatë muajit maj 2015 KMD ka organizuar një trajnim me zëdhënëset e Drejtorive të Policisë në Qarqe, lidhur me ligjin "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*".
- Gjatë periudhës së raportimit, KMD ka zhvilluar në total 4 (katër) Ditë të Hapura. Gjatë këtyre aktiviteteve, përfaqësues të zyrës së KMD kanë realizuar sesione informuese mbi ligjin dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe janë shpërndarë Fletëpalosje dhe Broshura Informuese mbi ligjin në gjuhët e pakicave dhe në formate të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara në shikim (me shkrim *Braille*). Aktivitetet ishin një mundësi e mirë për marrjen e ankesave nga personat e pranishëm mbi problematikat e tyre, që mund të gjejnë zgjidhje nga KMD, në kuadër të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

II.3.3. Pjesëmarrja aktivitete

Gjatë vitit 2015, Zyra e KMD-së ka marrë pjesë në 40 aktivitete, si seminare, trajnime, tryeza diskutimi, grupe pune, workshop, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Për informacion mbi aktivitetet ku stafi KMD ka marrë pjesë në aktivitete të organizuar nga aktorë të tjerë referojuni Aneks 2 të këtij raporti.

II.3.4. Leksione të Hapura, trajnime të aktorëve të ndryshëm dhe prezantime

- Me datë 9 qershor 2015, prezantim i Komisioneres në Konferencën Rajonale "*Për zbatimin dhe ekzekutimin e legjislacionit kundër diskriminimit*", organizuar nga OSBE Kosovë.
- Me datë 29 qershor 2015 Leksion i Komisioneres me temë "*Aksesi në drejtësi i personave me aftësi të kufizuara*", pranë Shkollës së Magjistraturës.
- Me datë 14 korrik 2015, Leksion me temë "*Mbi rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", në Akademinë për të Drejtat e Minoriteteve, organizuar nga Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut me mbështetjen e Ambasadës Gjermane.
- Me datë 9 - 10 nëntor 2015, Leksion i Komisioneres pranë Akademisë së Sigurisë me tematikë "*Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes në veprimtarinë e policisë*".

- Në dhjetor 2015 - Prezantim i Komisioneres në Konferencën “E drejta e web-it, mes mbrojtjes së privatësisë, kërkesave për siguri dhe demokracisë”, organizuar nga Universiteti Katolik “Zonja e Këshillit të Mirë”, me temë: Një vështrim filozofik dhe juridik mbi konceptin e privatësisë, evoluimi i mbrojtjes së të drejtës së privatësisë nga praktika gjyqësore ndërkombëtare, përdorimi i medias dhe rrjeteve sociale për të nxitur gjuhën e urrejtjes ndaj grupeve vulnerabël dhe roli i institucioneve në mbrojtjen e tyre.
- Leksion i hapur me studentët e gazetarisë të Universitetit të Tiranës dhe universitetit Beder.

II.3.5. Rritja e vizibilitetit në media dhe monitorimi i vazhdueshëm i trajtimit të çështjeve të diskriminimit në media

Në kuadër të rritjes së vizibilitetit në media dhe monitorimit të vazhdueshëm të trajtimit të çështjeve të diskriminimit në media, do të theksonim dy aspekte:

Së pari, realizimin e shkrimeve, artikujve shkencor me tematikë çështjet e diskriminimit, pjesëmarrjen në emisione televizive me tematika sociale apo artikuj në median e shkruar ;

Së dyti, monitorimi i shtypit të shkruar. Nga përditësimi i monitorimit të shtypit të shkruar, gjatë periudhës janar 2015- 31 dhjetor 2015, janë shkëputur gjithsej 238 artikuj nga gazeta të ndryshme¹⁰¹. Artikujt në fokus kanë patur disa prej grupeve vulnerabël si psh: *fëmijët, gratë e dhunuara, personat me aftësi të kufizuar, romët, komunitetin LGBT*, etj.

Disa nga grupet vulnerabël që përcillen në media përmes artikujve të shkruar, (dalë nga leximi i shtypit) janë:

1. **Gratë** (kryesisht dhuna ndaj tyre) – **16 artikuj**
2. **Komuniteti LGBT** – **13 artikuj**
3. **Fëmijët** (me gjithë problematikat e tyre kryesisht të shfrytëzimit, dhunimit e trafikimit të tyre) – **49 artikuj**
4. **Romët** – **42 artikuj**
5. **PAK** (Personat me aftësi të kufizuar) – **42 artikuj**
6. **Artikuj në mbrojtje të të drejtave të njeriut** – **19 artikuj**
7. **Dhuna ne Familje** – **24 artikuj**

¹⁰¹ Gazetat nga të cilat kemi shkëputur artikujt, lidhur me tematikat e sipërpërmendura, janë: Gazeta Shqiptare; Gazeta Shqip; Gazeta Telegraf; Gazeta Shqiptarja.com; Gazeta Mapo; Gazeta Standard; Gazeta Tirana Observer; Gazeta Sot; Gazeta Panorama; Gazeta RD; Gazeta Zëri i Popullit; Gazeta Shekulli; Gazeta Shqip; Gazeta Tema; Gazeta Koha e Jonë; Gazeta Integrimi; Gazeta Dita.

II.4. Studime e Monitorime mbi diskriminimin dhe Raportime të KMD

Bazuar në nenin 32, pika 1 gerat (dh), (e), (f) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, KMD ka zhvilluar aktivitetin e mëposhtëm.

II.4.1. Studime të KMD mbi diskriminimin

Gjatë 2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim ka hartuar dhe botuar:

1. Studim “Mbi Situatën e Diskriminimit të Grave në Shqipëri”

Në këtë studim, KMD ka ngritur disa shqetësime lidhur me situatën diskriminuese të grave në Shqipëri:

- *Gratë përballen me diskriminim në marrëdhëniet e punës.*
- *Në fushën e të mirave dhe shërbimeve, gratë përballen me pabarazi dhe forma të drejtpërdrejta e të tërthorta diskriminimi.*
- *Aksesi i grave në përfitimet nga skemat sociale dhe ekonomike.*
- *Aksesi i grave në kredi, ndihma hipotekore dhe forma të tjera të kreditit financiar është ende i ulët.*
- *Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje. KMD ka vlerësuar edhe më herët si të domosdoshme nevojën për ndryshime në kuadrin ligjor.*
- *Dhuna në familje, vazhdon të mbetet një nga fenomenet më shqetësuese me të cilën përballen gratë. Pavarësisht zhvillimeve në Kodin Penal dhe legjislacionit administrativo civil, efektiviteti i zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje ka nevojë të forcohet.*
- *Vlen të theksohet fakti se numri i ankesave me pretendim “diskriminim për shkak të gjinisë” është i vogël, megjithatë kjo nuk e përjashton faktin se viktimat në pjesën dërrmuese të rasteve të marra në shqyrtim, qofshin ato edhe shkaqe të ndryshme, janë më shumë gra. Deri më 23.09.2015. Nga 30 rastet ku është konstatuar diskriminimi, në 18 raste subjektet e diskriminuara janë femra.*

II.4.2. Monitorime të KMD mbi diskriminimin

Gjatë vitit 2014, KMD ka vazhduar me realizimin e monitorimeve :

- Zbatimi i Ligjit “P r Mbrojtjen nga Diskriminimi” në sektorin privat të punësimit. Ky monitorim është fokusuar në mënyrë të veçantë tek aksesin e grupeve vulnerabël në punësim;

- Monitorimi i zbatimit të Ligjit “P r Mbrojtjen nga Diskriminimi” nga gjykatat

Në kuadër të këtij të fundit, me shkresë nr. 705 Prot, date 31.07.2015, KMD ka kërkuar nga te gjitha Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, informacionet mbi çështjet që kanë në objekt: pretendim diskriminimi. Nga statistikat e mbledhura deri tani, kanë kthyer përgjigje 24 gjykata. Nga këto, rezulton se vetëm 4 gjykata kanë trajtuar çështje diskriminimi. Gjykata Administrative e Shkalës së Parë, Tiranë është ajo me numrin më të madh të çështjeve.

II.4.3. Raportime të KMD

II.4.3.1. Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi para Organizatave Ndërkombëtare dhe Rajonale

Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar informacion “Mbi Takimin Vjetor të dimensionit njerëzor të ODIHR-it”,¹⁰² sipas fushës së kompetencës së tij, bazuar në axhendën e takimit.

Me qëllim përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut në kuadrin e OKB-së, vendi ynë do të paraqesë pranë Komitetit për të Drejtat e Punonjësve Migrantë, Raportin Periodik Kombëtar. KMD është pjesë e grupit të punës për hartimin e këtij raporti periodik ndërkombëtar. Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar informacion për Hartimin e Raportit “Mbi zbatimin e Konventës së OKB-së “Për Mbrojtjen e të drejtave të punonjësve Migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre”, në zbatim të nenit 1/1 dhe nenit 7 të kësaj Konvente.¹⁰³

Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar informacion lidhur me përditësimin e Raportit të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut “Mbi ligjet dhe praktikat diskriminuese si dhe aktet e dhunës kundër individëve, që bazohen në orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor”¹⁰⁴. Qëllimi i përditësimit të raportit në fjalë ishte shkëmbimi i praktikave dhe mënyrave pozitive për të tejkaluar dhunën dhe diskriminimin, bazuar në kuadrin ligjor dhe standartet ndërkombëtare, që lidhen me çështjen e orientimit seksual dhe identitetin gjinor. Në zbatim të rezolutës 27/32 “Mbi të drejtat e njeriut, orientimin seksual dhe identitetin gjinor” miratuar në shtator 2014 nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) u kërkoi shteteve palë të japin kontributet e tyre lidhur me përditësimin e raportit si dhe mbi praktikat dhe mënyrat e suksesshme për të tejkaluar dhunën dhe diskriminimin, që bazohet në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

¹⁰² Me shkresë zyrtare Nr.725/1 Prot, datë 11.09.2015.

¹⁰³ Me shkresë zyrtare Nr. 914/1 Prot, datë 23.11.2015.

¹⁰⁴ Me shkresë zyrtare Nr. 34/1 Prot, datë 20.01.2015.

II.4.3.2. Raportime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të procesit të integritetit evropian

Në datën 23 mars 2015, Komisioneri ka raportuar në kuadër të **Takimit të Gjastë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit**, Bashkimi Evropian-Shqipëri i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, zhvilluar në Bruksel. Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Integritetit, Komisioneri ka dërguar informacion¹⁰⁵ për çështjet për trajtim në këtë takim, përfshirë zhvillimet nga takimi i mëparshëm i këtij komiteti. Raportimi është fokusuar në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Dokumentit të Partneritetit Evropian (2007) për sa kohë i aplikueshëm, rekomandimeve të Raportit të Progresit 2014, si dhe rekomandimeve të nën-komiteve të Stabilizim-Asociimit.

Në datat 21-22 Prill 2015 Komisioneri ka raportuar në Takimin e Shtatë të **Nën-komitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë”**, në Bruksel. Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Integritetit, Komisioneri ka dërguar informacion¹⁰⁶ mbi zhvillimet konkrete të institucionit, sipas fushës së veprimtarisë, për periudhën e raportimit nga 18 prill 2014 - 13 Mars 2015 dhe ka raportuar, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, në takimin e këtij nënkomiteti.

Në datat 26 Nëntor 2015 Komisioneri ka raportuar në Takimin e Shtatë të **Nën-komitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale”**, në Tiranë. Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Integritetit, Komisioneri ka dërguar informacion¹⁰⁷ mbi zhvillimet konkrete të institucionit, sipas fushës së veprimtarisë, për periudhën e raportimit nga 25 Nëntor 2014 - 30 Tetor 2015 dhe ka raportuar, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, në takimin e këtij nënkomiteti.

KMD ka dërguar kontributin e parë dhe të dytë për përgatitjen e Raportit 2015 për Shqipërinë, sipas fushës së veprimtarisë së tij, për periudhat e kërkuara të raportimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kontribuar në kuadër të **Udhërrëfyesit/RoadMap mbi 5 Prioritetet**, në të cilin KMD ka parashikuar masa në kuadër të Prioritetit 5 “*Të Drejtat e Njeriut*”. KMD ka raportuar në mënyrë periodike në lidhje me masat dhe aktivitetet e parashikuara në kuadër të zbatimit efektiv të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut mbi këtë ligj. Gjithashtu, përfaqësuesi i KMD ka marrë pjesë në takime periodike të grupit të punës.

¹⁰⁵ Me shkresë zyrtare Nr. 185/1 Prot. datë 11.03.2015.

¹⁰⁶ Me shkresë zyrtare Nr. 215/1 Prot. datë 16.03.2015.

¹⁰⁷ Me shkresë zyrtare Nr. 869/1 Prot. datë 30.10.2015.

KMD raporton pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në mënyrë periodike për Kapitullin 19 “Politikat Sociale dhe Punësimi” dhe merr pjesë në takime mujore mes anëtarëve të GNP-së të këtij grupi, të ngritur në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 107 datë 28.02.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNP) për Integrimin Evropian”.

II.4.3.3. Seancat Publike në Kuvend

Gjatë viti 2015, KMD ka marrë pjesë në disa seanca dëgjimore në Kuvend, nga të cilat përmendim:

- Pjesëmarrja në nënkomisionin për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje zhvilloi seancën dëgjimore publike për shqyrtimin e raportit të veçantë të Avokatit të Popullit “Për dhunën ndaj gruas”, si dhe për diskutimin e hapave konkret. Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi, theksoi se komisioni të jetë pjesë e mekanizmit kundër dhunës sepse nuk është aktualisht. Me tej tha se “kemi bërë trajnimin e nëpunësve vendorë, në mënyrë që çdo shërbim, të ofrohet në zbatim të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Kemi pasur një sërë trajnimesh me gjyqtarët dhe e kemi vendosur fokusin edhe të çështjet që kanë të bëjnë me vendosjen e urdhrave të mbrojtjes dhe të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes”, tha znj. Baraku duke shtuar se ka edhe mjaft dispozita ligjore të cilat bëhen shkak për diskriminimin mbi bazë gjinore.
- Shoqëria Civile dhe Aleanca e Grave Deputete propozojnë vendosjen e kuotës gjinore 40% në kodin zgjedhor dhe zgjedhjet vendore 2015.
- Me datë 04.10.2015, Komisioneri mori pjesë në Takimin me grupin parlamentar “Miq të fëmijëve” .
- Me datë 31 gusht 2015, pjesëmarrje e Komisioneres në tryezën e diskutimit publik “Drejtësia e të miturve në fokus të reformës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri”.

II.5. Bashkëpunime

II.5.1. KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit Europian të Organeve të Barazisë

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Europian, është përmbushur një nga kushtet për t’u përfshirë në EQUINET - Rrjetit Europian të Organeve të Barazisë. Këto të fundit, sipas Equinet, janë institucione të pavarura publike që promovojnë barazinë dhe luftojnë diskriminimin në vendet e tyre. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bërë anëtar i EQUINET me datë 4 Dhjetor 2014, gjatë votimit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (AGM) nga anëtarët e Rrjetit.

Aktualisht, EQUINET është rrjeti i 42 organeve të barazisë në 32 vende europiane. KMD e vlerëson anëtarësimin në EQUINET si një mundësi e mirë për shkëmbimin e eksperiencave dhe të informacionit mbi legjislacionin dhe politikat e barazisë dhe të mos-diskriminimit në nivel evropian.

Stafi i KMD është përfshirë në shtatë grupe pune të këtij rrjeti gjatë 2015, duke vlerësuar pjesëmarrjen si në aspektin e rritjes së kapaciteteve profesionale ashtu edhe në shkëmbimin e praktikave ndërmjet organeve të barazisë në vende të ndryshme të Europës, konkretisht në:

1. Grupin e Punës për Legjislacionin e Barazisë
2. Grupin e Punës për komunikimin, strategji dhe praktika
3. Grupin e Punës për barazinë gjinore
4. Grupin e Punës për hartimin e politikave
5. Grupin e Punës për çështjet gjyqësore strategjike
6. Grupin e Punës për vlerësimin e projekteve
7. Grupin e Punës mbi standartet e Organeve të Barazisë

Gjatë vitit 2015, punonjësit e KMD, anëtar të grupeve të punës, kanë marrë pjesë në aktivitetet e Equinet si: mbledhjet e grupeve të punës të zhvilluara nga rrjeti, në seminare kualifikuese dhe konferenca me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve të barazisë, ku përmendim seminarin “Karta e BE: Organet e Barazisë dhe të Drejtat Themelore në BE” dhe konferencën: “Organet e Barazisë dhe Direktiva e re për lëvizjen e lirë – sfidë apo mundësi?” si dhe në mbledhjen vjetore të përgjithshme të Equinet. Gjithashtu, punonjësit e KMD, anëtar të grupeve të punës, janë pjesë aktive e komunikimit me përfaqësues të organeve europiane të barazisë, duke shkëmbyer informacione lidhur me parashikime ligjore dhe praktika institucionale për çështje specifike si dhe duke dhënë kontribut për hartimin e materialeve si raporte, përmbledhje, sondazhe, ku përmendim “Sondazh i Equinet për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, Këndvështrimi i Equinet mbi veprimtarinë e Organeve të Barazisë në fushën e diskriminimit për shkak të Besimit Fetar, etj.

KMD ka bashkëpunuar me EQUINET në përcjelljen e informacionit të përmbledhur të dy çështjeve në hetim administrativ, me qëllim marrjen e eksperiencës së këtyre vendeve në zgjidhjen e rasteve të tilla dhe legjislacionit të brendshëm që parashikon këto zgjidhje. Pas fazës së grumbullimit të informacionit ku jemi aktualisht, do të hartohet një vështrim krahasues i legjislacionit të brendshëm të vendeve anëtare të BE dhe kandidatave potenciale me legjislacionin shqiptar.

EQUINET ka publikuar në faqen zyrtare botime të KMD, si Botimi i "*Përmbledhje e Vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*"¹⁰⁸ dhe Raportin e Veçantë "*P r mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri*", duke i bërë të njohura edhe për anëtarët e këtij rrjeti por edhe për publikun e gjerë.¹⁰⁹

II.5.2. Pjesëmarrja dhe kontributi i KMD në grupe pune

Pjesëmarrja e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në grupe të ndryshme pune, përbën një ndër veprimtaritë kryesore ku KMD është përfshirë në dhënien e kontributeve, si organ i specializuar, në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

- Komisioneri është pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për integrimin evropian, në zbatim të Urdhrit Nr. 107 datë 28.02.2014 "*P r ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian*".
- Komisioneri është pjesë e grupit të punës për hartimin e m pas raportimin në kuadër të *Udhërrëfyesit/ RoadMap mbi 5 Prioritetet*, në të cilin KMD ka parashikuar masa në kuadër të Prioritetit 5 "*Të Drejtat e Njeriut*". Gjithashtu, KMD ka marrë pjesë në takime periodike të grupit të punës.
- Komisioneri është pjesë e grupit të punës "*Për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) 2016-2020*", si pjesë e Dokumentit të Politikave për Përfshirje Sociale dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020).
- Komisioneri është pjesë e grupit të punës "*Për hartimin e Raportit mbi zbatimin e Konventës së OKB-së "Për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre*".
- Komisioneri ka qenë pjesë e grupit të punës "*Mbi përditësimin e Planit Kombëtar të Integritit Evropian për periudhën 2016 – 2018*".
- Komisioneri ka qenë pjesë e grupit për vendosjen e Objektivave Strategjike për pesë vitet e ardhshme për zyrën e ALO 116.
- Komisioneri ka qenë pjesë e grupit "*Me shoqërinë civile ngritja e regjistrit kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve nga krimet seksuale në Shqipëri*".
- Dy përfaqësues të zyrës së Komisionerit janë anëtarë të "*Mekanizmit të Koordinimit Vendor*" (MKV). Ky mekanizëm shërben për rritjen e aksesit në shëndetësi dhe përthithjen e fondeve për personat me HIV dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme. Një nga nënkryetarët e Komitetit Mbikëqyrës është nga stafi i KMD.
- Komisioneri ka qenë pjesë e gjatë grupeve të punës, me tematika të ndryshme, të Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë – EQUINET.

¹⁰⁸ <http://www.equineteurope.org/Summary-of-the-Decisions-of-the>

¹⁰⁹ <http://www.equineteurope.org/Report-on-the-protection-of-rights>

II.5.3. Marrëveshje Bashkëpunimi të nënshkruara

Gjatë 2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me:

1. Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës.

Në kuadër të kësaj Marrëveshje, me datë 18 shtator 2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në ambjentet e këtij institucioni një delegacion me përfaqësues nga institucionet e vuajtjes së dënimit, sociologë, përfaqësues të shoqërisë civile, mekanizmit kundër torturës pranë Ombudsmanit nga Serbia dhe Mali Zi në kuadër të bashkëpunimit me Qendrën Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës. Gjatë takimit, të pranishmit u njohën me Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, kompetencat e Komisionerit, studimet monitorimet, rekomandimet legislative, proceset gjyqësore, format e realizimit të ankesës, formulari, ankesa online, tipologjia e ankesave dhe vendimet e Komisionerit, bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

2. Akademinë Profesionale të Biznesit, Tiranë.

KAPITULLI III

ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

III.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore

1. Në institucionin e KMD-së aktualisht punojnë 21 persona, nga të cilët 15 kanë statusin e nëpunësit civil, të fituar në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil ndërsa 3 të tjerë janë në periudhë prove. Ndërsa 3 punonjës të tjera rregullohen me Kod Pune.

2. Procedurat për nëpunësit civil i janë nënshtruar kontrollit nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vitin 2015, i cili ka hartuar raportin përfundimtar “*Për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë në Administrimin e Shërbimit Civil*”. Në këtë raport, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka konstatuar zbatimin korrekt të procedurave nga institucioni i KMD-së dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse.

3. Gjatë vitit 2015, pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bërë punësimi me kontratë i specialistit në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe më pas është kryer konkurrimi dhe është emëruar specialist i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse. Gjithsej, janë zhvilluar 5 procedura konkurrimi për pozicione të lira pune, bazuar në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”. Gjithashtu, kanë marrë konfirmimin punonjësit që kishin përfituar statusin e nëpunësit civil, sipas kërkesave të ligjit të mëparshëm, dhe janë konfirmuar punonjësit në periudhë prove.

4. Nëpunësit e KMD-së kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme si, trajnime të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Trajnimet janë fokusuar në çështjet që kanë të bëjnë me njohjen e Administratës Publike, përgatitjen e letrave dhe komunikimeve zyrtare, hartimin e kontratave, sistemin e menaxhimit informacionit të burimeve njerëzore, mbrojtjen e të dhënave personale dhe menaxhimi i programit të transparencës, zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, për hartimin e përkrahjes dhe klasifikimin e pozicioneve të punës, vlerësimi e rezultateve në punë të nëpunësve civil, organizimi i dosjes dhe regjistrimit të personelit, masat disiplinore dhe procedurat e apelit, sipas këtij ligji. Trajnim për sistemin të menaxhimit të Regjistrimit Qendror të Personelit

(HRMIS) që do të menaxhoj dosjet e personelit dhe do llogarisë pagën në mënyrë elektronike për të gjithë nëpunësit.

Punonjësit e KMD-së kanë marrë pjesë në takime dhe aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e nivelit profesional në trajtimin e çështjeve të diskriminimit, si mbrojtja nga diskriminimi për shkak të gjinisë, etnicitetit, orientimit seksual dhe aftësisë së kufizuar, monitorimi i zbatimit të Konventës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, përmirësimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në luftën kundër diskriminimit, integrimi gjinor për nëpunësit e barazisë gjinore në nivel vendor, përfshirja e çështjeve LGBT në politikat sociale, të drejtat e njeriut në praktikë etj. Janë organizuar Ditë të Hapura me komunitetet rome dhe egjiptiane për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e këtyre komuniteteve në lidhje me ligjin nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

5. Në mbështetje të ligjit Nr. 7995 Date 20.9.1995 “Për Nxitjen e Punësimit” i ndryshuar, dhe VKM-ve në zbatim të tij dhe më bashkëpunim me Zyrën e Punës Tiranë, kanë kryer praktikën profesionale pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2 persona nga grupi i personave me aftësi ndryshe .

6. Gjatë vitit 2015, në institucionin e KMD-së, është kryer edhe kontrolli i dosjeve nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për zbatimin e ligjit nr. 9049, date 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë” i ndryshuar, ku u konstatua zbatimi korrekt i ligjit.

III.2. Menaxhimi i burimeve financiare

Mbi Performancën Financiare Buxhetore të KMD për vitin 2015

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në zbatimin të buxhetit të vitit 2015, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

KMD, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektësi në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për Buxhetin e vitit 2015”, në vijim Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 06. 02. 2012, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit dhe zbatimin të Udhëzimit Plotësues nr. 2 , Datë 09.01.2015 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2015”.

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Buxheti i akorduar për këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit: Organizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për

mirëfunksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me legjislacionin e vendeve të tjera të bashkimit evropian; sigurimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe hartimi i strategjive për realizimin e këtij synimi; vendosja e marrëdhënjeve dhe hartimi marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që ndikojnë në zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e zbatimit të parimit të barazisë; nxitja dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve që kanë interes të drejtpërdrejtë si dhe të gjithë shoqërisë mbi mundësitë e zbatimit të parimit të mësipërm, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond i planifikuar prej **37.500 në mijë lekë**. Totali i vlerës së akorduar duke përfshirë edhe fondin e donatorëve është **147,68 në mijë lekë** dhe përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	22. 000	<i>mijë lekë (zëri 600)</i>
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	4. 500	<i>mijë lekë (zëri 601)</i>
Fondi për Shpenzime Operative:	10. 000	<i>mijë lekë (zëri 602)</i>
Fondi për Investime:	1. 000	<i>mijë lekë (zëri 231)</i>
Fondi i Donacioneve:	147, 68	<i>mijë lekë (zëri 602)</i>

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 “*Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, numri mesatar i punonjësve është realizuar 21 vetë, nga 23 vetë të miratuar.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht; **17.793,34 (në mijë lekë)** për paga nga zëri 600 si dhe **2.771,57 (në mijë lekë)** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore nga zëri 601 ose **77.6 %** e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231): nga vlera e përgjithshme prej **1.000 (në mijë lekë)** për periudhën e raportuar janë arritur të realizohen në tremujorin e katërt të vitit, në zërin investime, projektet me vlerë **761,76 (në mijë lekë)** nga zëri 231 ose **76.18 %** e fondit të planifikuar.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602); për vitin 2015, është planifikuar në vlerën **10,000 në mijë lekë**. Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **6.466,67 (në mijë lekë)** ose **64.67 %**, e fondit të planifikuar.

Fondi i Donacioneve (zëri 602); për vitin 2015, është në vlerën **147,68 (në mijë lekë)**. Edhe për këtë zë, për periudhën respektive nuk është realizuar asnjë vlerë. Ky mosrealizim ka ardhur për arsye se detyrimi i ardhshëm kalon vlerën e sipërcituar dhe po pritet xhirimi i kestit të tretë dhe të fundit. Vlera e donacionit është parashikuar për aktivitete me organizatën **UNDP**.

Realizimi dhe monitorimi i përdorimit të fondeve publike në nivel të përgjithshëm ka qenë në masën **73,83 %**.

III.3. Programi i transparencës.

Nga periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2015 tek regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve janë regjistruar 25 kërkesa për informacion të ardhura nga autoritete publike si dhe nga individë të ndryshëm, ku ju është kthyer përgjigje ne baze te ligjit nr.119\2014 “Për te drejtën e informimit”.

KMD ka përcaktuar disa prioritetet për vitin 2016 si vijon:

- ✚ Forcimi i bashkëpunimit të KMD me organizatat që punojnë me grupe të marginalizuara si romët dhe egjiptianët, PAK, LGBTI, gratë, fëmijët etj me qëllim identifikimin e situatave që ngrenë çështjen e diskriminimit dhe rritjen e numrit të rasteve të nisura me iniciativë;
- ✚ Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese, përfshirjen e pushtetit vendor, organizatave që punojnë me grupet në nevojë, përdorimit të mediave elektronike dhe të shkruara si një mjet i rëndësishëm, etj.
- ✚ Përmirësimi i legjislacionit në përputhje me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe rritja e efektivitetit dhe zbatimit të tij, nëpërmjet rekomandimeve legjislative drejtuar autoriteteve përgjegjëse. Gjithashtu, KMD do të vazhdojë punën lobuese për marrjen në konsideratë të rekomandimeve legjislative të paraqitura në vitin 2014 dhe miratimin e tyre.
- ✚ Vijimi i organizimit të Ditëve të Hapura, duke patur në konsideratë faktin se gjatë aktiviteteve të tilla është rritur numri i ankesave për diskriminim, është rritur niveli i informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut dhe njohja më nga afër e problematikave të komunitetet.
- ✚ Duke patur parasysh shkaqet e ankesave për diskriminim gjatë vitit 2015, KMD do të forcojë punën për parandalimin e diskriminimit për shkak të racës, etnisë, bindjes politike, gjendjes ekonomike, gjendjes shëndetësore, PAK dhe shkaqeve të tjera.
- ✚ Nxitja e dialogut social në ambientet universitare për të diskutuar dhe trajtuar problematika dhe çështje të lidhura me diskriminimin dhe luftën kundër tij.
- ✚ Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me një numër sa më të madh aktorësh edhe gjatë vitit 2016 do jetë në vëmendjen e institucionit tonë.
- ✚ Vazhdimi i trajnimit të aktorëve (në kuadër të zbatimit të Projektit IPA 2013 – 2015) përfshirë administratën publik, qendrore dhe vendore, gjykatës, prokurorë dhe avokatë.
- ✚ Monitorimi i vazhdueshëm i mediave shqiptare, vizive dhe të shkruara, ku pasqyrohen çështjet e diskriminimit;

- ✚ Marrja e masave për të garantuar zbatimin efektiv të legjislacionit të ri të miratuar në fushën e arsimit, legjislacionit në fushën e punësimit, legjislacionin për PAK dhe formimit profesional, duke eliminuar barrierat në ndërtesa, transport, informacion, komunikim, si dhe në çdo aspekt tjetër të shërbimeve që janë publike, për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë, në baza të barabarta me të tjerët dhe pa u diskriminuar, të drejtat dhe liritë themelore.

- ✚ Ngritja e zyrave rajonale dhe përfshirje e komuniteteve përkatëse në mirëfunksionimin e tyre.

ANEKS 1

Kuadri ligjor për garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në Shqipëri

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991¹¹⁰. Në nenin 2, kjo Konventë përcakton detyrimin e shteteve palë të sigurojnë që të gjithë shtetasit të jenë subjekt i mbrojtjes së të drejtave të parashikuara në këtë konventë pa dallim race, ngjyre, seksi, gjuhe, përkatësie rajonale apo politike, përkatësie kombëtare, origjine sociale, pasurie ose status lindje. Neni 26 i këtij instrumenti parashikon se, “Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë ligjore pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi”.

Në korrik 2013, KMD ka qenë pjesë përbërëse e delegacionit që ka raportuar lidhur me zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, në kuadër të raportit të Dytë Periodik të Shqipërisë, gjatë Sesionit 106 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut. Në vëzhgimet përmbyllëse, Komiteti ka vlerësuar si aspekte pozitive miratimin, ndër të tjera, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në vitin 2010 dhe amendimet në Kodin Penal në Maj 2013 të cilat zgjerojnë mbrojtjen nga diskriminimi edhe për shkak të orientimit seksual.

Në komentimin e Përgjithshëm 18, Mosdiskriminimi, Komiteti i të Drejtave të Njeriut thekson se, mosdiskriminimi së bashku me barazinë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë ligjore pa diskriminim, përbëjnë një parim të përgjithshëm bazë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Komiteti thekson se, parimi i barazisë kërkon shpesh që shtetet palë të marrin masa pozitive për të eliminuar kushtet që shkaktojnë ose ushqejnë diskriminimin e ndaluar nga kjo konventë. Komiteti vëren se jo çdo trajtim i ndryshëm përbën diskriminim, nëse kriteret për këtë trajtim të ndryshëm janë të arsyeshme dhe objektive dhe nëse qëllimi është të arrihet një qëllim që është legjitim sipas konventës.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991¹¹¹. Shtetet palë të këtij instrumenti garantojnë që të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të shpallura në këtë Pakt, të ushtrohen pa kurrfarë diskriminimi. Disa nga të drejtat e parashikuara në këtë Konventë janë e drejta për punë, e drejta sindikale, e drejta e sigurimit shoqëror, e drejta për arsim, etj.

Në nëntor 2013, KMD ka qenë pjesë përbërëse e delegacionit që ka raportuar lidhur me implementimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore. Në

¹¹⁰ Ligji nr. 7510 date 08.08.1991 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”.

¹¹¹ Ligj nr. 7511 date 08.08.1991 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore”.

vëzhgimet përfundimtare të këtij Komiteti, mbi raportin e dytë dhe të tretë periodik të kombinuar të Shqipërisë, vlerësohet si pozitive miratimi i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ligjit “Për shëndetin mendor”, ratifikimi i Konventës së OKB “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ndryshimet në Kodin Penal lidhur me zgjerimin e mbrojtjes nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, si dhe punën e realizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.¹¹²

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012¹¹³, ka përcaktuar një sërë të drejtash për personat me aftësi të kufizuara, të cilat përkthehen në detyrime për shtetet palë. Këto parashikime duhen të udhëheqin ndryshimet legjislative, në kuadër të përshtatjes së legjislacionit të brendshëm shqiptar me këtë Konventë dhe garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në kuadrin e detyrimeve që u burojnë shteteve palë të Konventës. Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK” përshkohet nga parimi i barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, miratuar në vitin 1979, është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993¹¹⁴, dhe Protokollin Opsional i kësaj konvente në 2003¹¹⁵. Në legjislacionin shqiptar, një përkufizim të diskriminimit plotësisht në përputhje me CEDAË, gjejmë në ligjin 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” (neni 4) dhe në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (neni 3). Kjo konventë synon të sigurojë përmirësimin de fakto të pozitës së grave. KMD kontribuoi në përgatitjen e Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave”, miratuar me Vendimin nr.806, datë 26.11.2014. Nenet substanciale të kësaj konvente përcaktojnë detyrimet e shtetit shqiptar në lidhje me barazinë gjinore në përfaqësimin politik dhe në jetën publike, përfaqësimin në nivel kombëtar, shtetësinë, trafikimin dhe prostitucionin, barazinë në edukim, punësim, kujdesin shëndetësor dhe shëndetin riprodhues, mirëqenien ekonomike dhe sociale, barazinë para ligjit, barazinë në martesë dhe familje, etj. Në vendimet ose rekomandimet e marra për çështje që kanë ngritur pretendime për diskriminim, KMD është referuar në këtë konventë.

Në Vërejtjet Përmblyëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, Komiteti në sesionin e dytë të gjashtë, 12-30 korrik 2010, vlerësoi si aspekt pozitiv krijimin në vitin 2010 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, një organ i pavarur për nxitjen e barazisë,

¹¹² http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Doenload.aspx?symbolno=E/C.12/ALB/CO/2-3&Lang=En

¹¹³ Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

¹¹⁴ Ligji 1769/9.11.1993

¹¹⁵ Ligj nr. 9052, date 17.04.2003

monitorimin e zbatimit të legjislacionit anti-diskriminim, organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe hetimin e çështjeve që ngrenë pretendime për diskriminim¹¹⁶.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e ratifikuar nga Shqipëria në 1996¹¹⁷, në nenin 14 të saj parashikon “ndalimin e diskriminimit”, ndërsa Protokollin Nr. 12, në nenin 1, i referohet ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit, duke zgjeruar fushën e zbatimit të Nenit 14 edhe në rastet kur një person është diskriminuar në gëzimin e çdo të drejte ose përfitimi sipas legjislacionit kombëtar. Parimi i mosdiskriminimit që përshkon këtë konventë është i lidhur ngushtësisht me të drejtat e përcaktuara në nenet e konventës.

Konventa e Këshillit të Europës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”¹¹⁸ është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Me ligjin nr.104/2012, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje’”, shteti shqiptar pranoi detyrimin për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Konventa Kuadër e Këshillit të Europës Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, e cila pas ratifikimit është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka forcën e ligjit, është një garanci për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri;

Karta Sociale Evropiane, një traktat i Këshillit të Europës, e miratuar në vitin 1961 dhe e rishikuar në vitin 1963, është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm me ratifikimin e saj prej Shqipërisë në vitin 2002. Në këtë traktat trajtohen të drejta lidhur me strehimin, shëndetin, edukimin, arsimimin, punësimin, mbrojtjen sociale, etj.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial-ICERD, në të cilën Shqipëria ka aderuar në vitin 1994, kërkon nga shtetet palë marrjen e masave me qëllim eliminimin e diskriminimit për shkak të racës.

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, konkretizon nenin 18 të Kushtetutës. Ai është ligji organik mbi bazën e të cilit sigurohet mbrojtja nga diskriminimi. Progres Raporti për Shqipërinë 2014 vlerëson se Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është më së shumti në përputhje me *acquis* të BE-së¹¹⁹. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe

¹¹⁶ Vërejtjet Përmblyëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në sesionin e dyzetë e gjashtë të Komitetit CEDAW, në datat 12-30 korrik 2010, paragrafi 14.

¹¹⁷ Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, i ndryshuar.

¹¹⁸ Ligj Nr. 104 datë 11.08.2012 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”. Kjo Konventë ka hyrë në fuqi në 1 gusht 2014.

¹¹⁹ Komisioni Evropian, Progres Raporti për Shqipërinë 2014, I vlefshëm në websitin e Ministrisë së Integritimit www.integrimi.gov.al

mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi. Ligji rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë joshteruese shkaqesh. Në bazë të këtij ligji është krijuar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), si person juridik publik, i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij dhe si autoriteti përgjegjës, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin. KMD-ja ka kompetenca për të pranuar ankesa jo vetëm ndaj sektorit publik, por edhe ndaj subjekteve privatë dhe individëve. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore janë të parashikuara shprehimisht dhe përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Por, mbrojtja nga diskriminimi sipas Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” garantohej për të gjitha të drejtat e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Ligjet e brendshme gjithashtu sanksionojnë parimin e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, edhe pse ekziston nevoja për ndryshime apo miratimin e legjislacionit të ri për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi¹²⁰.

Kuadri ligjor në fushën e barazisë dhe mos-diskriminimit, për shkaqe të veçanta parashikohet edhe në ligjet e tjera si: Ligji nr. 9970, date 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri” i cili parashikon ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë në nenin 6 të tij; Ligji nr. 10347, date 04.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, i cili eliminon të gjitha format e diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës; Ligji nr. 9669, date 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, etj.

Niveli i mbrojtjes nga diskriminimi është rritur gjatë vitit 2014 me zbatimin e ndryshimeve të vitit 2013 në Kodin Penal¹²¹. Këtu mund të përmendim parashikimin si rrethanë rënduese të dënimit të motiveve të identitetit gjinor, orientimin seksual, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike dhe aftësisë së kufizuar¹²²; parashikimin si vepër penale të ngacmimit seksual (neni 108/a); kriminalizimin e nxitjes së urrejtjes apo grindjeve për shkak të orientimit seksual (neni 265); kriminalizimi i shkeljes së barazisë së shtetasve nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik edhe për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor (neni 253). KMD ka propozuar disa prej këtyre ndryshimeve. Disa nga rekomandimet e KMD nuk janë marrë në konsideratë në ndryshimet e vitit 2013 dhe për këtë arsye u janë ridërguar autoriteteve përgjegjëse. Këto të fundit lidhen me rekomandimet që:¹²³

¹²⁰ Një nevojë e tillë është konstatuar edhe në Progres Raportin 2013 Për Shqipërinë.

¹²¹ Me ligjin nr.144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar".

¹²² Shkaqe këto që mbrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Ligji “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”.

¹²³ Dërguar përmes Shkresës me nr. Prot 175, datë 07.03.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.

- pas nenit 84/a të Kodit Penal, të shtohet një nen tjetër me qëllim parashikimin si figurë të veçantë vepre penale të kanosjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit **(nuk është përfshirë në ndryshimet e Kodit Penal)**.
- të riformulohen ose të shtohen nene të reja pas nenit 119/a “*Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik*” dhe 119/b “*Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik*” në mënyrë që të kriminalizohet shpërndarja e materialeve homofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik dhe fyerja nëpërmjet sistemit kompjuterik për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit **(nuk është përfshirë në ndryshimet e Kodit Penal)**.
- neni 265 “*Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve*”, të riformulohet për të kriminalizuar edhe nxitjen e urrejtjes për shkak të identitetit gjinor **(nuk është përfshirë në ndryshimet e Kodit Penal)**.
- heqja e termit “*marrëdhënie homoseksuale*” që përmendet si në titull ashtu edhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal, Seksioni VI, ku parashikohen krimet seksuale, p r t’u vendosur “*marrëdhënie seksuale*”.

ANEKS 2

Pjesëmarrje e stafit të KMD në konferenca, trajnime, takime informuese dhe grupe pune

- Me datë 14.01.2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në një tryezë diskutimi me temë *“Prezantimi i raportit mbi situatën e respektimit të lirisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri”* organizuar nga Komiteti shqiptar i Helsinkit.
- Me datë 27.01.2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në tryezën e rumbullakët me temë *“Përmirësimi i kapaciteteve të Kuvendit për një qeverisje më të mirë të Sektorit të Sigurisë në Shqipëri”*, organizuar nga IDM.
- Me datë 02.02.2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në takimin me temë *Vendosja e Objektivave Strategjik për 5 Vitet e Ardhshme të linjes Alo 116*.
- Me datë 03.02.2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në workshop me temë *“Mbi forcimin e Institucioneve të Pavarura”* organizuar nga Komisioni Europian në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit me mbështetjen e TAIEX.
- Me datë 05.02.2015 Komisioneria mori pjesë në aktivitetin në lidhje me fushatën e informimit mbi platformat politike dhe forume publike gjate zgjedhjeve lokale 2015.
- Me datë 10.02.2015 Komisioneria mori pjesë në aktivitetin me temë *“Rritja e Përfaqësimit të Grave Shqiptare në Vendimmarrje”* të organizuar nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim në mbështetje të organizatës suedezë *“The Olof Palme International Center”*.
- Me datë 16.02.2015 një nga punonjësit e zyrës së KMD mori pjesë në takimin konsultues me temë *“Ngritja e Regjistrimit Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Krimet”*, organizuar nga CRCA.
- Me datë 06.03.2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në tryezën e rumbullakët me temë *“Për trajtimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore në komunitetet romë me fokus prostitucioni dhe fëmijët e rrugës”* të organizuar nga Këshilli i Europës dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
- Me datë 04.03.2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në seminarin me temë *“Prezantimi i Objektivave dhe Aktiviteteve kryesore të projektit Person”*.
- Me datë 05.03.2015 KMD mori pjesë në tryezën e rumbullakët *“Për trajtimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore në komunitetet romë, me fokus prostitucionin dhe fëmijët e rrugës”*, të organizuar nga Këshilli i Europës dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Kjo tryezë e rumbullakët për trajtimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore në komunitetet romë, me fokus prostitucionin dhe fëmijët e rrugës, u zhvillua me ekspertë nga vendet partnere (Greqi, Itali, Hollandë dhe Rumani), Këshillin e Sekretariatit të Europës,

- përfaqësues të qeverisë shqiptare dhe përfaqësues të OJF-ve dhe organizatave ndërkombëtare në Shqipëri.
- Me datë 17.03.2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në trajnimin me temë “*E drejta për informim, Autoritetet Publike ,koordinatori, programi i transparencës*”, organizuar nga KMDP.
 - Me datë 19.03.2015 KMD ka raportuar në nënkomitetin për “*Drejtësinë Lirinë dhe Sigurinë*” BE-Shqipëri.
 - Me datë 24.03.2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në takimin e parë të grupit të punës për hartimin e politikave në kuadër të EQUINET. Takimi u organizua në Bruksel.
 - Me datë 14.04.2015 një nga punonjësit e KMD-së mori pjesë në trajnimin me temë “*Të Drejtat LGBT dhe Ofrimi i Shërbimeve Miqësore*”.
 - Me datë 17.05.2015 KMD mori pjesë në paradën e biçikletave organizuar nga Aleanca kundër diskriminimit LGBT.
 - Me datë 14 maj, pjesëmarrja e KMD në vizitë studimore në Serbi pranë Komisionerit për Mbrojtjen e Barazisë.
 - Me datë 28 maj Seminari i organizuar nga ECRI “*Roli i institucioneve të Barazisë në adresimin e nivelit të ulët të raportimit të diskriminimit dhe krimit të urrejtjes*”.
 - Me datë 9-10 qershor 2015 një nga punonjësit e KMD mori pjesë në takimin e punës me temë “*Roli i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për Zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil*”.
 - Me datë 11.06.2015, përfaqësues të KMD morën pjesë në Marshimin e dytë të Krenarisë, Tirana Pride 2015. Ky marshim u organizua për të sjellë në vëmendjen e kandidatëve të zgjedhjeve vendore dhe votuesve LGBT se vota LGBT vlen.
 - Me datë 12.06.2015, dy punonjës të KMD morën pjesë në konferencën me temë: “*Avancimi i Përfshirjes Sociale të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, Praktika Efektive dhe Qëndrueshmëria*”, organizuar nga EU, UNDP dhe MMSR.
 - Me datë 16-17 qershor 2015, dy punonjës të KMD morën pjesë në seminarin me temë “*Karta e BE: Organet e Barazisë dhe të drejtat themelore në BE*”, organizuar nga EQUINET në Bruksel.
 - Me datë 01.07.2015 një punonjës i KMD mori pjesë në workshop-in me temë “*Mbi vlerësimin e përbashkët të fushave prioritare për zhvillimin në Shqipëri*” (Common Country Assessment), organizuar nga United Nations Albania. Qëllimi i këtij workshop ishte Prioritizimi i fushave për zhvillimin e vendit me qëllim përgatitjen e një Common Country Assessment - CCA (Vlerësim i Përbashkët i Vendit). Ky i fundit do të hartohet mbi bazën e një analize të UN Albania, qeverisë dhe partnerëve të tyre për të identifikuar bashkarisht fushat prioritare për zhvillim në vend dhe planifikimi i mbështetjes nga Kombet e Bashkuara në këto fusha.
 - Me datë 08.07.2015, një punonjës i KMD mori pjesë në takim konsultues me shoqërinë civile dhe institucionet shtetërore për Planin e Veprimit për LGBT 2015-2020.

- Me datë 10.07.2015 një punonjës i KMD-së mori pjesë në konferencën me temë “Radikalizimi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” .
- Me datë 15.09.2015 Komisioneria mori pjesë në tryezën e rumbullakët me temë “Identifikimi i Sfidave dhe mundësive për aksesin në Drejtësi të grupeve Vulnerabël”.
- Me datë 21.09.2015 një punonjës i KMD mori pjesë në takimim me temë “Paraqitja e Draft raportit të implementimit të planit të veprimit për fëmijë 2012-2015”, organizuar nga MMSR.
- Më datën 29.09.2015 u organizua konferencë nga Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë (SHKSHNJD), me pjesëmarrjen edhe të KMD. Në këtë aktivitet u prezantuan gjetjet dhe konkluzionet përmbyllëse të Studimit Kombëtar për Vlerësimin e Situatës së Njerëzve që nuk Dëgjojnë, zhvilluar nga SHKSHNJD me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare Finlandeze të Njerëzve që nuk Dëgjojnë, INSTAT dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale e Rinisë. *Gjetjet ishin parë nën këndvështrimin e mbështetjes dhe mosdiskriminimit të këtij target grupi, mbështetur në ligjin 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.*
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) ka koordinuar procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) 2016-2020, si pjesë e Dokumentit të Politikave për Përfshirje Sociale dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020). Qëllimi i PKVPAK ishte të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë Shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe eliminojë pengesat për aksesin e tyre në shërbime dhe në të drejta.

Gjatë muajit tetor 2015, janë zhvilluar disa seminare, ku përfaqësuesi i KMD ka marrë pjesë, për përcaktimin e masave/aktiviteteve konkrete e me ndikim të ndjeshëm në jetën e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme, si:

- Kultura dhe Pjesëmarrja në jetën publike
 - Mbrojtja sociale
 - Punësimi dhe AFP
 - Aksesin në Sistemin e Drejtësisë
 - Arsimit dhe Sportit
 - Strehimi, Zhvillimi Urban, Infrastruktura dhe Transporti
 - Kujdesi shëndetësor
- Me datë 06.10.2015 një punonjës i KMD mori pjesë në takimim me temë “Internet i sigurtë për fëmijët në Shqipëri drejt qasjes të integruara institucionale dhe shoqërore për mbrojtjen e fëmijëve online”.
 - Me datë 09.10.2015 një nga punonjësit e KMD-së mori pjesë në takimet e zhvilluara në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të veprimit 2016-2020 për Personat me Aftësi të Kufizuara, proces i koordinuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), si pjesë e Dokumentit të Politikave për Përfshirje Sociale dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020).

- Me datë 15.10.2015 Komisioneria mori pjesë në workshop me temë *‘Ndërtimi i një sistemi gjithpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri sfidat dhe mundësitë’*, organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
- Me datë 27.10.2015 një punonjës i KMD mori pjesë në workshop *“Për ngritjen e kapaciteteve dhe transferimin e njohurive dhe shkëmbimin midis partnereve si Greqia , Shqipëria, Maqedonia dhe Bullgaria”* në kuadër të programit Shape.
- Me datë 02.11.2015 Komisioneria mori pjesë ne Auditorium me temë *“Të drejtat e komunitetit LGBT në Shqipëri”* te organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Pro LBGT.
- Me datë 09.11.2015 një punonjës i KMD mori pjesë në takimin e organizuar me temë *“Aksesi në drejtësi për personat me aftësi të kufizuar”*.
- Me datë 10.11.2015 Komisioneria mori pjesë në aktivitetin me temë *“Segregimi i fëmijëve romë dhe egjyptiane në shkollat shqiptare arritje dhe sfida të integritimit”*, organizuar nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve.
- Me datë 17 nëntor 2015, një punonjës i KMD mori pjesë në tryezën e rumbullakët *“Legjislacioni p r të miturit në konflikt me ligjin - Shqipëria dhe Gjeorgjia shkëmbejnë përvoja”* të organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe UNICEF. Kjo tryezë kishte si qëllim të nxisë debatin profesional mbi legjislacionin që nevojitet për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Teksa Komisioni i Posaçëm parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë e ka përfshirë në strategjinë e reformës, hartimin e një ligji të posaçëm për drejtësinë për të mitur, Ministria e Drejtësisë dhe UNICEF kanë ftuar Zëvendësministrin e Drejtësisë së Gjeorgjisë dhe specialistë të tjerë të së drejtës për të ndarë përvojën e tyre në hartimin, miratimin dhe hapat e para të zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, që është në fuqi në Gjeorgji. Kodi Gjeorgjian konsiderohet si legjislacioni më novator dhe bashkëkohor në rajonin tonë, në fushën e drejtësisë për të mitur.
- Me datë 25.11.2015 një punonjës i KMD mori pjesë në trajnimin me temë *“Punësimi i personave LGBTIQA”*.
- Me datë 8 dhjetor 2015 një punonjës i KMD mori pjesë në Konferencën: *"Organet e Barazisë dhe Direktiva e re për lëvizjen e lirë - sfida apo mundësi?"* organizuar nga EQUINET në Paris. Kjo konferencë iu dedikua rolit të organeve të barazisë në luftën kundër diskriminimit bazuar në kombësi, në kuadrin e zbatimit të Direktivës së re.
- Me datë 10.12.2015 një nga punonjësit e KMD-së mori pjesë në trajnimin me temë *“Trajnim i sistemit të menaxhimit të regjistrit qendror të personelit”* të organizuar nga DAP.
- Me datë 16.12.2015 Komisioneria mori pjesë në prezantimin e dokumentit politik *“E ardhmja e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri”*, organizuar nga MMSR, Këshilli i Europës dhe UNICEF.
- Me datë 16.12.2015 Komisioneria mori pjesë në konferencën me temë *“Zvogëlimi i dhunës kundër grave dhe vajzave në fokus në komunitetin LGBT ne Shqipëri”*.